REFLEKTIM
MBI BOTËN SHQIPTARE

Xhemil Zeqiri

Prishtinë, 2026

Parathenia: **Kolë Marku**

Redaktor: **Fadil Shyti**

Korrektor: **Beqir Elshani**

Shtypi: **FAB Advertising**

Botues: **Libri im**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga autori. Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të shumëzohet, të fotokopjohet e as të riprodhohet në çfarëdo mënyre pa lejen me shkrim të autorit. Të gjitha të drejtat mbrohen me ligj.

REFLEKTIM
MBI BOTËN SHQIPTARE

Xhemil Zeqiri

XHEMIL ZEQIRI -NJË JETË NË SHERBIM TË KOMBIT



Shkruan: Kol Marku - Itali *(studiues)*
09/02/2026

PROLOG

"Ka njerëz që jetojnë brenda kohës së tyre, por ka njerëz që bëhen vetë koha. Një i tillë është Xhemil Zeqiri.
Ka jetë që kalojnë si hije dhe humbasin pa lënë gjurmë. Por, ka edhe jetë që bëhen dritë dhe vazhdojnë të ndriçojnë edhe pasi njeriu largohet nga kjo botë. Në këtë dritë hyn figura e Xhemil Zeqirit, një njeri që nuk jeton për veten, por për fatin e kombit. Ai, është nga ata burra që e matin ekzistencën jo me vitet e jetuara, por me shërbimin e kryer ndaj atdheut, jo me fjalët e bukura, por me veprat që mbeten.
Ai jeton në Danimarkë, në veriun të largët të Evropës, por zemra e tij ishte gjithmonë në vendlindje, atje ku shqiptarët përballeshin me padrejtësi, mohime dhe luftë për dinjitet. Ishte larg me trup, por pranë me shpirt. Në çdo mëngjes të tij kishte një mendim për atdheun, në çdo mbrëmje një shqetësim për fatin e shqiptarëve.

Për të, mërgimi nuk ishte arratisje; ishte detyrë. Ishte një front tjetër i betejës.
Zëri që nuk lejoi heshtjen!
Në mesin e mërgatës, emri i tij u kthye në besim. Kur duhej të flitej, njerëzit e dinin se ai do të fliste. Kur duhej të trokitej në dyer të rënda, ai do të ishte aty. Në zyra ministrish, në takime me diplomatë, në konferenca e media, Zeqiri nuk çonte kurrë emrin e vet – ai çonte dhimbjen dhe të drejtën e kombit.
Ai u bë zëri i atyre që nuk kishin zë. Fjala e tij ishte si një kambanë që binte larg, duke zgjuar ndërgjegje. Nuk kërkoi privilegje, por drejtësi. Nuk kërkoi mëshirë, por barazi. Dhe në një botë ku shpesh heshtja është më e rehatshme se e vërteta, ai zgjodhi rrugën më të vështirë: të mos heshtë.
Kosova-plagë dhe betim!
Kur Kosova digjej, edhe shpirti i tij digjej. Ai nuk mund të qëndronte i qetë, ndërsa fëmijët dëboheshin, ndërsa familjet shpërnguleshin, ndërsa një popull kërkonte liri.
Ai u bë pjesë e përpjekjes së madhe me aq sa kishte: me organizim, me ndihma, me sensibilizim, me shkrime dhe me thirrje publike. Ai kërkoi që Evropa të shihte. Që bota të dëgjonte. Që viktimat të mos mbeteshin vetëm numra, por njerëz me emër e histori. Për të, liria nuk ishte slogan - ishte borxh. Xhemil Zeqiri nuk u ndal asnjëherë. Ai ishte i pranishëm në çdo lëvizje për lirinë e Kosovës, qoftë me shkrime, qoftë me veprime konkrete. Ai ndihmoi luftën e UÇK-së, ngriti zërin për viktimat e pafajshme dhe mbështeti me mjete e mundësi ata që kishin nevojë. Po aq i madh ishte edhe kontributi i tij për shqiptarët në Maqedoni. Ai ishte bashkëthemelues dhe pjesëmarrës aktiv në shoqata patriotike, si "Besa", të cilat kishin për synim jo vetëm ruaj-tjen e identitetit kombëtar në diasporë, por mbi të gjitha sensibilizimin e opinionit ndërkombëtar për padrejtësitë që shqiptarët përjetonin nën Jugosllavi.

Ai luftoi me penë dhe me fjalë për njohjen e Universitetit të Tetovës, për të drejtën e shqiptarëve që të arsimoheshin në gjuhën amtare dhe për t'u trajtuar si qytetarë të barabartë.
Nga Danimarka, ai dërgoi letra dhe kërkesa...
Ai e kuptoi se beteja për identitetin kalon përmes gjuhës dhe arsimit.
Prandaj, u angazhua në shoqatat patriotike të mërgatës, duke punuar për njohjen e Universitetit të Tetovës dhe për barazinë qytetare. Letra pas letre, kërkesë pas kërkese, ai e çoi çështjen shqiptare në tryezat evropiane. Ai nuk lejoi që padrejtësia të fshihej pas kufijve shtetërorë. E bëri Evropën dëshmitare.
Kur e vërteta bëhet mburojë!...
Por, udhëtimi i tij nuk ishte i shtruar me lule. Burrat që ngrihen për kombin shpesh goditen edhe nga ata që duhet t'i kenë pranë. Ai, u përball me shpifje, me keqkuptime, me përpjekje për ta ulur. Megjithatë, ai nuk u përkul. Sepse, kishte një forcë më të madhe se çdo baltosje: ndershmërinë. Kishte një armë që nuk ndryshket: të vërtetën. Dhe, e vërteta, sado të vonojë, di gjithmonë të dalë në dritë. Pra, i armatosur me atdhedashurinë ndershmërinë dhe të vërtetën, ai arriti të fitojë respektin e shumë personaliteteve shqiptare të njohura, si Adem Demaçi, Ibrahim Kelmendi, Hydajet Hyseni, Albin Kurti, Fadil Shyti, e shumë të tjerë, të cilët bashkëpunuan me të në fusha të ndryshme të veprimtarisë kombëtare.
Rojtari i kujtesës
Përveçse veprimtar, ai ishte edhe publicist i kohës së vet. Ai nuk lejoi që ngjarjet të treten. I mblodhi dhe i hodhi në letër: ngjarjet, bisedat, intervistat gazetareske dhe çdo aspekt tjetër të veprimtarisë së tij, duke i regjistruar dhe ruajtur me përpikëri. Librat e tij janë sot dëshmi, janë memorie, janë udhërrëfyes, për këdo që kërkon të kuptojë atë periudhë. Në faqet e tyre nuk gjen vetëm informacion; gjen rrahjen e zemrës të një patrioti. Gjen mallin, dhembjen dhe shpresën. Ai shkroi që kombi të mos

mbetej pa kujtesë, sepse një popull pa kujtesë, është një popull pa të ardhme.
Kur atdheu bëhet mënyrë jetese?!
Por, Xhemil Zeqiri nuk është vetëm zë i një kohe të kaluar. Ai nuk mbetet thjesht kujtim apo figurë e arkivuar në faqet e historisë. Ai jeton dhe vepron, mendon dhe reagon, shkru-an dhe paralajmëron edhe sot. Për të, atdheu nuk ka kohë të shkuar; ka vetëm përgjegjësi të vazhdueshme.
Interesimi i tij ka qenë dhe mbetet i shtrirë në të gjithë kombin, në rrugën e shtet-formimit shqiptar dhe në mënyrën si është drejtuar dhe duhet të drejtohet shteti. Ai i rikthehet vazhdimisht periudhave vendimtare të historisë, figurave që ngritën themelet e shtetit dhe atyre që për rreth gjysmë shekulli mbajtën të paprekur pavarësinë në kushte të stuhishme ilirike (ballkanike). Për Zeqirin, historia nuk është muze; është mësuese. Ajo nuk lexohet për t'u admiruar, por për t'u kuptuar dhe për të mos gabuar sërish. Në analizat dhe bisedat e tij, ai shpesh shtron pyetje thelbësore: çfarë e forcon shtetin? Ku dobësohemi? Pse përsërisim të njëjtat gabime? Ai kërkon përgjegjësi, kërkon përparim, kërkon seriozitet. Sepse, sipas tij, një komb që nuk mëson nga hist-oria, rrezikon ta paguajë të ardhmen.
Edhe sot ai e ndjek me vëmendje rrugëtimin e Shqipërisë në sistemin e ri politik. Ai gëzohet për arritjet, por nuk hesht për problemet. Kur sheh padrejtësi, kur sheh institucione që lëkunden, kur sheh zhgënjim qytetar, ai e ngre zërin. Jo për të sulmuar, por për të përmirësuar. Jo për të prishur, por për të ndërtuar. Për të, liria duhet të shoqërohet me ligj, me drejtësi, me funksionim të shtetit – ndryshe ajo mbetet e paplotë.
Vështrimi i tij shtrihet njëkohësisht në Kosovë, në trevat shqiptare në Maqedoni, si dhe tek shqiptarët nën Serbi, në Kosovën Lindore. Ai, nuk i ndan ata me kufij administrativë; i bashkon me fat. Çdo zhvillim politik, çdo tension, çdo shpresë apo rrezik në këto hapësira, ai e ndjen si çështje personale. Për të, kombi është një trup: nëse dhemb një pjesë, dhemb i tëri.

Në këtë kuadër, ai ka qenë dhe mbetet kritik ndaj ideve për ndryshime kufijsh, që mund të hapin plagë të reja. Ai e njeh mirë historinë e Ilirikut (Ballkanit) dhe e di se kur politikanët luajnë me harta, shpesh popujt paguajnë me jetë e me shpërngulje. Prandaj, ai kërkon maturi, drejtësi dhe garanci të forta.
Po kështu, ai e ka trajtuar me kujdes dhe iniciativën e ashtuquajtur "Ballkani i Hapur", duke ngritur pikëpyetje sa herë që sheh rrezikun që në emër të bashkëpunimit të krijohen pabarazi të reja ose të forcohet përparësia (primati) i Serbisë pa u zgjidhur më parë çështjet e hapura me shqiptarët. Për Zeqirin, bashkëpunimi është i mirëpritur vetëm kur është i barabartë, kur respekton dinjitetin dhe të drejtat e secilit.
Pra, veprimtaria e tij nuk është vetëm e djeshme; është e përditshme. Ai vazhdon të shkruajë, të flasë, të këshillojë, të kritikojë kur duhet dhe të mbështesë kur e sheh të drejtë. Dialogu i tij është i gjerë, gjithëpërfshirës dhe i drejtuar nga një busull e vetme: interesi kombëtar. Kjo e bën Xhemil Zeqirin një figurë të rrallë – një njeri që e ka kthyer patriotizmin në mënyrë jetese. Jo si kujtim romantik, por si detyrë aktive. Dhe, për sa kohë ai vazhdon të mendojë e të veprojë, zëri i kombit në mërgatë vazhdon të jetojë përmes tij.

Çfarë na mëson aktiviteti dhe jeta e tij?
Jeta e Xhemil Zeqirit nuk është thjesht një rrëfim për t'u treguar; është një mësim për t'u jetuar. Ajo na flet me gjuhën e përvojës, me peshën e sakrificës dhe me qartësinë e një ndërgjegjeje që nuk ka pranuar të flejë. Në çdo hap të tij, dje dhe sot, kupton se atdheu nuk është një fjalë që shqiptohet lehtë, por një barrë e shenjtë që mbahet me dinjitet. Ai na mëson se dashuria për vendin nuk provohet me brohoritje, por me punë të heshtur e të përditshme. Me durimin për të trokitur në dyer që nuk hapen menjëherë. Me këmbënguljen për të folur edhe kur të tjerët lodhen. Me guximin për të qëndruar drejt kur rrymat fryjnë kundër. Na mëson se flamuri nuk është veç zbukurim festash. Ai

është përgjegjësi. Është kujtesë për ata që ranë dhe detyrim për ata që jetojnë. Ta mbash flamurin do të thotë të mbash fjalën, të mbash drejtësinë, të mbash shpresën e njerëzve që presin më të mirën. Nga rruga e tij kuptojmë edhe një të vërtetë tjetër të madhe: largësia nuk e zvogëlon dashurinë për atdheun. Përkundrazi, shpesh e bën më të mprehtë. Edhe në mërgim mund të bëhesh mur mbrojtës, urë lidhëse, shtyllë e lirisë. Trupi mund të jetë larg, por ndërgjegjja mund të jetë më pranë se kurrë. Ai, kurrë nuk e kërkoi lavdinë. Nuk rendi pas titujve, as pas duartrokitjeve.

Por lavdia e gjeti vetë – në besimin e njerëzve, në respektin e bashkëpunëtorëve, në gjurmën që veprimtaria e tij ka lënë në historinë tonë të re dhe në debatet që vazhdon të hapë edhe sot. Sepse, ai nuk është vetëm kujtim; ai është prani. Figura e tij bëhet kështu një thirrje e vazhdueshme: për bashkim kur rrezikojmë të ndahemi, për përkushtim kur tundimi i rehatisë na merr, për vazhdimësi kur harresa na afrohet. Ai na kujton se kombi nuk mbahet nga entuziazmi i çastit, por nga puna e gjatë dhe besnikëria e palëkundur.

Në fund, nga veprimtaria dhe jeta që ai zhvillon në mërgatë, del një përfundim i thjeshtë dhe njëkohësisht i thellë: patriotizmi nuk është fasadë deklaratash, por punë dhe qëndrueshmëri. Është të mos largohesh nga detyra, të mos heshtësh përballë padrejtësisë, të mos lejosh të shuhet drita e së vërtetës. Dhe, përderisa ai vazhdon të mendojë, të shkruajë e të reagojë, ky mësim vazhdon të marrë frymë mes nesh.

Unë kam pasur dhe vazhdoj të kem fatin ta njoh nga afër. Kam biseduar dhe bisedoj me të për kulturën, për plagët dhe për shpresat tona. Në fjalën e tij gjen urtësi, në heshtjen e tij gjen përgjegjësi, në qëndrimin e tij gjen dinjitet. Sa herë që më ka dhuruar librat e vet, kam ndjerë se në duar nuk mbaj vetëm faqe të shtypura, por copa jete, frymë përkushtimi, një zemër që rreh për kombin.

Dhe sot, kur përmendet emri i tij, nuk del përpara thjesht një njeri. Del një udhë. Del një kujtesë që nuk plaket. Del një zë që nuk lodhet së thirruri për drejtësi. Xhemil Zeqiri, është aty ku shqiptari ngre kokën dhe kërkon të drejtën e vet. Është aty ku fjala e lirë çan errësirën. Është aty ku dashuria për atdheun bëhet punë, sakrificë dhe besim. Si një dritë në horizont, ai nuk kërkon duartrokitje; mjafton që rruga të shihet. Dhe, për sa kohë kjo dritë mbetet ndezur, kombi e di se nuk është vetëm.

PA ADEM JASHARIN, KOSOVA SOT DO TË KISHTE ENDE POLICË DHE USHTARË SERBË…!

Pacifizmi i rremë dhe pushka e drejtësisë: nga frika te qëndresa
Pa Adem Jasharin, Kosova sot do të kishte ende policë dhe ushtarë serbë - ndërsa pacifistët do të mbanin konferenca shtypi për "paqe" në hijen e okupimit.
Në çdo kohë, tradhtia ka veshur maska të ndryshme. Disa e quajnë "mençuri politike", të tjerë "pacifizëm". Por në thelb, është e njëjta frikë e vjetër që na është shitur si urtësi kombëtare.



Kujtojmë kohën kur disa "udhëheqës" predikonin qetësinë dhe durimin, duke frikësuar popullin me parashikime apokaliptike: "Mos ia prishni qejfin Serbisë, se për dy orë na vret 300 mijë shqiptarë!"
–kështu e përtypnin frikën e tyre dhe ia ushqenin një kombi të shtypur.
Por historia nuk shkruhet me frikë. Historia shkruhet me qëndresë.

Dhe pikërisht atëherë kur "pacifistët" paralajmëronin shfar-osje, Adem Jashari - Komandanti i pavdekshëm - ngriti pushkën e lirisë në Prekaz, bashkë me familjen e tij. Në emër të UÇK-së dhe të gjithë shqiptarëve, ai ia ktheu pushkën Serbisë fashiste.
Dy vite luftë, 12 mijë të vrarë, qindra fshatra të djegura – por liria u fitua.
Nëse do ta kishim ndjekur logjikën e "pacifistëve" që llogarisnin frikën me orë, Serbia do të kishte vrarë "miliarda" shqiptarë vetëm në lapsin e tyre të përkulur. Por realiteti e rrëzoi mitin e frikës: pushka e drejtësisë është më e fortë se çdo fjalë e servilizmit.
Po të mos ishte Komandanti legjendar Adem Jashari, sot Kosova do të kishte ende polici e ushtri serbe nëpër rrugët e saj.
Sepse, për "pacifistët rugovistë", mjaftonte që të mbaheshin konferenca shtypi çdo të premte në ora 12:00 –pikërisht në të njëjtën orë kur fundamentalistët thërrisnin në arabisht nga xhamitë. Kjo nuk ishte rastësi, por pjesë e një taktike të mirë menduar serbe: t'i jepej Rugovës hapësirë për konferenca dhe takime me delegacione ndërkom--bëtare në ato orë, për t'u "vërtetuar" propaganda serbe se shqiptarët gëzonin të gjitha të drejtat, por në Kosovë
ekzistonin"lëvizje islamike ekstremiste".
Një farsë e përkryer propagandistike, që synonte ta paraqiste okupimin si "luftë kundër terrorizmit".
Por historia foli vetë. Nuk ishin as konferencat e së premtes, as deklaratat "paqësore" që e sollën lirinë. Ishte pushka e Jasharajve, gjaku i dëshmorëve dhe vendosmëria e popullit që nuk pranoi të jetonte më nën çizmen e pushtuesit.
Sot, kushdo që përpiqet të rishkruajë historinë e luftës, duke e zbukuruar me fjalë boshe "paqësore", bën po të njëjtin gabim si dikur: harron se pa pushkën e Prekazit, nuk do të kishte as flamur, as liri, as Republikë të Kosovës.

Qerret. Kavajë, 24. 10. 2025

PSE SHQIPTARËVE U MOHOHET E DREJTA PËR BASHKIM KOMBËTAR?

Shqiptarët janë një nga popujt më të vjetër të Evropës, me rrënjë që datojnë mijëra vjet përpara formimit të shteteve moderne. Megjithatë, ky popull autokton, që ka ndihmuar në ndërtimin e qytetërimeve evropiane, mbetet ende i ndarë në disa shtete, për shkak të vendimeve të padrejta të fuqive të mëdha. Konferenca e Londrës më 1913 jo vetëm që copëtoi trojet shqiptare, por krijoi një realitet që as sot, më shumë se një shekull më vonë, nuk është korrigjuar.

Në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Sanxhak dhe në Çamëri, shqiptarët përbëjnë një faktor të rëndësishëm etnik, kulturor dhe politik. Vetëm në Serbi, në treva si Sanxhaku i Nishit, Presheva, Bujanoci e Medvexha, jetojnë mbi 700 mijë shqiptarë, të cilëve u mohohen të gjitha të drejtat themelore sociale, arsimore e nacionale. Ndërkohë, në Çamëri, dhjetëra mijëra shqiptarë u dëbuan me dhunë nga trojet e tyre dhe ende sot nuk u është njohur e drejta për rikthim apo dëmshpërblim.

Përse atëherë shqiptarëve u mohohet e drejta për të vendosur vetë mbi fatin e tyre?

E drejta për vetëvendosje është një parim themelor i së drejtës ndërkombëtare, por kur bëhet fjalë për shqiptarët, ky parim zbatohet me standarde të dyfishta.

Bashkësia ndërkombëtare, që ka pranuar pavarësinë e shumë popujve të tjerë, nuk lejon as referendumin për ribashkim kombëtar shqiptar, duke u fshehur pas argumentit të "stabilitetit rajonal". Në të vërtetë, frika e vërtetë është politike: një komb shqiptar i bashkuar do të ishte faktor i fuqishëm në Ballkan, me ndikim ekonomik, kulturor dhe gjeostrategjik. Pikërisht për këtë arsye, shqiptarët mbahen të ndarë - për të mos u bërë asnjëherë zë i fuqishëm, i vetëm në arenën ndërkombëtare.

Por koha e heshtjes po mbaron. Ribashkimi i kombit shqiptar nuk është kërcënim, por, është e drejtë historike dhe morale. Një komb që ndan të njëjtën gjuhë, kulturë dhe histori, nuk mund të jetojë përgjithmonë i ndarë. Shqiptarët nuk kërkojnë më shumë se të tjerët - kërkojnë drejtësi, dinjitet dhe të drejtën për të vendosur vetë mbi fatin e tyre në trojet e veta.

Vlorë, 17 prill 2024

SUGJERIMI IM DHE I BASHKËPUNËTORËVE TË MI QË, VV-JE, TË HYJË NË INSTITUCIONE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHA REZULTATE TË KËNAQSHME, -TË SHUMËPRITURA?!

Gjithmonë, me bashkëpunëtorët e mi në mërgim i kam mbështetur lëvizjet politike, jo për interesat tona personale, por sepse besonim se kombi ynë kishte nevojë për zëra të fortë dhe për përkushtim të sinqertë.
Ndoshta për fatin tim dhe të shokëve të mi, jo gjithmonë ata që udhëhiqnin këto lëvizje; ditën ta shfrytëzonin përvojën dhe energjinë tonë, për interesat kombëtare, duke i kthyer ato për interesa të tyre.
Por, kjo dredhi e tyre politike, fatbardhësisht nuk na e zbehu asnjëherë vullnetin. Kjo, pafytyrësi politike, aspak nuk na ndodhi me Albinin dhe me VV.
Si nënkryetar i "STS International solidaritet" në Danim-arkë, ku kishim mbi 300 mbështetës kundër terrorit serb në Bosnje dhe Kosovë, në fushëbetejën politike dhe diplo-matike u angazhuam me gjithë qenien tonë për të shpjeguar para opinionit danez, suedez dhe norvegjez, por edhe më gjerë atij ndërkombëtar vuajtjet shekullore të shqiptarëve në trojet e tyre etnike. Çdo fjalë që thoshim, çdo takim që organizoja dhe shokët e VV organizonin ishte një përpjekje për ta bërë botën që të kuptojë të drejtën dhe dhimbjen tonë, për atdheun në robëri.
Në veçanti , kur në skenën politike doli Albin Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje, bashkë kemi ndier, më qartë kemi parashikuar se po lindte diçka e re, diçka që vinte nga shpirti i popullit.

-Një ditë më telefonoi simboli i rezistencës sonë kombëtare, Adem Demaçi,- ai, me zërin e tij të vendosur më tha:



(Albin Kurti viziton Pikat e Lëvizjes Vetvendosje ne Skandinavi Fadil Shyti dhe Xhemil Zeqiri)

"Xhemil Zeqiri, a ka mundësi së paku 4-5 veta t'ia bashkojmë Albin Kurtit?" -I thashë -po kemi mundësi, por neve na mungon, paraprakisht nuk e kishim një program politik të qartë. Ai, u përgjigj mme e vendosmëri, me bindje të plotë:
"Program më të mirë se Vetëvendosje – vetë emri është program." Ajo fjali më mbeti gjatë në mendje.
Pasi bisedova me shokë, ata e përqafuan mendimin tim dhe në veçanti të simbolit të rezistencës, Adem Demaçit. Pa harruar të theksoj dhe faktin që edhe ata ishin në dijeni që një Lëvizje përparimtare është themeluar dhe po vepron në Kosovë me fillimet e saj me guxim dhe dituri. Po ato ditë, shoku Fadil Shyti, posa kishte dëgjuar për protestat dhe parullën fillestare tepër largpamëse të Albinit dhe VV-së: "Jo negociata, Vetëvendosje"! Ay, menjëherë kishte dalë me një shkrim me titull: "Një diell i ri, po lindë në Kosovën shqiptare", në atë shkrim shoku ynë, bënte thirrje për përkrahje të fuqishme për Albinin dhe VV.
-Demonstratat e studentëve i mbështetëm pa asnjë hezitim – politikisht, moralisht dhe ekonomikisht. Besonim se energjia rinore ishte forca më e pastër e ndryshimit.

-Në vitin 2009, një aksident komunikacioni, mua më ndërpreu hovin.
Problemet shëndetësore më detyruan të tërhiqem ca nga terreni aktiv, por jo nga misioni. Përmes STS-së dhe revistës sonë mujore vazhdova të kontribuoj, duke informuar dhe sensibilizuar opinionin. Viti 2010 qe vit shumë dramatik, me protesta të fuqishme, VV u fuqizua bukur shumë, kjo solli zhvillime të mëdha. Në njërën anë, mbështetja popullore për Vetëvendosjen rritej çdo ditë, në anën tjetër, strukturat ndërkombëtare dhe veglat e tyre reaksionare që ishin në pushtet në Kosovë, përpiqeshin ta frenonin këtë vetëdijesim të popullit. Ishte një përballje mes vullnetit popullor dhe interesave të fuqive të mëdha.
Vendosëm të dërgonim një delegacion në Kosovë. Kryetari ynë, Vogn Rasmussen, shkoi së bashku me deputetin danez dhe euro-parlamentarin Søren Søndergaard, si dhe me ish-euro-deputetin holandez Erik Meijer. Unë, për arsye shënde-tësore, mbeta në Danimarkë, por para nisjes ua shpjegova qartë situatën: "Gjyqi ndaj Albin Kurtit, presioni politik dhe ekziston rreziku që, VV të izolohej". Shokët danezë, i porosita të takonin përfaqësuesit e VV dhe t'i bindnin ata që, pjesëmarrja në zgjedhje ishte e domosd-oshme.
Edhe nëse Albini dhe VV nuk e kishim aspak për qejfi, bile as nuk e njihnin Kushtetutën dhe simbolet shtetërore, të cilat vërtet ishin imponuese; pjesëmarrja e VV-së, ishte mënyra më e duhur, për ta sfiduar sistemin nga brenda. Delegacionit danez iu thashë: "Edhe këtu në Danimarkë, kemi monarki, por kjo nuk na pengon të jemi republikanë dhe të luftojmë për bindjet tona brenda dhe jashtë Kuvendit.
Pas kthimit, delegacioni raportoi për trajtimin diskriminues që, edhe sipas tyre, po i bëhej Vetëvendosjes nga strukturat e drejtësisë të ndikuara nga administrata e UNMIK dhe nga disa qeveritarë vendorë. Në debat theksova se ishte momenti për veprim diplomatik.

Propozova t'i dërgonim një letër Ministrit të Jashtëm danez, Søren Pin, duke kërkuar angazhim të drejtpërdrejtë për të kundërshtuar akuzat e pabazuara dhe për të mbështetur një proces të drejtë. Letra u hartua, u dërgua – dhe pas pesë ditësh morëm përgjigje pozitive. Ministri shprehej se Danimarka do ta trajtonte seriozisht çështjen dhe do të angazhohej në nivel diplomatik ndërkombëtar.

Ishte një moment kënaqësie dhe krenarie, jo vetëm për mua personalisht, por për faktin se zëri ynë u dëgjua.

Kur Vetëvendosje mori pjesë për herë të parë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010 dhe fitoi 14 vende në Kuvend, jemi ndier të kënaqur dhe më tej kemi ndier, shikuar dhe dëgjuar se, një kapitull i ri po hapej në historinë tonë të lavdishme dhe kjo po vinte si rreze drite në politikën shqiptare në Kosovës. Edhe pse shëndetin e kisha ca më kishte kufizuar, përsëri çaja përpara, në takimet me shokët; Fadil Shyti, Gëzim Mekuli Shqiptar Osekun; vërtet ndiheshim pjesë e atij rrugëtimi.

-Vlen të theksoj faktin e së vërtetës që, gjatë debateve, shokun Fadil mezi e kam bindur që, është e dobishme, që VV të pranojë të hyjë në Institucionet e Republikës. Ai, në veçanti rreptësisht reagonte me argumentet: si mund të pranojë Albini dhe VV jonë, një "Kushtetutë të Kosovës" e futur në margjinat e Paketës të Ahtisarit?! Si mund të pranojë, Albini dhe VV-ja jonë, heqjen e Flamurit kombëtar nga institucionet Republikës sonë?! Si mund të pajtohet, Albini dhe VV; që në rrugën tonë drejt sovranitetit të Kosovës, të kemi Nenin 3 si digë të kësaj Kushtetute e cila e pengon ribashkimin tonë kombëtar?! -E, të tjera, e të tjera ndërkë-mbëza dhe bllokada politike dhe diplomatike që do t'i kemi para nesh. Debatet me shokun dhe bashkëpunëtorin tim shumëvjeçar, "rebel" i shtroja me durim dhe me gjakftohtësi, këto bllokada i shihja si të përkohshme, ato do t'i tejkalojmë me punën tonë -i thosha me bindje të plotë, shokut Fadil. Tani, kur kanë kaluar kaq vite plot sfida, punët kanë ecur një çikë përpara, ne jemi të vetëdijshëm që, ende kemi shumë punë të mbara për

të bërë, ne duhet dhe do t'i çajmë bllokadat -themi, kur dertohemi, bile edhe "kur zihemi", pro-et kundër, vetëm që, çështja jonë kombëtare të zgjidhet drejt, që atdheu ynë, Shqipëria Etnike të ecë përpara dhe të përparojë. Prandaj, thellohem në mendime, them me vete: ndonjëherë kontributi atdhetar, nuk matet vetëm me praninë fizike në skenë, në atdhe; por, matet edhe me bindjen, me veprat, me përkushtimin dhe guximin për të vepruar në momentet vendimtare. Ne, mërgata jonë atdhetare kemi bërë, aq sa kemi mundur dhe ditur, ne po bëjmë dhe do të bëjmë edhe më tutje; për të dhënë kontributin tonë, këtë borxh ia kishim dhe sa t'i bie dielli tokës, ia kemi atdheut; ne pandalshëm do të japim këtë kontribut të pakursyer...!

KRYESIA E FAQES SHQIPTARE ”DIPLOAMCIA.DK”, DEL ME KËTË: KOMENT

Kopenhagë, 16 nëntor 2011

Është bërë kërkesë e fuqishme, jo vetëm e kohës së sotme; Por edhe kërkesë e ardhmërisë sonë që, secili shqiptar atdhetar kudo që gjendet nëpër botë të veprojë në të gjitha fushat e jetës, me të gjitha forcat fizike dhe mendore për të sotmen e dhe të nesërmen e ndritur të Shqipërisë Etnike.

– Siç po dihet, -historia, ndaj nesh u tregua dhe po tregohet tejet e pamëshirë. Atmëmëdheu ynë së shpejti po i afrohet 110 vjetorit të pavarësisë së gjysmë-shtetit shqiptar; Dhe, për të mos shkuar më tutje ndër shekuj, qe kaq vite po jeton si mos më zi, i ndarë dhe i shumëvuajtur në trojet e veta.

Gjatë shekujve u masakrua dhe u ricopëtua nga shtetet sllave fqinje, – këto ishin dhe mbetën armike të përbetuara ndaj nesh, ishin dhe mbetën të pangopura në orekset e tyre shoviniste, për ta gllabëruar Shqipërinë Etnike.

Por, kjo tragjedi nuk ngjau jo sepse, ato patën mëshirë; Por populli ynë shekujve gjer në ditët tona qëndroi e po qëndron i patundur në përpjekjet për liri, përparim e ribashkim kombëtar.

-Po, me të drejtë dikush mund të pyet: “Po, pasi paska bërë dhe po bën gjithë këtë qëndresë ky popull etnik në trojet e veta, përse gjer më sot nuk i paska arritur objektivat e tij madhore”?!

-Përgjigjigjen për këtë, është zor t’a japësh në një komenti ky në emër të redaksisë sonë; -për këtë duhen një mal me letra dhe kurdoherë duke i qëndruar besnik të vërtetës dhe vetëm të vërtetës.

Ne, kryesia e diplomacisë dk, do të përpiqemi që, duke i mbetur besnik qëndrimit tonë të shprehur dhe në ueb-faqen tonë: diplomacia.dk, e cila gjatë udhëtimit të saj, -përkrah simotrave të

veta: pashtriku, albaniapress, mekulipress,
hogoshti.blogspot.com, e të tjera po përpiqen t'i japin zërin e së vërtetës së kësaj "kohë të pakohë"!…
Ne, kryesia e diplomacisë dk, do të përpiqemi t'i mbesim besnik idealit të madh të ribashkimit kombëtar; ne, jemi të vetëdijshëm se, ky ideal madhor nuk është e mundur të arrihet me ndonjë formulë magjike apo të arrihet aq shpejt sa që do të dëshironim ne dhe shumë ithtarë të kësaj ideje, me rrënjë shekullore.
Ne, konsiderojmë që, kjo dot ë mund të arrihej me përpjekje të pandërprera në te¨gjitha fushë-betejat e jetës duke u ndeshur kurdoherë dhe kudo me të gjithë ata që kësaj ideje i japin ngjyrime të errëta duke shkuar më tej duke e konsideruar këtë si një objektivë të paarritshme, si romantike, si nacionaliste, si të tejkaluar për kohën e sotme dhe për të nesërmen; Hertug Hedhur "Perin e Peshkimit" Gjetiu; kinse se kjo ide do të arrihet që kombi ynë paraprakisht duhet të bashkohet me Evropën e pastaj kjo objektivë "ndoshta" do t'i duhej…
-Për më keq, viteve të fundit, e në veçanti pas tri luftërave çlirimtare që bëri kombi ynë në trojet e veta; -janë ngritur zëra "teorikësh", reaksionarë si: Nexhemdin Spahiu, Migjen Kelmendi, Halil Matoshi e të tjerë që iu kanë marrë kokat erë tradhtie; -që, kjo ndarje tragjike kombëtare të përligjet, të çelikoset duke e ndarë kombin tonë kinse, në "komb kosovar"; -kinse, me një gjuhë "tjetër" e bazuar vetëm sipas gegnishtes, me një flamur laraman të Ahtisarit; -e të pranuar nga klasa politike e dështuar e Kosovës dhe më tej!…
-Po, pse erdhën gjithë këto prapakthime në historinë tonë të re, -shtrohet pyetja tejet e arsyeshme.
Erdhën, sepse burimin e kanë tek të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare, anti-shqiptare: në Traktatin e Shën Stefanit, Kongresin e Berlinit, Mbledhjen e Versajit, Konferencën e Londrës I, në Londrën II, Parisin, Dejtonin, Rambujenë e deri te Pakoja e Ahtisarit, këtu shihen qartas

dëmet që na janë bërë e po na bëhen nga faktori ndërkombëtar…

– Erdhën gjithashtu, sepse faktorët politikë shqiptarë luajtën dhe po luajnë një diplomaci tejet defensive dhe servile "aleatëve" apo miqve të heshtur të Serbisë dhe vendeve të tjera armike të shqiptarëve.

Ne, kryesia e diplomacisë dk, ishim dhe do të jemi kurdoherë zëri i fuqishëm i kërkesave gjithëkombëtare përkrah forcave përparimtare të cilat po përpiqen që ta çojnë përpara përparimin edhe Ribashkimin gjithëkombëtar, si Lëvizja Vetëvendosje dhe simotrat e saj kudo që janë dhe po veprojnë pandalshëm.

Tani, jemi në prag festave të mëdha kombëtare, 28 e 29 Nëntorit, përfitojmë nga rasti që, të gjithë shqiptarëve kudo që gjenden brenda dhe jashtë Shqipërisë Etnike, t'jua urojmë këto festa madhë-shtore!

DILAVER GOXHAJ, KOMANDANT "SHPËTIM GOLEMI": HEROI QË MERITON TË SHPALLET "NDERI I KOMBIT"!

Kur vullnetarët e lirisë ndëshkohen, ndërsa servilët shpërblehen – padrejtësia bëhet plagë kombëtare!

Sa padrejtësi duhet të durojë ky komb që të mësojë të nderojë bijtë e vet më të mirë?
Dilaver Goxhaj, i njohur me nofkën e luftës Komandant Shpëtim Golemi", është një ndër figurat atdhetare, që prej shumë vitesh do të duhej të ishte shpallur "Nder i Kombit".
Ai nuk kërkoi poste, as lavdi; ai nuk u shty nga interesat personale, familjare e të tjera, por, hyri në luftë nga ideali i çlirimit dhe ribashkimit kombëtar.
Ky burrë, bashkë me të birin Dritan Goxhajn, erdhën vullnetarë nga Shqipëria londineze, për t'u bashkuar me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.
I frymëzuar nga mësimet e Komandanti strateg, Enver Hoxhës për mbrojtjen e Atdheut dhe nga qëndresa e Adem Demaçit për ribashkim kombëtar, ai mori pjesë në luftën e shenjtë për liri.

Para flamurit kuq e zi e dha besën shqiptare për ribashkimin e trojeve, për një Shqipëri të lirë e të ribashkuar.
Por çfarë ndodhi më pas?
Sot, në vend që të nderohen, këta burra janë lënë krejt në harresë?!!!
Shqipëria londineze heshtë. Kosova zyrtare, heshtë.
E, për më keq – Komisioni Shtetëror i Kosovës, ua ka ndalur pensionin e veteranit vullnetarëve nga Shqipëria londineze?!!!

A mund të ketë padrejtësi më të madhe se kjo?
Ata që erdhën nga shteti amë, që dhanë jetën e derdhën gjakun për çlirimin e Kosovës, sot trajtohen si të huaj, si të padëshiruar?!

A është ky shpërblimi që meriton gjaku i derdhur për liri?!
Pse vallë tek institucionet tona ende mungon meritokracia kombëtare?
Pse shpërblehen servilët dhe harrohen idealistët?
Pse duhet të nëpërkëmben ata që luftuan për një ideal të pastër kombëtar, ndërsa lavdia dhe privilegjet u takojnë atyre që s'e kanë ndier kurrë frymën e pushkës e të sakrificës?
Është koha të thuhet hapur:
Dilaver Goxhaj – Komandant "Shpëtim Golemi" dhe të gjithë vullnetarët e ardhur nga Shqipëria janë krenaria e kombit shqiptar! Atyre t'u japim edhe ato të mira materiale që iu takojnë.



Ata nuk luftuan për para, as për pushtet – por për flamurin kuq e zi, për nderin e Atdheut dhe për ribashkimin kombëtar.
Kush nuk i nderon këta burra, nderon kombin!
Koha është që Shqipëria administrative dhe Kosova të ndreqin këtë padrejtësi historike, të rivlerësojnë figurat e luftës që dhanë

gjithçka për Atdheun dhe të rivendosin drejtësinë kombëtare në vend të hipokrizive politike.
Sepse, pa nderimet për luftëtarët e lirisë, nuk ka as dinjitet kombëtar, as të ardhme për shqiptarinë!
Kopenhagë, 29 tetor 2025

ENVER HOXHA – STRATEGU I MADH I HEROIZMIT TË KOMBIT SHQIPTAR

Në historinë e gjatë të shqiptarëve, asnjë figurë politike nuk ka lënë gjurmë më të thella, më vendimtare dhe më të qëndrueshme, sesa Enver Hoxha. Ai nuk ishte thjesht një udhëheqës shteti apo një ideolog komunist; ai ishte arkitekti i strategjisë së heroizmës kombëtare, në një epokë kur Shqipëria rrezikonte të zhdukej si komb dhe si subjekt politik në hartën e Evropës.
Njohja e gabimeve historike:
Enver Hoxha ishte ndoshta i vetmi udhëheqës shqiptar që analizoi me qartësi dhe pa iluzione strategjitë e gabuara historike të shqiptarëve - që nga besnikëritë e kota ndaj Perandorisë Osmane, deri te besimi naiviteti në premtimet e Fuqive të Mëdha pas Luftërave së Dytë Botërore. Ai, kuptoi se historia e shqiptarëve kishte qenë histori e mbijetesës, por pa strategji të qëndrueshme. Kombi shqiptar kishte qenë shpesh instrument i interesave të huaja, duke u dobësuar në çdo përplasje rajonale.

Hartimi i një strategjie të re kombëtare:

Në këtë kontekst, Enver Hoxha formuloi një strategji të re të mbijetesës zhvillimit të ideve të bazuar në veprimtarinë revolucionare kombëtare: forcimin e shtetit, edukimin e popullit në frymë kombëtare dhe ngritjen e Shqipërisë në nivel të barabartë me fqinjët, pavarësisht



madhësisë apo pasurisë. Ai, e kuptoi se vetëm një shtet i fortë, i arsimuar dhe i vetë- qëndrueshëm mund të garantonte ekzistencën e shqiptarëve në shekujt që do të vinin.

Orientimi drejt Perëndimit:

Në mënyrë paradoksale, ndonëse udhëhoqi një regjim socialist, Enver Hoxha ishte ai që e vendosi Shqipërinë në boshtin e qytetërimit perëndimor. Duke refuzuar vartësinë nga Lindja, nga Rusia e Carëve revizi-onistë sllavë dhe më pas edhe nga Kina revizioniste, ai e izoloi Shqipërinë politikisht, por e mbrojti shpirtërisht nga asimilimi lindor dhe perëndimor. Në thelb, projekti i tij ishte mbrojtja e qenies shqiptare si pjesë e identitetit të pavarur evropian, dhe kjo e bëri të papajtueshëm me çdo formë të nënshtrimit ndaj fqinjëve.

Trashëgimia e strategut:

Sot, në një kohë ku globalizmi dhe interesat e huaja rrezikojnë sërish pavarësinë ekonomike dhe kulturore të Shqipërisë, figura e Enver Hoxhës duhet të lexohet me objektivitet historik. Ai, nuk mund të gjykohet thjesht si udhëheqës i një sistemi, por si strateg i heroizmit të mbijetesës kombëtare — një mendje që e kuptoi idenë e madhe të rilindësve të shek.. 19-të se, fati i shqiptarëve nuk mund të lihej në dorë të askujt tjetër përveç vetë shqiptarëve.

Përfundim:
Historia do ta rivlerësojë Enver Hoxhën jo për kultin e tij, por për vizionin e tij strategjik. Ai, e ktheu Shqipërinë nga një territor i ndarë e pa identitet në një komb me vetëdije politike dhe historike të ribashkuar, duke e vendosur çështjen shqiptare në boshtin e qytetërimit shqiptar dhe njerëzor. Dhe, kjo, më shumë se çdo gjë tjetër, e bën atë figurën më madhështore politike që ka nxjerrë kombi shqiptar.

Zhelinë, 08- tetor, 2025

REAGIM NDAJ DEBATIT NË RTK PËR FIGURËN E ENVER HOXHËS

Televizioni i Kosovës, RTK, zhvilloi së fundmi një debat mbi temën "Enver Hoxha i Kosovës dhe Enver Hoxha i Shqipërisë", i moderuar nga gazetari Korab Lecaj. Në studio ishin të ftuar profesorët Agim Zogaj dhe Begzad Baliu nga Kosova, si dhe profesor Hasan Bello nga Tirana.

Që në hyrje, debati u shoqërua me terma të papërshtatshëm ideologjikë që vinin erë propagandë titiste – një diskurs i ndërtuar për dekada për të përçuar një narrativë armiqësore ndaj periudhës së socializmit shqiptar dhe veçanërisht ndaj Enver Hoxhës. Termat si "Shqipëria komuniste" dhe etiketime të tjera si "reaksionare" ndaj mbështetësve të Enverit janë trashëgimi e aparatit propagandistik të Komitetit Qendror të LKK-së, që pas vitit 1981, e deri në transformimin e saj në LDK, vazhdoi të mbillte urrejtje ndaj çdo mendimi kombëtar shqiptar.

Profesorët Begzad Baliu dhe Agim Zogaj, në këtë debat, u përpoqën me qartësi dhe argumente të ruajnë seriozitetin dhe balancën. Përballë tyre, fatkeqësisht, qëndroi një pozicion ideologjik i njohur tashmë për qasjen e tij antikombëtare.

Disa të vërteta që nuk mund të fshihen me etiketime ideologjike

Konferenca e Paqes në Paris, 1946 – Britanikët dhe amerikanët refuzonin praninë e delegacionit shqiptar, duke pretenduar se përfaqësimi shqiptar i takonte Titos. Vetëm pas këmbënguljes së Bashkimit Sovjetik, Shqipëria u përfshi dhe Enver Hoxha deklaroi hapur: "Nuk kam ardhur për të dhënë llogari, por për të kërkuar llogari për padrejtësitë ndaj kombit tim."

Përplasja në Moskë me Hrushovin, 1961 – Enver Hoxha mbrojti me vendosmëri pavarësinë kombëtare dhe ideologjike të Shqipërisë, duke refuzuar përuljen ndaj Bashkimit Sovjetik dhe duke zgjedhur rrugën e vështirë, por të ndershme, të sovranitetit.

Lenini dhe Shqipëria – Ishte Lenini ai që për herë të parë denoncoi Traktatin e fshehtë të Londrës të vitit 1915, ku parashikohej ndarja e Shqipërisë mes Greqisë, Italisë dhe Jugosllavisë. Nuk është çudi që Bajram Curri e quante atë me respekt "Hazreti Lenini".

Roli i Jusuf Gërvallës dhe Enver Hoxhës – Në Kongresin e 8-të të PPSH-së, Jusuf Gërvalla kërkoi themelimin e një partie komuniste shqiptare në Kosovë. Por Enver Hoxha iu përgjigj: "Jo. Ju duhet të zhvilloni nacionalizmin shqiptar. Ai do të jetë shpëtimi juaj." Kjo nuk ishte ndarje ideologjike, por një strategji kombëtare e menduar mirë.

Plani sekret i Ushtrisë Shqiptare për Kosovën – Sipas dëshmive të gjeneral Veli Llakës, Enver Hoxha në vitet '70 kishte përgatitur një plan konkret për ndihmën ushtarake ndaj Kosovës në rast të krijimit të kushteve ndërkombëtare të favorshme. Plani parashikonte çlirimin e territoreve brenda 6 orësh nëse nuk ndërhynte asnjë fuqi tjetër.

Pas 1990-ës: Shkatërrimi sistematik i gjithçkaje komb-ëtare

Viti 1989 shënon fillimin e një periudhe tragjike për kombin shqiptar. Nën parullën "Të shkatërrojmë komunizmin", u dogjën mbi 600 fabrika, u zhdukën kooperativat, u prenë 600,000 rrënjë ullinj dhe u shkatërrua ekonomia shqiptare. Sloganet e rrejshme për "liri" sollën varfëri, zbrazje dhe shpopullim.

Sot jemi më pak se 1.5 milion shqiptarë në Shqipëri dhe më pak se 3.5 jashtë milion në gjithë hapësirën shqiptare. Sipas çdo logjike demografike dhe zhvillimore, duhet të ishim mbi 13 milion shqiptarë në Ballkan. Por mohimi i trashëgimisë kombëtare dhe përulja ndaj ideologjive të huaja na ka sjellë në këtë gjendje.

Enciklopedia Britanike e vitit 2004 e përmend Enver Hoxhën si "udhëheqësin komunist të Shqipërisë" – pa e quajtur as diktator, as tiran. Sepse historia e drejtë, vonon, por nuk harron.

Kopenhag,10 maj 2025

TË NDERUAR BASHKATDHETARË SHPIFJET DHE TRILLIMET NDAJ ENVER HOXHËS NUK JANË AS PAK TË VËRTETA!

Të nderuar bashkatdhetarë shpifjet dhe trillimet ndaj Enver Hoxhes nuk janë as pak të vërteta! - Ata që dikur kanë qenë kundër Shqipërisë dhe shqiptarëve janë shkatërruar nga vetë forca e së vërtetës dhe nga qëndresa jonë kombëtare!
Mos u mashtroni nga gazetat dhe portalet e verdha, ku neofashistët, hedhin helm dhe shpifje ditë e natë!
Janë mbushur tonelata librash me gënjeshtra dhe trillime. Janë shpenzuar mijëra, ndoshta miliona orë debate televizive nga borgjezia reaksionare fashiste, që nuk prodhon asgjë tjetër përveç tradhtive kundër interesit kombëtar shqiptar!
Unë vetë kam financuar botimin e librit të Shefit të Shtabit të Ushtrisë Shqiptare, gjeneral Veli Llakës"Operacioni Shpetimi-një dokument historik që tregon se si 800.000 ushtarë, brenda vetëm 6 orësh, ishin gati të vendosnin nën kontroll çdo pëllëmbë të territoreve shqiptare deri te Molla e Kuqe.
Dhe sot, unë i thërras publikisht këta shpifës ordinerë - qoftë ata që mbahen si "akademikë", qoftë ata që vetëquajturit, "analistë" - të dalin me mua, ballë për ballë në debat!
Le të ballafaqohemi me faktet, le të përballemi me të vërtetën historike dhe me figurat e mëdha të kombit, nga heronjtë modernë e deri te Leka i Madh.
Shqiptari i vërtetë nuk frikësohet nga shpifjet. Shqiptari i vërtetë ecën me kokën lart, e mbron të vërtetën me guxim, me dashurinë e atdheut në zemër!

Qerret, Kavajë¨-15 gusht 2025

NDËRHYRJA SERBE NË KOSOVËN VERIORE: NJË STRATEGJI PËR NDARJEN E KOSOVËS DHE SAKATOSJEN E TROJEVE SHQIPTARE

Ndërhyrjet e vazhdueshme të Serbisë në veri të Kosovës nuk janë thjesht tensione të përkohshme apo reagime ndaj zhvillimeve lokale.
Ato përfaqësojnë një strategji të mirëfilltë, të menduar gjatë, që synon ndarjen *de facto* të Kosovës dhe, më gjerë, dëmtimin e strukturës territoriale dhe etnike të trojeve shqiptare në Ballkan.
Veriu i Kosovës është bërë qendra e një lufte hibride që Serbia ushtron për të ruajtur ndikimin dhe kontrollin në një zonë që ajo kurrë nuk e ka pranuar si pjesë të një shteti të pavarur të Kosovës.

Një projekt i vjetër – një qëllim i ri
Që nga përfundimi i luftës në Kosovë dhe shpallja e pavarësisë më 2008, Serbia ka refuzuar të heqë dorë nga ambiciet e saj territoriale.
Por ndërhyrja në veri nuk është thjesht një çështje e statusit të serbëve lokalë. Ajo është pjesë e një projekti të ri -aktualizuar që synon ndarjen etnike të Kosovës, përmes krijimit të një entiteti serb të modeluar sipas Republikës Sërpska në Bosnje, që në fakt do të ishte një hap drejt shkëputjes territoriale.
Kjo përpjekje për ndarje nuk është vetëm një sulm ndaj integritetit territorial të Kosovës, por një sulm më i gjerë ndaj trojeve shqiptare në Ballkan.
Me synimin e saj për të destabilizuar Kosovën dhe për të krijuar një precedent ndarjeje, Serbia mban gjallë idenë e një "botë serbe", ku territoret me popullsi serbe duhet të jenë pjesë e një shteti të vetëm.
Sanxhaku në shënjestër

Ndërkohë që veriu i Kosovës përballet me tensione të shtuara, një tjetër rajon me shumicë shqiptare – Sanxhaku – ndodhet nën presion të ngjashëm. Serbia e sheh Sanxhakun jo vetëm si një zonë strategjike mes Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë qendrore, por edhe si një territor që duhet izoluar, mbajtur nën kontroll dhe shtypur identiteti shqiptar atje.

Shteti serb i trajton shqiptarët e Sanxhakut si një "kërcënim të heshtur", duke u përpjekur ta mbajë këtë krahinë të nënshtruar përmes presioneve politike, ekonomike dhe kulturore.

Pazaret e "Planit Paqësor" – Kostoja e një mashtrimi

Në këtë lojë të rrezikshme, një rol të errët po luajnë edhe pazaret e brendshme politike. Opozita në Kosovë, e etur për të fituar kapital politik dhe për të dobësuar qeverinë aktuale, po përdor çështjen e veriut për të krijuar kaos institucional, pa ofruar zgjidhje reale. Nga ana tjetër, qeveria serbe, në koordinim me segmente ndërkombëtare të interesuara për "stabilitet të rremë", po promovon një të ashtuquajtur "plan paqësor".



Ky plan, që në thelb legjitimon ndarjen de facto të Kosovës përmes krijimit të një asociacioni me kompetenca ekzekutive për komunat me shumicë serbe, po i paraqitet opinionit publik si "zgjidhje e përhershme". E gjithë kjo për të ndërtuar një iluzion: Serbia do të pretendojë se e ka arritur qëllimin – ndarjen e Kosovës – ndërsa udhëheqës të papërgjegjshëm në Kosovë do të trumbetojnë se "ja, Serbia na njohu pavarësinë".

Kjo është një lojë djallëzore, një mashtrim i rrezikshëm që synon të shuajë përfundimisht ëndrrën e Kosovës sovrane dhe të bashkuar. Njohja e pavarësisë në letër, nëse vjen përmes ndarjes, është në fakt mohimi më i madh i asaj që përfaqëson shteti i Kosovës: një shtet i unifikuar, i pandarë dhe i barabartë për të gjithë qytetarët e tij.

Koha për qasje të vendosur

Përballë këtij rreziku, është koha që institucionet e Kosovës dhe shqiptarët në përgjithësi të përballen me realitetin: Serbia nuk ka hequr dorë nga pretendimet e saj territoriale, dhe pa një reagim të fortë politik, diplomatik dhe strategjik, do të vazhdojë të avancojë agjendën e saj përmes destabilizimit.

Shqiptarët në të gjitha trojet duhet të jenë të bashkuar në kundërshtimin e kësaj strategjie ndarëse. Nuk është vetëm Kosova që është në shënjestër – është një plan më i gjerë që synon të minojë unitetin kombëtar dhe të reduktojë ndikimin e shqiptarëve në Ballkan.

Kopenhagë, 12.05. 2025

NGJARJET POLITIKE DHE KEQINTERPRETIMET PUBLIKE: NJË QASJE KRITIKE?!

Diskursi politik shqiptar, veçanërisht në hapësirën publike mediatike post-konfliktuale, shpesh karakte-rizohet nga keqinterpretime, reduktime analitike dhe personalizime politike që e kanë dëmtuar dhe dëmtojnë analizën serioze politike. Siç argumenton, Jürgen Habermas në teorinë e sferës publike, "Kur mungon racionaliteti komunikativ, debati publik rrëshqet nga argumentimi kritik drejt polemikës emocionale dhe propagandës Me këtë shkrim synoj të sqarojë disa pretendime, të pasakta që duke ruajtur një ton kritik, por të mbështetur në analizë historike dhe politologjike.

Donika Gërvalla, pati thënë se Ibrahim Rugova është Václav Havelit i Kosovës! Unë pata reaguar bile edhe përmes TV Koha në Tetovë, pata thënë se ky krahasim është problematik dhe historikisht i pasaktë. Sipas literaturës mbi disidencën në Evropën Lindore (Timothy Garton Ash), Vaslav Havel, përfaqësonte modelin klasik të disidentit moral, i cili veproi jashtë dhe kundër sistemit totalitar, duke përballuar burgosje dhe represion të drejtpërdrejtë.



(Foto sa njëmij fjal)

Në të kundërtën, Ibrahim Rugova ka vepruar brenda një sistemi politik që ishte pjesë e Jugosllavisë "Socialiste" në fakt revizioniste me një regjim brutal, strukturalisht diskriminues ndaj shqiptarëve, ku ai ishte anëtar i LKJ/LKK. -Barazimi i këtyre dy figurave përbën jo vetëm një pasaktësi historike, por edhe një deformim konceptual të nocionit të disidencës politike të brendshme, konkurrenca dhe legjitimiteti procedurial (Schumpeter, Capitalism, Socialism and Democracy). -Në rastin e themelimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në fund të vitit 1989, ky standard mbetet objekt debati kritik në historiografinë dhe publicistikën politike shqiptare. Konteksti historik është thelbësor: pas suprimimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989, regjimi i Sllobodan Milosheviqit kontrollonte rreptësisht jetën politike, institucionale dhe mediatike në Kosovë (Noel Malcolm, "Kosovo: A Short History"; Miranda Vickers, "Between Serb and Albanian).

-Në këto rrethana, formimi i LDK-së u tolerua si formë e opozitarizmit oportunist paqësor në favor të Serbisë Fashiste, në kundërshtim me rezistencën radikale ilegale. Sipas disa argumenteve kritike të asaj periudhe, Ibrahim Rugova nuk u zgjodh përmes një procesi pluralist konkurrues, por u zgjodh si figurë e përkohshme "përbashkuese" e ca qarqeve servile brenda vendit dhe si figurë e pranueshme edhe për regjimin e Beogradit,-si dhe për një pjesë të diplomacisë perëndimore të akredituar në Beog-rad. Autori britanik, Tim Judah "Kosovo: War and Revenge" dhe analistë të tjerë vërejnë se Perëndimi, asaj kohe parapëlqente figura që garantonin stabilitet dhe shmangie të luftës së hapur, të drejtpërdrejtë me Beogradin. Roli i diplomacisë amerikane dhe evropiane në Jugosllavi në fundin e Luftës së Ftohtë është i dokumentuar gjerësisht; Sabrina P. Ramet, "Balkan Babel" ku, strategjia dominante ishte ruajtja e integritetit territorial të Jugosllavisë dhe mbështetja e aktorëve politikë që përgatisnin ndryshim gradual. Në këtë kuadër,

mbështetja ndërkombëtare ndaj Ibrahim Rugovës, duhet kuptuar si pjesë e një strategjie gjeopolitike atëbotë, në horizonte më të gjëra, për të nesërmen e politikave të diktatit të tyre, por jo apriori domosdoshmërisht, si produkt i një procesi demokratik klasik autokton shqiptar. Këto referenca historike nuk synojnë de legjitimimin e mbështetjes të një pjese të shoqërisë që LDK-ja fitoi më vonë, ku pikërisht midis këtyre ithtarëve fanatikë do shohim "Kuvendin e Karrigeve", por shërbejnë për të thyer mitologjizimin e procesit themelues, për të vendosur debatin në binarë analitikë, ku dallohen qartë rrethanat autoritare, interesat ndërkombëtare dhe format e lejuara të opozitarizmit politik në Kosovën e pas vitit 1989. Gabimet politike dhe standardet e dyfishta?!

-Megjithatë, në diskursin publik duhet të bëhet dallimi mes gabimeve politike dhe akuzave të rënda e të pabazuara.

-Në këtë kontekst, deklaratat e Ramush Haradinajt dhe Daut Haradinajt, të cilët e kanë quajtur Kryeministrin Albin Kurti "Agjent të Serbisë dhe Rusisë", përbëjnë shpifje politike të pafalshme dhe jashtë çdo norme demokratike.Figura e Enver Hoxhës dhe debati ideologjik?!

-Në hapësirën publike shqiptare është konsoliduar një prirje revizioniste, shpesh e paargumentuar shkencërisht, për të reduktuar dhe mohuar figurën e Enver Hoxhës; në një karikaturë ideologjike.

-Siç paralajmëron historiani Eric Hobsbawm, "Revizionizmi i pakontrolluar historik shndërrohet në instrument politik dhe humbet funksionin e tij kritik shkencor". Një qasje e tillë nuk i shërben as historio-grafisë serioze dhe as debatit racional.

-Paradoksi qëndron në faktin se, shumë nga kritikët më të zëshëm të Enver Hoxhës –si Sali Berisha, Ramiz Alia, Ismail Kadare dhe të tjerë kanë qenë ndër më të privilegjuarit e sistemit gjatë pushtet popullor.

Kjo kërkon një analizë sociologjike të elitave politike, konstaton, Vilfredo Pareto; C. Wright Mills, e cila tregon se, "Rotacioni i

elitave shpesh ruan interesat strukturore, pavarësisht ndryshimeve ideologjike të deklaruara". Formimi politik i Donika Gërvallës dhe çështja kombëtare?!

-Donika Gërvalla është formuar dhe edukuar në shkollat e periudhës së Shqipërisë Socialiste, në kohën e Enver Hoxhës. Ky fakt historik nuk mund të mohohet dhe as të përdoret në mënyrë të njëanshme. Me kalimin e kohës, ajo do ta kuptojë "më thellë", realitetin historik dhe politik dhe ashtu, siç ka ndodhur me shumë të tjerë deviatorë-revizionistë, sipas mendimit të saj do të zhurmojë për "Të vërtetën e hidhur", për Shqipërinë dhe shqiptarët gjatë sistemit socialist, "Nën sundimin e diktatorit, Enver Hoxha".

-Mos të harrojmë faktet historike se, Enver Hoxha, pavarësisht debatit ideologjik që e shoqëron, luftoi dhe punoi për unitetin dhe përparimin e Shqipërisë dhe të kombit shqiptar, për mbrojtjen dhe për ribashkimin e trojeve etnike shqiptare. -Megjithatë, për aq kohë sa kohë që Donika Gërvalla të mbrojnë interesat kombëtare, me Albin Kurtin, në koalicion me VV, duke drejtuar partinë Guxo, derisa po veprojnë kundër armiqve të përbetuar të shqiptarëve, përkrahja ndaj tyre është plotësisht e arsyeshme politikisht. Gjykata Speciale dhe përgjegjësia politike?!

-Në lidhje me Gjykatën Speciale, kam qenë ndër të parët që e kam kundërshtuar publikisht, si veprimtarë politikë në organizatat dhe në jetën politike daneze. Përmes "Radios Kosova" të gazetarit Demir Reshiti, e kam argumentuar rrezikun që pranimi i kësaj gjykate paraqiste rrezik për UÇK-n Heroike dhe për historinë e Luftës Çlirimtare. Megjithatë, përgjegjësia kryesore bie mbi elitën politike të kohës në Kuvendin e Kosovës –Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Isë Mustafën dhe bashkëpunëtorët e tyre – të cilët, për shkak të kokëfortësisë dhe interesave personale, mashtruan ose i shantazhuan 82 deputetët e Kuvendit të Kosovës, të cilët e ngarkuan barrën e rëndë të etiketimit dhe të dyshimit të "krimeve" të UÇK-së gjatë LÇ-re?!!!

Në një shtet funksional me Drejtësi të mirëfilltë, këta politikanë do të duhej të përballeshin me Drejtësinë në Kosovë; për krime politike, ekonomike e të tjera; me ç'rast Drejtësia shtetërore do ta vërtetonte, janë fajtorë, apo nuk janë?!

Përfundim: Debati politik kërkon saktësi me argumente historike, ndershmëri intelektuale dhe përgjegjësi morale. -Siç thekson Hannah Arendt: "Shkatërrimi i së vërtetës faktike është parakusht për degradimin e politikës në manipulim".

-Prandaj, pa këto parime themelore, diskursi publik shqiptar dje, sot dhe nesër; rrezikon të mbetet peng i emocioneve dhe të interesave afatshkurtra dhe të "historive" të njëanshme, duke u larguar nga funksioni i tij emancipues dhe kritik në shoqëri.

Kopenhagë,10 janar 2026

ROLI REAKSIONAR KUNDËR INTERESAVE SHQIPTARE I STRUKTURAVE PRO-SERBE QË U RRESHTUAN PAS IBRAHIM RUGOVËS DHE LDK-SË?!

Një nga çështjet më të debatuara në historiografinë bashkëkohore të Kosovës mbetet roli që luajtën ish-aktivistët, zyrtarët dhe bashkëpunëtorët e institucio-neve jugosllave në procesin e formimit dhe kontrollimit politik të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe të Ibrahim Rugovës si figurë politike dominuese në fillim të viteve '90-ta.

Ekziston një konsensus i gjerë në literatura të caktuara kritike se, strukturat e ish-aparatit jugosllav – nëpër ambasada, qendra diplomatike, ish-organet e sigurimit (UDB-ës) dhe rrjetet administrative – u rreshtuan pothuajse në mënyrë të sinkronizuar pas LDK-së.

Ky fenomen politik, sipas këtyre analizave, krijoi një kanal ndikimi tejet negativ që nuk ishte në linjë me interesat kombëtare shqiptare, por me stabilitetin e situatës politike të Beogradit në periudhën e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë titiste.

Së pari, fakti se, Ibrahim Rugova nuk u zgjodh në një proces të pastër pluralist e konkurrues, por u emërua si figurë qendrore në LDK-ja, nga një rreth i ngushtë intelektualësh dhe zyrtarësh reaksionarë të lidhur me strukturat e vjetra institucionale jugosllave, me të drejtë ka shtyrë shumë atdhetarë të argumentojnë se legjitimiteti i tij fillestar ishte më tepër si produkt i rrethanave politike, sesa i vullnetit popullor.

1. Ky konstatim përforcohet nga dokumentet e kohës që tregojnë se brenda Kosovës, për disa kohë, nuk u lejua asnjë opsion tjetër politik konkurrues, për shkak të represionit serb dhe kapjes së institucioneve publike, të cilat në një mënyrë apo tjetër favorizonin figura jo-konfliktuoze, fjala vjen atëbotë u keqtrajtua dhe u ndalua të vepronte në legalitet politologu, i madh, Ukshin Hoti dhe Partia e Unitetit Kombëtar. (PUK) , pastaj, u ndaluan dhe

parti të tjera përparimtare që dikur që nga vitet 60-70- ta, kishin vepruar ilegalisht, kundër regjimit titist jugosllav.

2. Dokumentet e periudhës jugosllave tregojnë qartë se, ambasadat jugosllave kishin një rol aktiv në mbajtjen nën kontroll të komuniteteve shqiptare jashtë vendit.

3. Një numër i konsiderueshëm funksionarësh të këtyre ambasadave – të cilët më parë
kishin vepruar si instrumente të politikës serbo-jugosllave – u pozicionuan si aktivistë apo ndërmjetës të LDK-së në mërgatë.
-Kjo lëvizje, sipas interpretimit kritik përparimtar, përfaqësonte komplet një vazhdimësi të strukturave kontrolluese jugosllave, të cilat e konsideronin, Ibrahim Rugovën si figurë të përsht-atshme për stabilitetin e tyre, për shkak të politikës së tij të butë dhe reaksionare të shmangies nga konfrontimi me Serbinë Fashiste të Sllobodan Millosheviqit.

4. Efekti i këtyre strukturave mbi interesat e shqiptarëve rezultoi prapakthyes në disa drejtime: në planin politik, dominimi i LDK-së si e vetmja forcë e "lejuar" ndikoi në frenimin e organizimit politik më radikal dhe të vendosur, duke larguar për një kohë të gjatë rrugën e rezistencës së armatosur.

5. Në planin diplomatik, orientimi i tepruar drejt kompromiseve (lëshimeve) të rënda; e zvarriti përpjekjen për ndërkomb-ëtarizimin e çështjes së Kosovës, deri në mesin e viteve '90-ta.

6. Në planin social, rrjetet pro-serbe që u ricikluan brenda strukturave të LDK-së, mbajtën gjallë logjikën e përçarjes, kontrollit dhe depolitizimit të shoqërisë shqiptare, duke vonuar konsolidimin e një uniteti politik të qëndrueshëm.

7. Vet fakti që shumica e figurave kyçe të asaj kohe kishin kaluar nëpër institucionet jugosllave – nga Lidhja Komuniste e deri tek administrata kulturore dhe diplomatike – e shpjegon pse shumë prej tyre u rreshtuan automatikisht pas opsionit më të pranueshëm për Beogradin, që ishte LDK-ja dhe Ibrahim Rugova.

Në këtë kuptim, ndikimi i këtij rreshtimi duhet kuptuar si një

përdorim politik i trashëgimisë së LKJ-së jugosllave, jo si përzgjedhje e një partie të vërtetë demokratike.

Në këtë prizëm, roli i këtyre strukturave me të drejtë mud të konsiderohet reaksionar; sepse, shërbeu për: pengimin e skenarëve të rezistencës aktive, orientimin e procesit politik drejt pritjes së pafundmë dhe pacifizmit pasiv, të kontrolluar nga një kastë qyqarësh politikë dhe ushtarakë, ruajtjen e një stabiliteti të tmerrshëm në robëri klasike, që i shërbente Beogradit, e, jo, aspak Kosovës;

fragmentimin e elitës shqiptare, përmes infiltrimit dhe lojës me influencat e jashtme regresive.

Pikërisht, për këto arsye, shumë analiza bashkë-kohore argumentojnë se rreshtimi i ish-strukturave pro-serbe pas Ibrahim Rugovës nuk ishte thjesht një proces i paorganizuar mirë nga qarqet armike të Kosovës, nuk ishte një politikë as ekonomike spontane, por një ndërthurje interesash që shpesh ishte kundër interesave kombëtare të shqiptarëve.

8. Strukturat pro-serbe dhe dëmi i tyre strategjik ndaj interesave shqiptare (në versionin më kritik)



(Foto sa njëmij fjal.)

-Njëra nga elementet më pak të shqyrtuara, por më të rëndësishme për ta kuptuar kolapsin politik të shqiptarëve në fillim të viteve ’90, është dhe fakti se një pjesë e madhe e strukturave politike, administrative dhe diplomatike të ish-Jugosllavisë – veçanërisht ato me profil pro-serb – u ricikluan pothuajse pa ndërprerje dhe u rreshtuan masivisht pas Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Ibrahim Rugovës.

Ky fenomen nuk ishte as rastësi, as evolucion i natyrshëm politik: ishte vazhdimësi direkte e ndikimit serb në politikën kosovare, një mekanizëm kontrolli i vjetër i shndërruar kinse, në “mbështetje demokratike”. Ky rreshtim pati pasoja të thella dhe prapakthyese për interesat kombëtare gjithë-shqiptare.

Së pari, siç theksova më lart; është fakti se Rugova u shfaq në krye të LDK-së jo si produkt i një konkurrimi politik, por si figurë e emëruar nga një rreth i mbyllur intelektualësh dhe burokratësh të rritur brenda aparatit jugosllav, e krijoi menjëherë një arkitekturë të brishtë legjitimiteti.

Në rrethana normale, një proces i tillë do të konside-rohej defekt demokratik; në Kosovën e viteve ’90, ai u shndërrua në mekanizëm kontrolli autoritar, të njëfarë kulti amorf, krejt pa merita…

Pikërisht, për këtë arsye strukturat pro-serbe e kapën Ibrahim Rugovën si figurë ideologjikisht të “de-politizuar”, të padëm-shme dhe të organizuar– një “udhëheqës i përshtatshëm”, për interesat e Beogradit në një kohë të shpërbërjes të shtetit jugosllav. Në fakt ata e kishin marionetën e tyre, në Prishtinë të kamufluar si demokrat.

-Së dyti, rreshtimi i ish-funksionarëve të ambasadave jugosllave përreth LDK-së ishte një sinjal alarmi që u neglizhua me kohë. Këta individë kishin shërbyer për vite me radhë në një sistem diplomatik që ishte historikisht i infiltruar nga shërbimet sekrete jugosllave dhe serbe. Pasi regjimi i Millosheviqit, ngriti nivelin e terrorit ndaj popullit të Kosovës, një pjesë e këtyre zyrtarëve u pozicionuan me dinakëri, kinse si ndërmjetës politik, si “Njohës

dhe miq të Perëndimit", si organizatorë të mërgatës dhe si mbështetës të LDK-së.

-Kjo lëvizje nuk ishte naive: Serbia kishte interes që komunitetet shqiptare të jashtme të mos radikalizoheshin, të mos shndërr-oheshin në burim presioni ndërkombëtar dhe të mos financojnë modele të rezistencës, madje as paqësore aktive.

Së treti, efekti reaksionar i këtij infiltrimi u pa qartë në tri fusha:

1. Në planin politik, strukturat pro-serbe sabotuan sistematikisht çdo iniciativë që dilte jashtë kontrollit të tyre. Çdo alternativë tjetër politike – qoftë më radikale, qoftë më moderne paqësore – etiketohej menjëherë si "rrezik", "provokim", ose "shkëputje nga miqtë perëndimor".

Kjo strategji prodhoi 10 vjet vendnumërim (stagnim) politik, ku populli shqiptar u udhëhoq nga një elitë hibride e përzgjedhur, jo e zgjedhur.

2. Në planin ndërkombëtar, dëmi ishte edhe më i madh. Rrjeti i ish-diplomatëve, spiunëve pro-serbë propagandoi në qendrat perëndimore dogmën se, "Stabiliteti në Kosovë" dhe firorja ishte i lidhur me pacifizmin e LDK-së. Kjo strategji boshe e zvarriti shumë gjatë, ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës deri në momentin kur Serbia kishte kryer tashmë krime masive dhe spastrime etnike. Për vite të tëra, Perëndimi u ushqye së koti me gënjeshtra të kulluara, kinse çështja e Kosovës do të zgjidhej "me laps" pa luftë, të nga ish-struktura jugosllave, jo nga realiteti i represionit brutal në terren.

3. Në planin shoqëror, ky rreshtim i strukturave të vjetra krijoi një elitë politike që riprodhoi mentalitetin jugosllav të kontrollit, konformizmit dhe nënshtrimit. LDK-ja u mbush me individë që, për vite me radhë, kishin shërbyer në misione pro-serbe të Jugosllavisë. Rezultati ishte i pashmangshëm: përçarje në elitën shqiptare, neutralizim i energjisë së rezistencës dhe krijimi i një kulture të frikës nga konfrontimi.

Në këtë kuptim, rreshtimi i strukturave pro-serbe pas Ibrahim Rugovës nuk ishte as mbështetje politike, as bashkim kombëtar.

Ishte transformim i një aparati të vjetër kontrollues në një maskë të re politike, që shërbeu për të frenuar sqarimin (emancipimin) e vërtetë politik të shqiptarëve dhe për të zgjatur jetën e ndikimit serb në Kosovë. Kjo është pasojë e madhe historike që duhet pranuar, studiuar dhe artikuluar pa frikë.

FUSNOTAT

Noel Malcolm, Kosovo: A Short History, London: Macmillan, 1998, 327–331.
Sabrina P. Ramet, The Three Yugoslavias, Bloomington: Indiana University Press, 2007.
Albert Doja, "The Politics of Identity in Kosovo: Continuity and Change," East European Politics and Societies, nr. 4, 2009.
British Foreign Office Papers on Yugoslavia (1989–1991), arkivi i diplomacisë britanike.
K. Dawisha & B. Parrott (red.), Politics, Power and the Struggle for Democracy in South-East Europe, Cambridge University Press, 1997.
Rexhep Qosja, intervistë në Republika, nr. 3 (1991).
Anna Di Lellio (red.), The Case for Kosova: Passage to Independence, London: Anthem Press, 2006.
James Pettifer, Kosovo Express, London: Hurst, 2005.
14.11. 2025 Kopenhag

(Një argument shtes)

CLINTON – RUGOVA- JA EDHE NJË ARGUMENT SHTES!

[Më 29 maj 1998 Ibrahim Rugova, i shoqëruar nga Bujar Bukoshi dhe Veton Surroi, pritet nga Presidenti Bill Clinton.
Në vazhdim fragmenti nga ajo bisedë:]

PRESIDENTI CLINTON:
Unë do të dëshiroja të dija edhe mendimin tuaj rreth konceptit të Shqipërisë për problemin për të cilin flasim [për problemin e Kosovës].
Ne mendojmë se është koncept modern dhe si të tillë e përkrahim.

"PRESIDENTI" RUGOVA:
Në Kosovë, qeveria e tashme shqiptare, flas në mesin e popullit të Kosovës nuk gëzon respekt. Janë shumë shkaqe, por populli mendon se ajo bën punë të papastërta, pikërisht në krahun serb. Ndërsa, e vërteta, për mendimin tonë është krejt tjetër.

PRESIDENTI CLINTON:
Si është tjetër? Pra, është në krah të kundërt me qëndrimin serb dhe unë këtë e gjejë të mirë!

"PRESIDENTI" RUGOVA:
Qeveria e Shqipërisë, pra kjo qeveri që është sot, mendoj unë, por edhe shokët e mi [Bujar Bukoshi dhe Veton Surroi] kështu mendojnë, është krejtësisht në krahun e grupeve të armatosura. Ajo mund të jetë frymëzuese e tyre, ndoshta edhe organizatore.

PRESIDENTI CLINTON:
Përse e keni këtë mendim?
Të dhënat tona, dhe burime të tjera nuk e tregojnë këtë.

"PRESIDENTI" RUGOVA:
Ka lidhje kohore mes gjithçkaje që po ndodh sot në Kosovë dhe Shqipëri.
Kur në pushtetin shqiptar ishin forcat e djathta [Sali Berisha], me të cilin ne kemi bashkëpunuar nga fillimi; edhe në Kosovë kishte gjendje tjetër. Grupe të armatosura në Kosovë përgjithësisht kanë pikëpamje të majta, pra, janë nga ata që kanë patur ide të majta, drejtohen nga njerëz që edhe sot e kësaj dite kanë nostalgji për ish figura të njohura komuniste. Si për shembull, për Enver Hoxhën i cili ka qenë diktator i madh Komunist.
Ka tani një lidhje, sepse grupe të armatosura shpërthyen pikërisht me shumicë, kur socialistët erdhën në pushtet.

PRESIDENTI CLINTON:
Nuk ka shkaqe të tjera të gjendjes?

"PRESIDENTI" RUGOVA
Ka edhe të tjera, por qeveria e Shqipërisë, zoti Nano, lojën e ka jo të pastër. Prandaj edhe marrëdhëniet tona me të, marrëdhëniet e mia me të, janë ngrirë. Nga Shqipëria janë futur armë edhe mjete të tjera. Futen njerëz, futet gjithçka. Kjo e radikalizoi gjendjen dhe mund të shkojë edhe më tutje drejt eskalimit.

PRESIDENTI CLINTON:
Ne kemi mendimin se në Shqipëri po punohet mirë, për problemin e Kosovës. Ata nuk po ndezin nga zjarri i vogël një zjarr të madh.

"KRYEMINISTRI" BUKOSHI [ndërhynë]:
Nuk duhet me pas besim të madh tek qeveria shqiptare. Unë, kam pas takime me to fill pas takimit të Nanos me Milosheviqin në Kretë, takim që është pritë me indinjatë në Kosovë.

PRESIDENTI CLINTON [ndërpret Bukoshin]:
Mendimi im është se kanë bërë mirë që janë takuar. Të jetosh në Ballkan dhe të mos flasësh me njeri - tjetrin, qoftë dhe për diç të zakonshme, është kundër rrjedhave. Vlerat demokratike nuk mbrohen me izolim. Edhe mendimi civilizues nuk ecën me ngrirje.

"KRYEMINISTRI" BUKOSHI:
Unë kam marrë takim me ta pas takimit në Kretë. Kreta ishte alibi për Nanon për faktin se ai ka lidhje të forta, të hershme, me ata që po realizojnë luftën në Kosovë. Lidhjet e tij datojnë prej disa vitesh.

VETON SURROI:
Veshja e jashtme e politikës së Nanos është moderne, thelbi është nacionalist.

PRESIDENTI CLINTON:
Ju duhet të takoheni me Nanon. Nëse qeveria e tanishme në Shqipëri ndihmon aktivisht në luftën që zhvillohet në Kosovë, nuk bën mirë, por mundësitë e saj janë të pakta për gjendjen që është atje. Mendoj për mundësitë që kanë ata për të marrë veten pas ngjarjeve të një viti më parë. Ata kanë problemet e tyre, por nuk duhet tu shtojmë edhe të tjera, ato tonat.
Ne do t'i përkrahim ata, sidomos për vizionin e qartë për problemin e Kosovës.

"PRESIDENTI" RUGOVA:
Zoti president, unë kam biseduar me zonjën Ollbrajt, edhe zotit Gelbard ia kam thënë se Nano nuk bën lojë të pastër, por kontaktet do t'i kemi më të rregullta.

PRESIDENTI CLINTON:
Do të ishte mirë të veprohej kështu. Të mos krijohen probleme të tjera në Shqipëri.

"PRESIDENTI" RUGOVA:
Nga ana jonë do të mundohemi. Por në Kosovë, rikthimi i Berishës në drejtimin e Shqipërisë do të pritej mirë.

PRESIDENTI CLINTON:
Ujrat nuk kalojnë dy herë nën të njëjtën urë. Do të isha po ashtu i interesuar të di se çfarë proporcionesh keni në marrëdhëniet me shqiptarët në Maqedoni dhe me institucionet e shtetit Maqedonas…

[Huazuar nga Institute for Economic Policy Research and Analyses (INEPRA).]

NGA LIDHJA KOMUNISTE NË LIDHJEN DEMOKRATIKE – E NJËJTA FYTYRË E VJETËR E DHUNËS.

Nga Lidhja Komuniste në Lidhjen Demokratike – e njëjta fytyrë e vjetër e dhunës
Rasti i Armend Zemajt nuk është një incident i rastësishëm, por pasqyra e një kulture të poshtër politike që prej dekadash ushqehet me arrogancë, dhunë dhe trashëgimi shoviniste kundër-shqiptare!
Në qendër të Prishtinës, deputeti i LDK-së Armend Zemaj është përfshirë në një akt të turpshëm dhune ndaj një qytetari të moshuar. Pamjet dhe dëshmitë që po qarkullojnë nuk tregojnë thjesht një nervozizëm momental, por një sjellje që rrënjët i ka thellë në mentalitetin e një partie që prej themelimit ka qenë strehë e ish-strukturave shoviniste dhe bashkëpu-nëtorëve të sistemit jugosllav.
Pas vitit famëkeq 1989, kur aparati i Lidhjes Komuniste të Kosovës u shpërbë, shumica e funksionarëve të saj nuk u zhdukën – ata thjesht u konvertuan.
N nga LKK në LDK, ndryshoi vetëm emri, ndërsa fryma e huaj shoviniste mbeti e njëjtë. Ish- zyrtarë e bashkëp-unëtorë të strukturave serbe, të njohur për shërbimin e tyre ndaj sistemit të vjetër, e gjetën strehën e tyre në Lidhjen Demokratike të Kosovës
–tashmë, të ricikluar si parti "demokratike".
Sot, kur një deputet i kësaj partie ngre dorën kundër një qytetari të moshuar, nuk kemi të bëjmë me një devijim individual, por me shfaqjen e asaj që LDK e ka kultivuar për dekada: arrogancën e pushtetit, mungesën e vetë-reflektimit dhe dhunën si mjet politik.
Kujtojmë se kjo frymë nuk është e re. Ajo u pa edhe brenda vetë LDK-së, në të ashtuquajturin "Kuvendi i Karrigeve", ku dhuna

fizike e verbale shpërtheu mes anëtarëve të partisë – një skenë që simbolizoi përfundimisht rrënimin moral të një subjekti që dikur pretendonte të përfaqësonte "maturinë" dhe "urtësinë" e popullit të Kosovës.

Sot, kur qytetarët kërkojnë llogaridhënie, përulësi dhe etikë publike, LDK vazhdon të tregojë se ende nuk është shkëputur nga hijet e së kaluarës. Rasti Zemaj është vetëm pasqyra më e fundit e një kulture që i përket së kaluarës – një kulture që Kosova demok-ratike nuk e meriton më.

Kopenhagë, 25 tetor 2025

TITISTËT E HOTEL "ROGNERIT" DHE DEFORMIMI I PROJEKTIT KOMBËTAR PAS LUFTËS ÇLIRIMTARE TË UÇK-SË.

Rezistenca paqësore albiniane dhe Lufta Çlirimtare e Kosovës (1997–1999), përfaqëson kulmin e rezistencës së shqiptarëve ndaj shtypjes serbe. Por, procesi politik dhe institucional pas luftës solli një deformim të qëllimeve thelbësore fillestare.

Në vend që të afirmohej projekti i ribashkimit kombëtar, Kosova u kap nga struktura politike të lidhura me trashëgiminë titiste, shpeshherë të mbështetura nga faktorët reaksionarë ndërkombëtarë, veçanërisht nga Franca dhe qarqe të afërta me Beogradin.

- Ky artikull analizon rolin e renegatëve të LÇ-re të "Grupit të Rognerit", ndërhyrjen e Agim Çekut dhe pasojat e infiltrimit të agjenturës së trashëgimisë të sigurimit serb në politikën e Kosovës.

Konteksti historik?!

Pas dështimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për të ndërkombëtarizuar çështjen e Kosovës nëpërmjet rezistencës paqësore pasive; kjo ide mashtruese në krye me Ibrahim Rugovën dështoi me turp.

Si feniks rilindi ideja dhe veprimtaria revolucionare për çlirim; e famshmja Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), e cila artikuloi me guxim në betimin e saj, - për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore dhe LBRSH të heroit Adem Demaçi; projektin e ribashkimit kombëtar nëpërmjet luftës së armatosur.

Por, fatkeqësisht, që në vitet 1998–1999, në Tiranë, në hotel "Rogner", në skenë doli një fraksion i cili synonte kontrollin politik të UÇK-së, duke nënvlerësuar dhe injoruar figurat kryesore të UÇK-së që realisht e kishin udhëhequr LÇ-re në terren.

"Mic Sokolat" e Rognerit!

Xhavit Haliti, Hashim Thaçi, Kadri Veseli e Fatmir Limaj, të vetëquajturit, shpeshherë "Mic Sokolat e Rognerit", përfaq-

ësonin linjën e turpshme të lëshimeve (kompromiseve politike dhe ushtarake, duke mos e zbatuar linjën e projektit kombëtar. Në kundërshtim me Adem Demaçin, Bislim Zyrapin dhe Dilaver Goxhajn, të cilët e shihnin UÇK-në si mjet për realizimin e ribashkimit kombëtar.

Ky grup famëkeq i "Rognerit" synonte të kontrollonte narrativen politike dhe të përfitonte nga mbështetja ndërkombëtare selektive.

Ndërhyrja franceze dhe ardhja e Agim Çekut në udhëheqje të UÇK-së?!

Një element vendimtar prapakthyes, ishte ardhja e Agim Çekut, një ish-oficer i Ushtrisë Jugosllave, në krye të UÇK-së. Çeku, u soll në Kosovë përmes kanaleve të mbështetura nga Franca e ideve reaksionare të "Bastijes", një shtet tradicionalisht i afërt me Beogradin. Vendosja e tij në krye të strukturave ushtarake solli margjinalizimin e Komandantëve që e kishin udhëhequr luftën në terren. Kështu, figura të spikatura, si Gjeneral, Bislim Zyrapi (Shef i Shtabit i UÇK-së) dhe Komandanti Kolonel, Dilaver Goxhaj (Shpëtim Golimi), zëvendësshef i Shtabit dhe koordinator me NATO-n, u denigruan nga strukturat e reja të pasluftës. Vrasjet politike dhe heshtja institucionale?!

Një nga shembujt më të qartë të këtij procesi ishte vrasja e Ekrem Rexhës, Komandant Drinit në oborrin e shtëpisë së tij pas luftës. Ky akt, i interpretuar gjerësisht si krim politik, mbeti pa autor të zbuluar. Prokuroria e Kosovës, e lidhur me strukturat e partive të dala nga grupi i Rognerit, nuk ndërmori asnjë hap serioz për hetim, për vrasjet, kidnapimet dhe zhdukjet; siç u sulmuan egërsisht, Ukshin Hotit, Behadin Hallaçi e të t tjerë veprimtarë të bashkimit kombëtar.

Trashëgimia e sigurimit serb

Një analizë më e thellë duhet të bëhet më tej; që të sqarojmë qartë dhe saktë; se, ky proces nuk ndodhi rastësisht. Për dekada me radhë, Serbia kishte kultivuar një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh përmes sigurimit shtetëror.

- Shumë familje, që punonin roje mali, roje fushe, drejtor, pronar Kafeneje e restorantesh, shoferë kamioni apo taksie, duhej të kishin lidhje me policinë serbe, këta puthadorë të armikut dhe pasardhësit e tyre; gjatë luftës, pa merita u emëruan me poste të larta në UÇK, si "Komandantë" dhe pas luftës, këta "trima" nga klikat e tyre u emëruan "Liderë politikë".

Kjo qe njëra nga mënyrat më të sofistikuara përmes së cilës Serbia arriti të imponojë ndikimin e saj edhe pas luftës. Kosova fitoi lirinë me gjak, por humbi projektin kombëtar pas luftës në tavolinat e politikës reaksionare përballë Serbisë dhe miqve të saj ndërkombëtarë. Titistët e Rognerit, të përkrahur nga faktorët reaksionarë ndërkombëtarë dhe të mbështetur nga trashëgimia e sigurimit serb, e deformuan qëllimin fillestar të UÇK-së, që u pasqyrua qartë te betimi i ushtarëve dhe Komandantëve të UÇK-së. Ky realitet i hidhur, ende mbetet plagë e hapur për kombin shqiptar, një sfidë për të ardhmen: si të çlirohet politika nga ndikimi i strukturave, që kurrë nuk i shërbyen idealit të ribashkimit kombëtar.

Referenca (për draftin)

Judah, T. (2000). Kosovo: War and Revenge. Yale University Press.

Demaçi, A. (2001). Deklarata publike mbi fragmen-tarizimin e UÇK-së. Arkivi i Kosovës.

Phillips, D. L. (2012). Liberating Kosovo: Coercive Diplomacy and U.S. Intervention. MIT Press.

Zyrapi, B. (2000). Raportet e Shtabit të Përgjithshëm të UÇ K-së. Arkivi i Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë.

Human Rights Watch (2001). Under Orders: War Crimes in Kosovo. New York.

Vickers, M. (1998). Between Serb and Albanian:History of Kosovo Columbia University Press,

Kopenhagë, 15.09.2025

Ka njëmijë mënyra për të tradhtuar popullin
Çfarë nënkuptojmë me "tradhti"?

Kur flasim për "tradhti" të popullit nga elitat, nuk qëndrojmë vetëm te morali individual; bëhet fjalë për një model institucional ku interesa private, kalkulime politike afatshkurtra dhe ndikime të huaja zëvendësojnë interesin publik.

- Në Ilirik (Ballkan) ky fenomen merr forma të ndryshme: mashtrim ekonomik që shkatërron kursimet e qytetarëve, marrëveshje politike të fshehta që tradhtojnë pritshmërine kombëtare, kapje të shtetit nga oligarkia dhe instrument-alizim i procesit të integrimit evropian.

1) Ekonomia si rrugë tradhtie: shembulli shqiptar i 1996–97

Një nga shembujt më të qartë kur ekonomia përdoret për të tradhtuar popullin është kriza e skemave piramidale në Shqipëri (1996–97).

Skemat premtuan kthime të jashtëzakonshme, u lidhën me pushtetin politik dhe thyen kursimet e masave të gjera — një shpërthim ekonomik që përfundoi me krizë shoqërore dhe rënie të besimit publik.

2) Marrëveshjet politike që lënë popullin jashtë tavolinës

Në proceset e normalizimit dhe negocimit (psh. mes Kosovës dhe Serbisë), vendimet e marra pas dyerve të mbyllura janë shpesh perceptuar si "marrëveshje të elitave" që nuk reflektojnë interesin ose vullnetin e qytetarëve.

3) Ideologji e "stabilitetit" si justifikim për kapitullim

Shqetësimi tjetër është instrumentalizimi i koncepteve si "stabiliteti", "paqja" dhe "integrimi" për të maskuar vendime që favorizojnë klasa të caktuara. Elitat argumentojnë se sakrificat kombëtare janë të domosdoshme, por shpesh këto shërbejnë për të mbuluar humbjen e hapave për interesin publik.

4) Kapja e shtetit dhe oligarkia

Një tjetër mënyrë e përhapur e tradhtisë është përmes "kapjes së shtetit": kur rrjetet e interesit ekonomik dhe politik infiltruar në

administratë, gjyqësor dhe media, përcaktojnë politikat publike për përfitime private.

5) Iniciativa rajonale dhe rreziku i "kompromisit të fshehtë"

Edhe projektet e marrëveshjeve rajonale (psh.nisma të lëvizjes së lirë të mallrave dhe njerëzve) mund të jenë të dobishme - por kur promovohen pa debat publik, mund të perceptohen si instrument për konsolidimin e influencave të fuqishme në rajon.

6) Si thyhet besimi dhe çfarë pasojash ur tradhtia bëhet model - kur qytetarët humbasin besimin te sistemi ekonomik, drejtësia dhe proceset politike — vijnë pasoja të thella: apati elektorale, radikalizim politik, emigrim i talentit dhe dobësim i rezistencës kombëtare.

"Njëmijë mënyra" për të tradhtuar popullin ekzistojnë si mostra të një realiteti, ku mungesa e transparencës, kapja e shtetit dhe kalkulimet politike afatshkurtra vijnë para interesit publik. Zgjidhja nuk është vetëm etike - është institucionale: forcim i medias së pavarur, reforma të gjyqësorit, mekanizma të qartë të llogaridhënies dhe procese vendimmarrjeje të hapura. Pa këto, tradhtia e popullit do të mbetet një rrezik i përhershëm për stabilitetin dhe zhvillimin e Ballkanit.

Burimet e referuara

– Raportet e FMN mbi krizat ekonomike në Shqipëri (1999)
– Analizat e Balkan Insight mbi marrëveshjet Kosovë–Serbi
– Studime mbi kapjen e shtetit dhe korrupsionin politik në Ballkan
– Raporte mbi nismat rajonale dhe transparencën institucionale

Kopenhagë, 23 tetor 2025

KOMENTI IM PËR ARTIKULLIN PERSONAL TË GËZIM MEKULIT

Të lumtë, Gëzim Mekuli!
Një përshkrim dhe një histori shumë rrëqethëse.
Këtë fat tragjik e kanë përjetuar shumë shqiptarë në ish-Jugosllavi!
Njëri ndër 'ta jam edhe unë, kur isha vetëm 18 -vjeçar, u torturova keq, i alivanosur nga milicia maqedonase dhe shqipfolëse; krimi im i vetëm ishte se, u isha dëshmitar i një vrasjeje ndaj një bashkëfshatarit tim, krejt të pafajshme në fshatin tim.
- E gjithë tragjedia ndodhi, kur Lidhja Komuniste e Kosovës – degë e Lidhjes Komuniste Serbe në Beograd – u shndërrua në Lidhje Demokratike të Kosovës.
- Avazi i keq u vazhdua, qëllimet e këqija mbetën të njëjta: luftë kundër të drejtave të popullit shqiptar, vetëm se tash me metoda dinake, të ashtuquajtura, "demokratike"!
- Shumë familje kanë qenë të detyruara të jenë bashkëpunëtor të policisë sekrete serbe si për shembull, roje fushe, drejtorë, pronarë kafeneje e restorantesh, pronarë edhe te kiosqeve, apo shitës të eblebijave, shoferë kamioni apo taksie, drejtorë nëper instucione e ndërmarrje të ndryshme, profesorë. klerikët fetarë patjetër që ishin ne shërbim të etj. duhej të kishin lidhje me policinë serbe, këta puthadorë të armikut dhe pasardhësit e tyre; gjatë luftës, pa merita u emëruan në poste të larta në UÇK, si "Komandantë" dhe pas luftës, këta "trima" nga klikat e tyre u emëruan "Liderë politikë".
Kjo qe njëra nga mënyrat më të sofistikuara përmes së cilës Serbia arriti të imponojë ndikimin e saj edhe pas luftës.
Ishte ai vit famëkeq 1989, kur një djalë i lig i një "neo-ballist", Dr. Ibrahim Rugova, i shkolluar në institucionet e UDB-së serbe,

i magjistruar dhe i doktoruar në Francë –i përgatitur mirë, u paraqit si udhëheqës politik i shqiptarëve në ish-Jugosllavi.
Por, dihej mirë se fëmijët e ballistëve nuk kishin të drejtë as të punësoheshin në detyra shtetërore, as si roje të objekteve apo pastrues, jo më të mbronin doktoratën jashtë vendit! E gjithë propaganda e kohës ishte e përqendruar në luftë kundër ribashkimit kombëtar.
Ata, që dhanë prova e sakrifica për bashkim kombëtar u izoluan dhe u luftuan. Në thelb, asgjë nuk ndryshoi, – përveç përdorimit të fjalës "liri", e cila në fakt kontrollohej mirë nga mediat, në mënyrë që populli të mos kuptonte rrjedhat dhe zhvillimet e vërteta politike një shembull të tillë shohim dhe udbash Mehmet Locin dhe mediat e Klan Kosovës, alias, të Klan Serbisë me të birin e udbashit, Adriatik Kelmendin & CO.

Kopenhagë, 15.05.2025

PARTITË SHQIPTARE NË MAQEDONINË E VERIUT: VEGLA TË REGJIMIT MAQEDONAS KANË RËNË NË HESHTJE PËR RACIZMIN INSTITUCIONAL?!

Ukshin Hoti, filozof i politikës shqiptare do thoshte – "BËJE…OSE VDIS!"
Ç'RËNDËSI KA PSE NA QENKA SHQIPTAR?!
- Është Kryekuvendari ish, apo ky i tanishmi?!
Maqedonia e Veriut është një shtet që ndërton identitetin e tij mbi mohimin e tjetrit–në veçanti ndaj popullit shqiptar autokton në trojet e veta, që sot përbën gjysmë e popullsisë.
- Në vend që të jetë shembull i bashkëjetesës multietnike, ky shtet është bërë "laborator" i diskriminimit dhe i racizmit të institucionalizuar, kundër shqiptarëve.
- Ironia më e madhe është se kjo gjendje mbahet gjallë jo vetëm nga elitat maqedonase, por edhe nga partitë politike shqiptare, të cilat prej dekadash funksionojnë si vegla qorre të pushtetit maqedonas dhe si garant i stabilitetit të një shteti të huaj, që i trajton shqiptarët si qytetarë të dorës së dytë.
Tradhtia e elitës politike shqiptare?!
- Partitë politike shqiptare në Maqedoninë e Veriut kanë humbur çdo funksion kombëtar. Në vend që të përfaqësojnë interesat e popullit të tyre, ato kanë zgjedhur të bëjnë pazare të pista për poste qeveritare dhe privilegje personale. Historia e dy dekadave të fundit është histori koalicionesh të turpshme, ku partitë shqiptare janë bërë fasadë, për çdo qeveri maqedonase, ndërsa shqiptarët vazhdojnë të jenë të nën -përfaqësuar në institucionet shtetërore, të përbuzur në ekonomi dhe të përjashtuar nga proceset vendimmarrëse.
Marrëveshja e Ohrit, që duhej të shënonte fillimin e një epoke të re barazie, nga partitë shqiptare u përdor si mburojë justifikimesh

për të bërë karrierë politike, ndërkohë që ajo kurrë nuk është zbatuar plotësisht.
Shqiptarët sot, ende janë peng i një sistemi arsimor të deformuar, i cili shpesh i shtyn të rinjtë drejt emigrimit, ndërsa vendbanimet shqiptare vazhdojnë të kenë infrastrukturë të shekullit të kaluar.

Racizmi maqedonas si shtyllë e shtetit. Maqedonia e Veriut ka trashëguar një ideologji shtetërore nacio-naliste që gjithnjë e sheh kombin shqiptar si kërcënim të saj, jo si partner.
Historia e këtij shteti është e mbushur me shembuj të dhunës dhe diskriminimit ndaj shqiptarëve:
Ngjarjet e vitit 2012 në Smilkovc treguan qartë, sesi shqiptarët mund të kriminalizohen kolektivisht pa prova, ndërsa mediat maqedonase, pandalshëm përhapin gjuhë urrejtjeje.
Konflikti i vitit 2001, u përdor nga shteti për të legjitimuar ndarjen etnike të vendit, ndërsa Marrëveshja që doli prej tij, nuk u zbatua kurrsesi në përmasa reale.
Shqiptarët shpesh përballen me dhunë policore dhe gjyqësore, ku drejtësia është e njëanshme (selektive) dhe kombësia është faktor vendimtar për trajtimin e qytetarëve.
Burgjet janë të mbushura me ish -pjesëtarë të UÇ K-së.
Nga Brodeci te Kumanova – kur shteti sulmoi shqiptart Në vitin 2007, fshati Brodec u bë skenë e një operacioni brutal policor, me ndihmën e forcave speciale të ardhura nga Shkupi. Me arsyetimin e kapjes së "terroristëve", u arrestuan dhe u rrahën publikisht burra shqiptarë, ndërsa, mediat maqedonase u angazhuan për të krijuar një klimë frike, sikur Brodeci ishte një "strofkë e rrezikshme ekstremistësh".
Në majin e vitit 2015, "Lagjja e Trimave" në Kumanovë, u rrafshua nga një operacion i përmasave ushtarake, i inskenuar dhe i pa hetuar deri më sot.
- Dhjetëra shqiptarë u vranë, u plagosën apo u burgosën nën akuza të dyshimta.
Asnjë zyrtar i lartë nuk u mor në përgjegjësi, për këtë operacion

të përgjakshëm që tronditi opinionin kombëtar dhe ndërkombëtar. Por, brenda Maqed-onisë, ky aksion makabër u paraqit si një "Fitore kundër terrorizmit shqiptar".
Një nga plagët më të rënda të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, është ndjekja penale dhe burgosja e ish -luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK-re).
Ata, që në vitin 2001 i kapën armët, u ngritën për liri dhe barazi kombëtare, sot trajtohen si kriminelë, ndërsa pjesëtarët e forcave maqedonase të sigurisë që kryen krime ndaj shqiptarëve, sot gëzojnë imunitet dhe lavdi shtetërore.
Burgjet maqedonase janë të mbushura me ish -ushtarë të UÇ K-së, të cilët shpesh gjykohen mbi bazën e akuzave politike dhe jo provave konkrete.
- Ky fenomen i përsëritur, është dëshmi e një padrejtësie të përdorur si armë kundër shqiptarëve, ku lufta për barazi interpretohet si "terrorizëm".
- Ndërkohë, partitë shqiptare që kanë ardhur në pushtet falë sakrificës së këtyre burrave, heshtin dhe bëjnë pazare për poste, duke i tradhtuar ata që u flijuan për një kauzë të drejtë.
Iluzioni evropian dhe roli i ndërkombëtarëve
BE -ja dhe SHBA -ja shpesh përshëndesin "Përparimin Multietnik", të Maqedonisë së Veriut, ndërkohë që realiteti në terren është krejt ndryshe. Ata kanë zgjedhur stabilitetin mbi padrejtësinë, duke u bërë bashkëpunëtorë të heshtur të një sistemi diskriminues. Partitë shqiptare, në vend që të sfidojnë këtë dinakëri - hipokrizi ndërkombëtare, zgjedhin të jenë kukulla që legjitimojnë një shtet që i përjashton shqiptarët nga fuqia reale politike.

Kopenhagë, 5 shtator 2025

MAQEDONIA E VERIUT DHE URREJTJA INSTITUCIONALE NDAJ SHQIPTARËVE – ALARM PËR BALLKANIN

Nga Kumanova, mes tribunave të një ndeshjeje basketbolli, shpërtheu përsëri ajo që është shndërruar në normë të pashkruar në Maqedoninë e Veriut: urrejtja e hapur kundër shqiptarëve. Ishte data 2 gusht 2025, dhe ndeshja miqësore mes përfaqësueses maqedonase dhe asaj rumune u shndërrua në një spektakël të shëmtuar thirrjesh raciste ndaj komunitetit shqiptar, me heshtjen kompromentuese të vetë udhëhe-qësve shtetërorë të pranishëm në sallë, përfshirë kryeministrin aktual Kristian Mickoski.

Kjo nuk është një çështje sporti. Nuk është një "incident". Është një pasqyrë e qartë e mentalitetit shovinist dhe të pandryshuar të një pjese të madhe të shoqërisë maqedonase, i cili në mënyrë të qëndrue-shme gjen mbështetje të heshtur në majat e politikës dhe të institucioneve të këtij shteti.

Nga urrejtja historike te gjenocidi kulturor i heshtur

Thirrjet raciste të tifozëve maqedonas sot janë vetëm një vazhdimësi e një politike shtetërore të margjin-alizimit të shqipt-arëve, që nga fundi i viteve 1980, përmes përjashtimit, dhunës, dhe diskriminimit. Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut nuk janë pakicë, por popull shtetformues, që megjithatë ka mbetur i trajtuar si "rrezik kombëtar", si "armik i brendshëm".

Edhe pas marrëveshjes së Ohrit të vitit 2001 – që i dha fund luftës së lavdishme të UÇK-së, për të drejta politike dhe barazi – ky shtet kurrë nuk e zbatoi me përkushtim këtë Marrëveshje. Shqiptarëve u premtua barazi, por ajo mbeti letër e vdekur

Gjuha shqipe u mbajt peng nga burokracia; përfaqësimi në polici, ushtri dhe administratë u deformua; dhe krimet e shtetit ndaj shqiptarëve u amnistuan, u harruan ose u justifikuan.

Nga Brodeci te Kumanova – kur shteti sulmon shqiptart

Në vitin 2007, fshati Brodec u bë skenë e një operacioni brutal

policor, me ndihmën e forcave speciale të ardhura nga Shkupi. Me arsyetimin e kapjes së "terroristëve", u arrestuan e u rrahën publikisht burra shqiptarë, ndërsa mediat maqedonase u angazhuan për të krijuar një klimë frike, sikur Brodeci ishte "strofkë e rrezikshme ekstremistësh".

Në majin e vitit 2015, Lagjja e Trimave në Kumanovë u rrafshua nga një operacion i përmasave ushtarake, i inskenuar dhe i pahetuar deri më sot. Dhjetëra shqiptarë u vranë, u plagosën apo u burgosën nën akuza të dyshimta. Asnjë zyrtar i lartë nuk u mor në përgjegjësi për këtë operacion të përgjakshëm që tronditi opinionin ndërkombëtar. Por brenda Maqedonisë, ai u portretizua si një "fitore kundër terrorizmit shqiptar".

Një shtet që mohon të vërtetën – dhe ndihmësit e tij ndërkombëtarë

Maqedonia e Veriut është shteti i vetëm në rajon që nuk është në gjendje të pajtohet me asnjë fqinj, përveç Shqipërisë. Me Bullgarinë ka konflikt identitar, me Greqinë një kompromis të detyruar për emrin, me Serbinë një lidhje të brishtë si mosnjohja e kishës e fes krishtere maqedone, por vetëm shqiptarët janë ata që e kanë njohur, mbështetur dhe ndihmuar këtë shtet të ruajë stabilitetin e tij.

Dhe për këtë arsye, nacionalistët maqedonas na shohin si "tradhtarë" të ëndrrës së tyre mono -etnike! Nuk e durojnë faktin që shqiptarët janë gjysma e këtij shteti, që flasin gjuhën e tyre, kanë simbolet e tyre, dhe nuk pranojnë të jenë qytetarë të rendit të dytë.

Alarm për Evropën dhe për shqiptarët kudo Heshtja e institucioneve ndërkombëtare përballë kësaj situate është e turpshme. Nuk mund të ketë integrim evropian pa barazi reale për shqiptarët. Nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme në një shtet që toleron racizmin dhe e mban urrejtjen etnike si pjesë të identitetit të tij shtetëror.

Zhelinë, 03.08.2025



(si respektohet gjuha shqipe në Maqedoninë e Veriut)

MANIPULIMI I LISTAVE ZGJEDHORE NË MAQEDONINË E VERIUT: FALSIFIKIM SISTEMATIK KUNDËR SHQIPTARËVE AUTOKTONË

Në këtë artikull trajtoj fenomenin e manipulimit të listave zgjedhore në Maqedoninë e Veriut si një mekanizëm i qëllimshëm politik për të deformuar përfaqësimin e shqiptarëve autoktonë.
Duke analizuar të dhëna zyrtare dhe burime ndërkombëtare, shfaqet një mospërputhje dramatike midis numrit të popullsisë rezidente dhe numrit të votuesve të regjistruar, si dhe një shpërndarje disprop-orcionale e shtetësive.
Ky sistem paraqet një shkelje flagrante të standardeve demokratike dhe përbën një formë të re të diskriminimit institucional ndaj shqiptarëve.

1.
Maqedonia e Veriut shpesh përmendet si "histori suksesi" në rrugën drejt integrimit evropian. Megjithatë, pas fasadës së proceseve zgjedhore "të lira" dhe "transparente" qëndron një realitet i errët: manipulimi i listave zgjedhore ka krijuar një demokraci formale që shkel parimin bazë të përfaqësimit proporcional.
Në qendër të këtij fenomeni është strategjia e shtetit për të ruajtur dominimin e elitave maqedonase, shpesh duke anashkaluar të drejtat e shqiptarëve autoktonë, të cilët përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë.

2.

Shifrat që zbulojnë manipulimin

Treguesi
Të dhënat zyrtare Burimi Popullsia rezidente (31 dhjetor 2022)
1,829,954 banorë

Enti Shtetëror i Statistikës, "Maqedonia e Veriut në numra 2023"
Votuesit e regjistruar (2024)
1,815,350 votues

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
Emigrantët (deri në 2018)
>630,000 persona

Banka Botërore
Shtetësitë e shpërndara
2,460,000

Deklaratë e Oliver Derkoskit, ish-Kryetar i KSHZ-së (AIM)

Të dhënat tregojnë qartë një disproporcion të thellë:
99,2% e popullsisë totale figuron si votues, ndonëse një pjesë e madhe është nën moshën 18 vjeç.
Mbi 630 mijë qytetarë emigrantë vazhdojnë të figurojnë në lista.

2,460,000 shtetësi të dhëna dëshmojnë për ekzistencën e një "popullsie virtuale", jashtë kufijve realë të shtetit.
Kjo situatë nuk është e zakonshme për një demokraci funksionale; përkundrazi, ajo dëshmon për një mekanizëm të qëllimshëm falsifikimi.

3.

Manipulimi si strategji politike

Manipulimi i listave nuk është produkt i rastësisë, por një politikë shtetërore e mirëkalkuluar. Duke përfshirë në listat e votuesve emigrantë, persona të vdekur dhe individë pa lidhje reale me vendin, krijohet një rezervuar artificial votash. Ky rezervuar përdoret:
Për të ruajtur dominimin e elitave maqedonase;

Për të minuar fuqinë politike të shqiptarëve autoktonë;
Për të legjitimuar zgjedhje të manipuluara përmes një procesi që në letër duket "demokratik".
Në vend që të ndërmerren reforma për pastrimin e listave, institucionet maqedonase e mbrojnë këtë mekanizëm, duke e kthyer në një formë të institucionalizuar diskriminimi etnik.

4.

Pasojat për shqiptarët autoktonë

Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, që përbëjnë një nga popullsitë autoktone më të mëdha në Ballkan, janë viktima kryesore të këtij sistemi.
Zvogëlimi artificial i peshës politike: Shqiptarët kanë më pak ndikim elektoral sesa e justifikon numri i tyre real.
Margjinalizimi institucional: Përfaqësimi i tyre në Kuvend dhe në institucionet shtetërore është sistema-tikisht më i ulët .
Përforcimi i narrativave nacionaliste:
Elitat maqedonase përdorin këtë sistem për të mbështetur idenë se shqiptarët janë pakicë e parëndësishme.
Ky diskriminim demografik është i lidhur ngushtë me tensionet politike dhe etnike që kanë karakterizuar historinë e shtetit që nga pavarësia.

5. Nevoja për ndërhyrje dhe reforma

Reforma zgjedhore në Maqedoninë e Veriut është urgjencë kombëtare dhe ndërkombëtare. Hapat kyç për ndryshim janë.
Pastrimi i listave zgjedhore në përputhje me të dhënat reale të popullsisë rezidente.
Verifikimi i shtetësive dhe eliminimi i votuesve fantazmë.
Mbikëqyrja ndërkombëtare nga OSBE, BE dhe organizata të tjera për të garantuar proces transparent.
Përfshirja e diasporës në mënyrë të strukturuar, pa deformuar procesin zgjedhor.
Pa këto hapa, Maqedonia e Veriut rrezikon të mbetet një demokraci formale që shkel parimet themelore të të drejtave të njeriut.

6.
Përfundim

Lista zgjedhore e Maqedonisë së Veriut është simbol i një realiteti politik ku vota nuk është instrument i lirisë, por armë e manipulimit shtetëror. Ky sistem jo vetëm që shkel standardet evropiane shqiptarëve autoktonë. Pa një pastrim të plotë të listave dhe transparencë absolute zgjedhore, Maqedonia e Veriut nuk mund të flasë për integrim evropian, demokraci apo shtet të së drejt piane të demokracisë, por është edhe një strategji e qartë për të zvogëluar peshën politike të shës.

Referenca:

Enti Shtetëror i Statistikës, Maqedonia e Veriut në numra, 2023, f. 12.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Lista e përgjithshme e votuesve, Zgjedhjet Parlamentare dhe Presidenciale 2024.
Banka Botërore, Migration Data Portal, 2018.
Oliver Derkoski, Deklaratë për Agjencinë AIM, 2020

Kopenhagë, 20 tetor 2025

TË ARRATISURIT SHQIPTARË DHE SHËRBIMI I DETYRUAR NDAJ UDB-SË: QË NGA ARSHI PIPA DERI TE FLAMUR NOKA.

Në periudhën 1945–1990, një numër "shqiptarësh" kuislingë, që kishin bashkëpunuar me forcat pushtuese fashiste gjermane dhe italiane gjatë Luftës së Dytë Botërore, u detyruan të largoheshin nga Shqipëria Socialiste për t'i ikur përgjegjësisë politike dhe represionit që kishin ushtruar në vitet e robërisë fashiste; këta të pabesë të popullit e të atdheut, duhej dhënë llogaritë para pushtetit popullor të udhëhequr nga Komandanti anti-fashist, Enver Hoxha.



("Nasho Jorgaqi shpjegon se agjencitë greko-jugosllave kundër shqiptare kanë manipuluar me emigracionin shqiptar.")

-Një pjesë e konsiderueshme e tyre kaluan përmes territorit të Jugosllavisë; e cila, fillimisht hiqej sikur iu ofronte "strehim

politik", por në realitet, këta faqezinj e faqezeza i përdorte në këtë proces si instrumente politike dhe informative përmes Shërbimit të saj Sekret –" UDB-së" (Uprava državne bezbednosti).

Ky mekanizëm përfshinte marrjen në pyetje, rekrutimin e detyruar, përpunimin psikologjik dhe më pas dërgimin e "refugjatëve të përpunuar" drejt vendeve perëndimore.

Kjo praktikë, siç do të shihet më poshtë, nuk përfundoi me monizmin: ajo la gjurmë edhe në periudhën pas vitit 1990, përmes figurave që kishin kaluar përmes sistemit jugosllav përpara se të hynin në politikën e tranzicionit shqiptar.

1. Strehimi politik si mjet kontrolli (1945–1990)

Pas prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave në vitin 1948, kufiri mes dy vendeve u militarizua plotësisht. Çdo shqiptar që kalonte në Jugosllavi ndalohej nga UDB-ja dhe përballej me një zgjedhje dramatike: bashkëpunim ose riatdhesim.

Sipas studimeve të Pëllumb Xhaferrit, shumë prej tyre "nënshkruan deklarata bashkëpunimi nën presionin e kthimit të sigurt drejt vdekjes"[1].

Kjo situatë krijoi një rrjet refugjatësh të kontrolluar, të cilët më pas dërgoheshin në Perëndim si zëra anti-komunistë – por gjithmonë nën mbikëqyrjen e strukturave jugosllave.

Historiani kroat Ivo Banac thekson se UDB-ja gjatë viteve '50–'70 zhvilloi "një strategji të mirëorganizuar për rekrutimin e refugjatëve shqiptarë, të cilët më pas u përdorën për propagandë dhe informim politik kundër Tiranës"[2].

2. Rasti i Arshi Pipës

Një shembull domethënës i këtij mekanizmi është Arshi Pipa (1920–1997), poet, filozof dhe disident shqiptar. Pas viteve të burgimit në kampet socialist, Pipa u arratis nga Shqipëria dhe kaloi përmes territorit jugosllav përpara se të arrinte në Perëndim.

Sipas dëshmive të bashkëkohësve dhe biografëve të tij, Pipa u ndalua nga autoritetet jugosllave dhe u mbajt për një periudhë

"përpunimi" nga UDB-ja, e cila më pas e lejoi të largohej në Itali dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës[3].

Studiuesi amerikan Nicholas Pano e përmend Pipën si "Një nga intelektualët shqiptarë që kaluan nëpër filtrin jugosllav të refugjatëve politikë", duke theksuar se shumë prej tyre u instrumentalizuan në mënyrë të kujdesshme "si anti-komunistë të dobishëm, por jo anti-jugosllavë"[4].

Rasti i Pipës ilustron qartë mënyrën, sesi Jugosllavia i shfrytëzonte arratisjet shqiptare si kapital politik dhe informativ, duke i kthyer refugjatët në instrumente të ndikimit të saj në diasporë.

3. Vijimësia pas vitit 1990: rasti i Flamur Nokës

Pas rënies së Pushtetit popullor, Jugosllavia (në shpërbërje e sipër) ende kontrollonte rrugët e arratisjes së shqiptarëve drejt Perëndimit.

Në fillim të viteve 1990, qindra të rinj shqiptarë u larguan nga vendi përmes kufirit verilindor, duke hyrë në territorin jugosllav. Në këtë periudhë ndodhet edhe rasti i Flamur Nokës, sot figurë e rëndësishme politike në Shqipëri, nënkryetar i Partisë Demokratike dhe ish-ministër i Brendshëm.

Sipas burimeve mediatike dhe dëshmive të bashkëkohësve, Noka, u largua nga Shqipëria përmes Jugosllavisë, një itinerar që në atë kohë kontrollohej ende nga strukturat e sigurisë serbe[5].



(„Terrori fashist me bashkëpunëtorët shqiptarë kundër popullit shqiptar.")

Ndonëse nuk ekzistojnë dokumente të hapura që e lidhin Nokën me UDB-në, vetë fakti i kalimit përmes një sistemi që regjistronte dhe përpunonte çdo refugjat shqiptar e vendos atë në të njëjtin kontekst politik me fenomenin e mëparshëm: mbikëqyrje, kontroll dhe ndikim të shërbimeve jugosllave mbi individët që hynin në territorin e tyre.

Në këtë kuptim, rasti i Nokës nuk trajtohet si bashkëpunim i drejtpërdrejtë, por si shenjë e vazhdimësisë së mekanizmave të ndikimit që Jugosllavia ushtroi mbi emigracionin shqiptar edhe në periudhën e tranzicionit demokratik.

4. Nga analiza e këtyre dy rasteve — Arshi Pipës dhe Flamur Nokës — kuptohet se UDB-ja dhe pasardhësët e saj përdorën sistematikisht strehimin politik si mjet për kontroll dhe rekrutim të shqiptarëve.

Në periudhën e Hoxhës, ky mekanizëm kishte karakter ideologjik dhe informativ, ndërsa në fillim të viteve 1990, u shndërrua në instrument ndikimi politik.

Kjo tregon se trashëgimia e ndikimit jugosllav në shoqërinë dhe politikën shqiptare është më e thellë se sa mendohet, dhe se ajo nuk përfundon me shembjen e sistemit socialist, por vijon të reflektohet në forma të tjera të ndikimit të jashtëm.

Për të kuptuar plotësisht këtë periudhë, është e domosdoshme hapja e plotë e arkivave të UDB-së dhe të Sigurimit të Shtetit shqiptar, si dhe ndërtimi i një qasjeje të re akademike që i sheh këto raste jo si episode të izoluara, por si pjesë e një strategjie të gjerë rajonale të kontrollit politik ndaj shqiptarëve.

Referenca bibliografike

Pllumb Xhaferri. Shërbimet Sekrete dhe Arratisjet Shqiptare 1945–1990. Tiranë: Onufri, 2009.

Ivo Banac. With Stalin Against Tito: Cominformist Splits in Yugoslav Communism. Cornell University Press, 1988.

Kastiot Dervishi . Lëvizjet Politike të Shqiptarëve në Emigracion 1945–1990. Tiranë: Dituria, 2012.
Nicholas Pano . The People's Republic of Albania. Baltimore: Johns Hopkins University Press, 1968.
"Flamur Noka – nga refugjat politik në Jugosllavi te politika shqiptare." Gazeta Dita,

Miranda Vickers . Between Serb and Albanian: A History of Kosovo. London: Hurst & Company, 1998.
"Dosjet e UDB-së për refugjatët shqiptarë." Arkivi i Beogradit – Seksioni për Marrëdhëniet me Shqipërinë, dokumente të deklasifikuara, 2002.

17.tetor.2025, Qerretë

ÇLIRIMI I SHQIPËRISË DHE PËRPJEKJET E BALLIT KOMBËTAR NË NËNTOR 1944: RILEXIM MBI BAZËN E ARKIVAVE NDËRKOMBËTARE

Data 29 Nëntor 1944 njihet zyrtarisht si çlirimi i Shqipërisë nga pushtimi gjerman. Megjithatë, ditët para kësaj date shfaqin zhvillime të rëndësishme politike dhe ushtarake që shpesh janë trajtuar sipërfaqësisht në historiografinë shqiptare.

Ky artikull shqyrton përpjekjet e Ballit Kombëtar për bashkëpunim me forcat çetnike serbe, duke u mbështetur në burime arkivore britanike, amerikane dhe jugosllave, të cilat hedhin dritë mbi dinamikën e vërtetë të ngjarjeve.

Çlirimi i Shqipërisë në fund të vitit 1944 është një moment kyç i historisë shqiptare. Megjithëse aspekti ushtarak i këtij procesi është dokumentuar gjerësisht, në shumë raste janë anashkaluar manovrat politike të aktorëve jo-komunistë, veçanërisht përpjekjet e Ballit Kombëtar për të siguruar mbështetje nga forcat çetnike serbe në ditët e fundit të luftës. Burimet ndërkombëtare të periudhës ofrojnë informacion të mjaftueshëm për të rindërtuar një panoramë më të gjerë dhe më të balancuar të situatës.

Në fund të nëntorit 1944, Ushtria Nacional Çlirimtare Shqiptare (UNÇSH) kishte marrë kontrollin e pothuajse gjithë territorit.

1 -Tërheqja gjermane po kryhej me ritme të shpejta dhe strukturat e pushtetit kolaboracionist po shpërbëheshin. Pikërisht në këtë kontekst, Balli Kombëtar kërkoi të krijonte një aleancë emergjente anti-komuniste me forcat çetnike serbe.

Sipas dokumenteve të SOE të ruajtura në The National Archives (Kew), përfaqësues të Ballit Kombëtar u angazhuan në bisedime me çetnikët për të sjellë në Shqipëri 15.000–17.000 luftëtarë çetnikë, në mënyrë që të organizohej rezistenca kundër

partizanëve.

2- Raportet britanike i përshkruajnë këto përpjekje si "Manovra të një organizate në kolaps të afërt".

Raportet e OSS (Office of Strategic Services), të ruajtura në U.S. National Archives, përforcojnë të njëjtin narrativ. Ato flasin për takime në zonat kufitare të Kosovës dhe Sanxhakut, ku përfaqësues të Ballit Kombëtar kishin negociuar me komandantë çetnikë për të krijuar një front të përbashkët anti-komunist.

3-Burimet jugosllave, të ruajtura në Arkivin e Jugosllavisë (Vojni Arhiv), konfirmojnë kontaktet e çetnikëve të Pavle Đurišić dhe Stojan Kalabić me Ballin Kombëtar në fund të vitit 1944.

4- Dokumentet flasin për koordinim potencial për të frenuar avancimin e forcave partizane. Që nga viti 1944, Aleatët e mëdhenj kishin ndërprerë çdo mbështetje për çetnikët e Mihailoviçit në favor të partizanëve të Titos.

5- Kjo e la strukturën çetnike në krizë të plotë, pa aftësi logjistike për të kryer një operacion të madh në territor shqiptar. Sipas raporteve britanike të tetor-nëntorit 1944, njësitë çetnike ishin duke u shpërbërë nga ofensivat partizane jugosllave dhe nga dezertimet masive.

6- Kjo e bëri të pamundur çdo mbështetje efektive për Ballin Kombëtar. Në ndihmës së premtuar, Balli Kombëtar mbeti i izoluar. Burime britanike citojnë Mit'hat Frashërin më 29 nëntor 1944 duke deklaruar: "Ikni, sepse e humbëm luftën".

7- Pas kolapsit të strukturës së Ballit Kombëtar, udhëheqësit kryesorë u bashkuan me kolonat e fundit gjermane duke u tërhequr drejt Evropës Qendrore. Burimet e SOE dhe OSS e konfirmojnë këtë lëvizje, duke e lidhur me fundin e çdo rezistence të organizuar jo-komuniste në Shqipëri.

8- Burimet ndërkombëtare konfirmojnë se Balli Kombëtar kërkoi të krijonte një aleancë strategjike me çetnikët serbë në fund të nëntorit 1944.

Marrëveshja u tentua, por dështoi për arsye ushtarake dhe politike që lidhen kryesisht me shpërbërjen e forcave çetnike dhe anulimin e mbështetjes nga Aleatët. Si rrjedhojë, forcat partizane shqiptare arritën të çlirojnë vendin pa kundërveprim serioz nga frontet "nacionaliste", duke çuar në çlirimin e Shqipërisë më 29 Nëntor 1944.

Fusnotat

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, dosjet e nëntorit 1944.

Fischer, Bernd J., Albania at War 1939–1945, Hurst & Co., 1999.

National Archives (UK), SOE Records, HS 5/133; FO 371/43531.

U.S. National Archives (NARA), OSS Records, Europe—Albania Files, Nr. 226/ALB.

Vojni Arhiv (Beograd), Četnička arhiva, dosjet e vitit 1944.

Pavlowitch, Stevan K., Hitler's New Disorder: The Second World War in Yugoslavia, Columbia University Press, 2008.

National Archives (UK), HS 5/137, raport i misionit britanik për Shqipërinë, 30-nëntor 1944.

Kopenhagë, 29 – Nëntor – 2025

MANIPULIMI I MASAKRËS SË TIVARIT NGA BALLISTËT DHE TITISTËT

Çfarë po ndodh me ne shqiptarët? Prej disa vitesh po shohim një tendencë të rrezikshme për të relativizuar Luftën Nacionalal Çlirimtare dhe për të rehabilituar forcat kolaboracioniste, në emër të një "demokratizimi" të rremë, i nxitur shpesh nga qarqe ideologjike serbe, turke, arabe, por edhe nga segmente të cakt-uara evropiane që kërkojnë rishkrimin e historisë shqiptare.

1. Partizanët shqiptarë u rreshtuan në anën e Aleatëve Antifashistë – fakt i padiskutueshëm

Ky nuk është interpretim politik, por fakt i dokumentuar:

Në Konferencën e Teheranit (1943), Aleatët njohën frontet partizane të Ballkanit si pjesë të koalicionit antifashist.

SHBA dhe Britania e Madhe dërguan misione ushtarake pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare.

Forcat partizane shqiptare bashkëpunuan me Zbulimin Sovjetik (GRU) për çështje operative në etapën e fundit të luftës.

Aleatët e mbështetën dhe njohën LNÇ-në si forcë të vetme legjitime të rezistencës shqiptare.

Këto dokumente ekzistojnë në arkivat britanike (The National Archives), amerikane (NARA) dhe ruse.

2. Balli Kombëtar ishte forcë kolaboracioniste – dokumentet e vërtetojnë

Debati politik nuk mund ta ndryshojë këtë fakt. Historianët ndërkombëtarë dhe vendas janë të njëzëshëm:

Njësitë e Ballit morën pjesë në operacione të përbashkëta me Wehrmacht-in sidomos në Shqipërinë e Mesme dhe në Kosovë.

Arkivat gjermane (Bundesarchiv) përmbajnë raporte ku Balli përshkruhet si "aleat i besueshëm lokal".

Kjo e bën të pamundur rehabilitimin e tyre pa mohuar dokumentet.

3. Shqipëria rrezikoi të fshihej nga harta – vetëm qëndrimi i udhëheqjes partizane e shpëtoi.

Në vitet 1944–1946 Jugosllavia kërkonte:
bashkim doganor,
bashkim monetar,
bashkim ushtarak,
futjen e Shqipërisë në Federatën Jugosllave.
Dokumentet e Koçi Xoxes me vetë Titos (në arkivat e Beogradit) e dëshmojnë qartë këtë plan.
Por faktet janë kokëforta:
Shqipëria u njoh ndërkombëtarisht si shtet i pavarur në Konferencën e Londrës (1913) dhe kjo njohje mbeti në fuqi.
Udhëheqja e LNÇ-së nuk pranoi asnjë formulë federale që hiqte sovranitetin.
Kjo është arsyeja pse sot ekziston Republika e Shqipërisë.

4. Ballistët dhe titistët kanë ndërtuar prej vitesh një narrativë të rreme rreth Masakrës së Tivarit, duke pretenduar se ajo qenka kryer nga vetë shqiptarët. Ky është një manipulim i qëllimshëm, i cili synon të relativizojë përgjegjësinë e strukturave ushtarake jugosllave dhe të zhvendosë fajin nga autorët te viktimat. Dokumentet arkivore të Beogradit dhe raportet britanike të kohës e dëshmojnë qartë se Masakra e Tivarit (mars 1945) u krye nga njësitë e Mbrojtjes Popullore të Jugosllavisë, nën komandën serbo-malazeze, dhe jo nga formacione shqiptare. Madje, në Beograd u zhvillua edhe një proces penal kundër disa oficerëve jugosllavë, të cilët u dënuan për rolin e tyre në këtë krim, gjë që rrëzon plotësisht pretendimin se "Shqiptarët vranë shqiptarët". Për më tepër, studiues si Akademik Hakif Bajrami duke përdorur arkiva jugosllave, britanike dhe shqiptare kanë argumentuar se asnjë strukturë shqiptare, as partizane, e, as administrative, nuk mori pjesë në ekzekutimet. Narrativa balliste dhe titiste shërben vetëm si instrument ideologjik për të sulmuar Luftën Nacional Çlirimtare dhe për të rehabilituar pozicionet e tyre historike, duke shpërqendruar vëmendjen nga masakrat sistematike të

kryera nga shteti serb ndaj shqiptarëve që nga viti 1912. Ky manipulim është, pra, një tentativë e hapur për rishkrimin e historisë dhe për përmbysjen e së vërtetës së dokumentuar.

5. Pse ballistët nuk flasin për masakrat serbe 1912–1944?

Përpara Luftës II Botërore, forcat serbe kryen një numër masakrash sistematike në Kosovë, Maqedoninë Perëndimore dhe Sanxhak, me mbi 500.000 shqiptarë të vrarë, dëbuar ose të asimiluar me dhunë. Këto përfshijnë:

Masakrat e Llukës, Carralevës, Drenicës (1912–1913), Masakrat e Tetovës dhe Monopolit të Tetovës, Deportimet masive 1918–1937 në Turqi Djegien e qindra fshatrave shqiptare. Këto janë dokumentuar nga Edith Durham,

Raportet britanike të Foreign Office,

Dokumentet jugosllave të Komisionit Antifashist,

Historianët shqiptarë dhe ndërkombëtarë.

Por propagandistët e sotëm nuk flasin për to, sepse bie narrativa e tyre ideologjike.

6. Shqipëria mbijetoi si shtet falë rreshtimit në anën fitimtare

Një fakt i thjeshtë, por vendimtar:

Shtetet e rreshtuara me Boshtin pas Luftës II Botërore u copëtuan, u pushtuan ose humbën territore.

Shqipëria jo vetëm që ruajti sovranitetin, por shpëtoi edhe Kufijtë e 1913-s.

Kjo është arsyeja pse historinë nuk mund ta rishkruajnë as fashistët, as titistët, as propagandat moderne.

FUSNOTAT

[1] British National Archives, HS 5/966 – Special Operations Executive (SOE), Albania: Reports on Partisan Activities, 1943–1944.

[2] National Archives and Records Administration (NARA), OSS Records, RG 226, Entry 154, "Albanian Partisan Forces and Operational Coordination with Allies", 1944.

[3] Vladimir Dedijer, The War Diaries, Vol. II (Belgrade: Prosveta, 1977), f. 112–118.
[4] Bundesarchiv (Arkivi Federal Gjerman), RW 40/145, "Berichte über lokale albanische Kräfte (Balli Kombëtar)", 1943–1944.
[5] Kristo Frashëri, Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e Shqipërisë 1939–1944 (Tirana: Akademia e Shkencave, 1984), f. 321–330.
[6] Owen Pearson, Albania in the Twentieth Century: A History, Vol. II (London: I.B. Tauris, 2006), f. 178–189.
[7] Arkivi i Beogradit, Fondi i OZNA-s, Dosja 1197, "Procesi gjyqësor për ngjarjet e Tivarit", 1945–1946.
[8] Hakif Bajrami, Masakra e Tivarit – Dokumente dhe Interpretim Historik (Prishtinë: Instituti i Historisë, 1998), f. 45–63.
[9] Arkivi Shtetëror i Kosovës, Fondi: "Kosova nën Jugosllavi", Dosja 58, "Raportet e pushtetit ushtarak jugosllav në Kosovë 1944–1945".
[10] Noel Malcolm, Kosovo: A Short History (New York: NYU Press, 1998), f. 228–234.
[11] Edith Durham, The Struggle for Scutari (London: Edward Arnold, 1914), f. 201–223.
[12] Foreign Office (FO), 371/17345, "Report on Serbian Atrocities in Kosovo and Macedonia, 1919–1923".
[13] Justin McCarthy, Death and Exile: The Ethnic Cleansing of Ottoman Muslims, 1821–1922 (Princeton: Darwin Press, 1995), f. 245–250 (për deportimet masive të shqiptarëve drejt Turqisë).
[14] Arkivi i Maqedonisë së Veriut, Fondi i Komisionit Shtetëror për Krimet e Luftës, Dosja: "Masakrat në Tetovë dhe rrethinë 1912–1913".
[15] Bernd Fischer, Albania at War: 1939–1945 (London: Hurst & Co., 1999), f. 275–298.
[16] Stavro Skendi, The Albanian National Awakening (Princeton University Press, 1967), f. 349–360.
[17] Miranda Vickers, Between Serb and Albanian: A History of Kosovo (London: Hurst, 1998), f. 55–66.

Kopenhagë, 06 nëndor 2025

HISTORIANI" URAN BUTKA DHE PËRPJEKJA PËR TË RISHKRUAR HISTORINË:NJË TRADHTI NDAJ KUJTESËS ANTIFASHISTE SHQIPTARE

Është për të ardhur keq që, edhe sot, më shumë se tetëdhjetë vjet pas fitores ndaj fashizmit, në Shqipëri vazhdojnë të dëgjohen zëra që përpiqen të rishkruajnë historinë e Luftës Nacional Çlirimt-are sipas këndvë-shtrimeve të humbësve të djeshëm. Një nga këta është Uran Butka, i cili nëpërmjet pseudo-historisë e manipulimit ideologjik, përpiqet të rehabi-litojë figurat e bashkëpunëtorëve të pushtuesve dhe të njollosë lëvizjen antifashiste shqiptare.

Kjo përpjekje nuk është e pafajshme. Ajo është pjesë e një strategjie më të gjerë për të shkatërruar identitetin historik të shqiptarëve, duke e relativizuar ndarjen midis çlirimtarit dhe tradhtarit, midis antifashistit dhe kolaboracionistit.

Masakra e Tivarit dhe shtrembërimi i qëllimshëm i historisë

Një shembull i qartë i këtij manipulimi është mënyra se si Butka dhe disa ndjekës të tij trajtojnë Masakrën e Tivarit.

Në mars të vitit 1945, mijëra shqiptarë nga Kosova, të mobilizuar me premtimin se do të dërgoheshin për çlirimin e vendit, u pushkatuan mizorisht nga forcat ushtarake jugosllave në Tivar. Kjo ngjarje, një nga plagët më të rënda të historisë sonë, është dokumentuar gjerësisht nga historianë seriozë, si prof. Hakif Bajrami, i cili ka ndërtuar një kronologji të plotë të krimit, me burime arkivore dhe dëshmi të mbijetuarish.

Është fakt historik se, pas presionit të palës shqiptare, në fillim të viteve '50 në Beograd u zhvillua një proces gjyqësor ndaj disa oficerëve serbë që kishin marrë pjesë në këtë masakër — dhe disa prej tyre u dënuan. Por, këto fakte, të pranuara edhe në dokumente arkivore jugosllave, anashkalohen nga pseudo-

historianët shqiptarë që e shohin historinë jo si shkencë, por si mjet politik për të përmbysur kujtesën antifashiste.

Revizionizmi historik si tradhti kombëtare

Butka dhe ideologët e linjës së tij nuk luftojnë për të zbardhur të vërtetën, por për të rehabilituar kolabo-racionizmin.

Në vend që të përballen me faktet, ata kërkojnë të barazojnë luftën antifashiste me "luftën civile", për të krijuar përshtypjen e një "konflikti të brendshëm" pa dallim moral midis palëve. Kjo është një strategji e rrezikshme, sepse përpiqet të zhdukë ndarjen themelore që përcakton çdo komb të lirë: ndarjen midis atyre që luftuan për liri dhe atyre që shërbyen pushtuesit.

Kjo lloj propagande e rreme, që shpesh ushqehet nga qarqe të lidhura me ndikimin serb dhe nostalgjinë monarkiste, është në fakt një akt tradhtie intelektuale ndaj gjakut të mijëra shqiptarëve që u flijuan për çlirimin e atdheut.

Lufta Nacionalçlirimtare si garanci e ekzistencës shqiptare

Duhet rikujtuar me forcë se Lufta Nacionalçlirimtare Shqiptare nuk ishte një konflikt ideologjik, por një luftë për mbijetesë kombëtare.

Nëse Shqipëria do të ishte dorëzuar në duart e bashkëpunëtorëve të pushtuesve, siç ndodhi në disa vende fqinje, sot kufijtë tanë kombëtarë nuk do të ekzistonin në formën që njohim. Pikërisht pjesëmarrja masive e shqiptarëve në frontin antifashist garantoi që Shqipëria të pranohej si vend fitues në kampin e aleatëve, duke shpëtuar kështu integritetin e saj shtetëror.

Kjo është arsyeja pse urrejtja e Butkës dhe e rrethit të tij ndaj luftës antifashiste nuk është thjesht një qëndrim ideologjik, por një reagim i atyre që nuk e durojnë faktin se historia i dënoi me vulën e tradhtisë.

Përfundim: Kujtesa historike është mburoja e kombit

Kujtesa historike është një akt qëndrese. Popujt që lejojnë që historia t'u rishkruhet nga duar të huaja ose nga bijtë e tradhtisë, rrezikojnë të humbin vetveten.

Në një kohë kur në Ballkan po ringjallen narrativa pro-serbe dhe

nostalgjitë e vjetra ndaj pushtuesve, mbrojtja e së vërtetës antifashiste është detyrë kombëtare dhe morale.

Uran Butka dhe pasuesit e tij nuk janë historianë të ndershëm; ata janë revizionistë që kërkojnë të legalizojnë tradhtinë e djeshme me gjuhën e sotme. Por historia është më e fortë se mashtrimi: ajo e di mirë se fitorja mbi fashizmin ishte fitorja mbi tradhtinë kombëtare, dhe se gjaku i dëshmorëve nuk mund të fshihet nga faqet e kujtesës sonë kolektive.

Burime dhe referenca historike

Hakif Bajrami, Masakra e Tivarit 1945 – Dokumente dhe dëshmi historike, Prishtinë, 1995.

Hakif Bajrami, Krimet serbo-malazeze ndaj shqiptarve 1912–1945, Botime Akademike, Prishtinë, 2006.

Arkivi Shtetëror i Kosovës, fondi "Lufta e Dytë Botërore", dokumente mbi mobilizimet shqiptare në Mal të Zi dhe proceset gjyqësore në Beograd (1951–1953).

Studime Historike, nr. 2, Tiranë, 1984 – "Roli i Lëvizjes Nacionalçlirimtare në mbrojtjen e shtetit shqiptar".

Enver Bytyçi, Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore: midis antifashizmit dhe tradhtisë kombëtare, Tiranë, 2018.

Kopenhagë, 08 Nëntor 2025

"FLAMURI I NIKOLLËS DHE SHKOPI I GJYSHIT ADEM: KUJTIME QË MË BËNË NJERI"

Frymëzimi im nga gjyshi
Që në moshë të vogël, e kam ndjerë thellë lidhjen me rrënjët e mia. Ajo që më ka formësuar si njeri, si qytetar, dhe si shqiptar, janë dy biseda të paharruara me gjyshin tim, Adem Zeqiri. Ai ishte një njeri i mençur, me përvojë jete dhe bindje të palëkundura. Në atë kohë, unë isha vetëm shtatë vjeç, ndërsa ai kishte arritur moshën e urtësisë – 78 vjeç.



(Në shtëpin time në Zhelin.)

I. Flamuri më i shtrenjtë se toka.
Pas Luftës Nacionalçlirimtare, xhaxhai im, Zeqir Zeqiri, i cili kishte luftuar në Brigadën e 7 Partizane, u kthye gjallë. Ndërkohë, gjyshi im dhe babai, Servet Zeqiri që atëherë ishte vetëm 13 vjeç, punonin arat me qira nga një njeri" Maqedon" me emrin Nikollë, nga fshati Saraqin, pranë Zhelinës – fshatit tonë. Interesante është që fshati ynë dikur quhej Xhelinë, por pas vitit 1945, pushteti sllav ia ndërroi emrin në Zhelinë, si pjesë e një politike më të gjerë për asimilimin e identitetit shqiptar.
Kur pas luftës nisi kolektivizimi i tokës, gjyshi mori djemtë e tij, Zeqirin dhe Servetin shkoi te shtëpia e Nikollës. Kur u takuan, Nikolla tha me të qeshur: "Grua, bëj kafe se këta janë turq, nuk pinë raki!" Gjyshi reagoi menjëherë: "Jo, jo, shqiptarë jemi, madje xhaxhai im, Ramadan Zeka, është vrarë në luftë për çlirimin nga osmanët!"
Nikolla nuk nguroi: "Jo, nuk jeni njësoj! Ne jemi shqiptarë, ata kanë qenë okupatorë!"
Gjyshi vazhdoi: "Nikollë, kemi punuar bashkë për vite me radhë në arat tuaja me qira, por ja – shteti ua mori të gjitha!" "A për atë je mërzitur?" – tha Nikolla duke qeshur me zë të lartë. "Le t'i marrë të gjitha! Flamuri është imi!" Kur u kthyen në shtëpi, gjyshi u tha djemve të tij: "E dëgjuat Nikollën? I jep të gjitha, vetëm ta ketë flamurin! Kjo është pasuria më e madhe – flamuri, jo si leckë, por si simbol i të drejtës së kombit."
II. Emri nuk është vetëm emër.
Një ditë tjetër, kur isha fëmijë dhe po luaja me shokë me pisha, kaloi gjyshi pranë nesh me shkopin në dorë. Kishte probleme me shtyllën kurrizore dhe e mbante shkopin si mbështetje. Njëri nga shokët tha: "A e morët vesh? Mbrëmë ujku copëtoi një lopë!"
"Ku?", pyetëm ne.
"Tek rruga e Bullgarit, në mal," -tha ai. Gjyshi ndaloi, u kthye dhe tha me zë të prerë: "Mos e dëgjoj më të quani atë rrugë 'e Bullgarit'! Bullgaria është larg nga këtu! Ajo është rruga e F. Cerovës!" Na tregoi se ajo rrugë ishte ndërtuar nga shqiptarët

gjatë pushtimit bullgar dhe se bullgarët kishin terrorizuar banorët, duke i detyruar me dhunë të punonin në ndërtimin e saj. Emri i rrugës ishte një kujtesë e dhimbshme, por edhe një dëshmi për sakrificën shqiptare.

III. Si më edukoi kombëtarisht gjyshi im.

Këto dy histori më kanë ndjekur si hije e mirë në jetën time. Ato më kanë mbrojtur kur isha në rrezik, më kanë udhëzuar kur isha në mëdyshje dhe më kanë nxitur të qëndroj i drejtë, -vertikal.

Gjyshi im nuk ishte i shkolluar, por ishte akademik i shpirtit. Fjalët e tij ishin rrënjë. Dhe sot, kur mendoj për qëndrueshmërinë, identitetin, drejtësinë dhe flamurin, gjithmonë më del para ai – Adem Zeqiri – me shkop në dorë, me të vërtetën në zemër. Ndjesë!

Zhelinë, 29.07.2025

LOTI I BURRIT NUK ISHTE ASPAK I LEHTË

Tani e kuptova që nuk thonë kot; se kur qajnë burrat, tundet malet e dridhet dhe toka!

Eh si të mos qaja, si ta mbaja lotin kur e pashë në atë gjendje atë burrë, akademik Abdullah Memetin, i cili nuk rreshti kurrë, nuk ndaloi së shkruari e së foluri për çështjen shqiptare. Mirëpo sëmundja e mallkuar, ia kishte cenuar pak fjalën, por mendimet jo. Jam i sigurt se ai mendon njëjtë si dikur, prandaj filloi të qante sapo më pa, dhe unë fillova të qaja bashkë me të, e që nuk kisha qarë prej vitesh, madje se mbaj mend nëse kam qarë dikur. Ai qan jo nga dhimbjet që i shkakton sëmundja, sepse ai është i fortë si guri, i tillë ka qenë gjithmonë. Por ai qan, sepse nuk iu dha kurrë mundësia dhe hapësira për të treguar potencialin e tij intelektual dhe gjenial.

Ai dëshpërohet me ne, me gabimet tona, i vjen keq për ne që nuk arritëm kurrën e kurrës t'i kuptojmë idetë madhore, dhe misionin fisnik të burrave të kombit. Qan edhe për Abdullahët e tjerë, që ne nuk dimë as t'i vlerësojmë e as t'iu japin hapësirën dhe mundësinë që iu takon.

Unë dëshpërohem njëjtë si ai, se e di se ai ka shumë të drejtë. Dëshpërohem dhe habitem me ne, me këta njerëz, për harresën e tyre të shpejt, për mos interesimin e tyre për njerëz si Abdullahu, që nuk harruan për asnjë çast të jenë vigjilent, të angazhuar dhe të japin gjithçka nga vetja në shërbim të kauzës.

I lamë në kushte të mjerimit Migjenian, ata ashtu mbesin, se nuk dinë të vjedhin, ose më saktë nuk duan të vjedhin e të rrjepin, as të shkulin nga trupi i Atdheut tonë me plot plagë, e që mezi ri në këmbë.

Ata janë misionar, janë shtylla e Kombit, e jo hiena, jo matrapaz e hajdut të tipit klasik.

Çfarë përfaqësuesish jeni ju more aman, që njëherë të vetme nuk u kujtuat për fatin e këtij njeriu, për fatin e këtij gjeniu, arkitektit,

ideatorit të Universitetin të Tetovës, njeriut që projektoi gjithë procesin se si do të ngrihej ky tempull i diturisë. Madje lëre se e keni harruar, por më e dhimbshme është ajo pjesë, kur ju aktroni sikur nuk e njihni fare! Sikur nuk ia keni idenë se kush ishte ky njeri, i cili ka mendjen, logjikën, dijen sa të gjithë ju bashkë, madje sa të gjithë ne bashkë në përgjithësi.

Abdullah Memeti, nuk rënkon sot nga sëmundja që e ka prekur trupin e tij, ai ka rënkuar gjithmonë nga dhimbja shpirtërore që ka ndjerë, duke na parë ne se nuk jemi as në tokë e as më qiell. Mua si një mik i tij prej vitesh, më digjet shpirti e zemra, kur e mendoj se ai një ditë mund të largohet nga ne po me këtë dhimbje të madhe shpirtërore, po me atë brengë se çfarë do të bëhet me fatin e kombit, me popullin dhe me ne në përgjithësi!

Ai nuk hidhërohet kurrë, vuan në heshtjen e tij, nuk nxjerr zë për të kërkuar ndihmë, madje herë -herë edhe na jep kurajo ne të tjerëve.

Më kujtohet një rast kur tha: Langua bëhesh brenda ditës, por misionarëve nuk u mjafton e gjithë jeta!

Ne more duhet të zgjohemi, t'u kushtojmë vëmendje këtyre njerëzve si Abdullah Memeti. Ku jemi ne? Ku është Kosova? Ku është Shqipëria Londineze? Pse nuk u interesuan kurrën e kurrës për të?

Pse nuk e ftonin nëpër emisione?

Apo e kishin frikë se nuk mund të përballen me të?

Nuk mund t'ia dalin diskutimit me të?

Mos keni frikë nga gjenitë, bota i kërkon për t'i gjetur, ne kur i kemi i tresim, i nënçmojmë i harrojmë e i përbuzim.

Kujdesi dhe interesimi për Abdullahun nuk i shërben atij, por të gjithë ne. Ai nuk mendoi kurrë për vete, madje as nuk mendon. Por ne e kemi obligim moral, kombëtar që t'ia zgjatim dorën, t'i qëndrojmë pranë e ta mbështesim në këto momente dhe sfida që po kalon i shtrirë në shtrat.

Zhelinë, Tetovë, 21 nëntor 2924

NGA THEMELIMI DERI NË PARLAMENTIN E EVROPËS DHE KONGRESIN AMERIKAN

Shkruan: Akademik Abdulla Mehmeti
Shipkovic, 15.XII.2022

Shpalime

Nga Historia e lavdishme e Universitetit Shqiptar të Tetovës Universiteti Shqiptar i Tetovës, me këtë emër ka hyrë edhe në Parlamentin e Evropës, nga viti 1995, kur pushteti i Maqedonisë e luftonte në të gjitha format dhe me të gjitha mjetet, kur fatkeqësisht edhe disa politikanë dhe intelektualë shqipfolës, të cilët ende kullosnin në livadhet e propagandës serbomadhe në Maqedoni, atë e quanin paturpësisht "Foshnjë e vdekur", "I ashtuquajturi universitet në Reçicë të Vogël", "Dyqani i Fadilit", "Kotec i pulave" etj.

Nga Arkivi i Bashkësisë Kulturore Shqiptare në Maqedoni, kësaj radhe ju paraqesim një dëshmi të pa publikuar deri më sot, që ka të bëjë me historikun, fillimin e veprimtarisë së Universitetit të Tetovës, afirmimin ndërkombëtar të këtij institucioni të parë të arsimit të lartë në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë.

Pas themelimit dhe fillimit të punës së këtij Universiteti, në mënyrë të organizuar dhe mbi baza vullnetare, shumë veprimtarë shqiptarë në Mërgatë, kanë ndihmuar sa kanë mundur dhe në forma të ndryshme, ndër të cilët edhe miku im Xhemil Zeqiri nga Zhelina e Tetovës, veprimtar i dalluar me punë dhe qëndrim në Danimarkë, i cili në vitin 1995 e ka njoftuar Parlamentin e Evropës, përmes delegacionit danez, për shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, të drejtën e mohuar nga pushteti për arsimim universitar në gjuhën amtare të shqiptarëve në Maqedoni, në mbrojtje të Universitetit të Tetovës, i cili atëkohë goditej pamëshirë nga pushteti, qarqet shoviniste serbomëdha, mediet

në gjuhën maqedonase dhe ndonjë politikan shqiptar, që edhe më tej kulloste në livadhet e propagandës serbomadhe kundër arsimit universitar në gjuhën shqipe.

Me këtë rast e ritheksojmë se, veprimtarë si Xhemil Zeqiri asnjëherë nuk janë lavdëruar për punën e tyre, as janë përmendur në ndonjë rast solemn në shënimin e ndonjë përvjetori të themelimit, punës dhe veprim-tarisë së këtij Universiteti, sepse njerëzi me ideale, ata që kanë lënë gjurmë me punën e tyre në lëvizjen kulturore, arsimore, politike dhe atdhetare të shqiptarëve në dekadat e fundit të shekullit të kaluar, nuk vuajnë për famë personale, privilegje dhe mirënjohje publike për punën e tyre, ata thjesht janë veprimtarë e atdhetarë që punojnë e veprojnë me zemër, për idetë dhe idealet e tyre, në dobi të interesave kombëtare.

Nga dokumenti i bashkëngjitur si dëshmi, ajo që duhet të përmendet është fakti se, diplomacia evropiane, sidomos ajo daneze, në frymën demokratike perëndimore, që nga fillimet e punës së tij e ka njohur këtë institucion të parë të arsimit të lartë në gjuhën shqipe në Maqedoni, si: Universiteti Shqiptar i Tetovës (nga muaji gusht 1995), ashtu siç ka qenë i emërtuar në dokumentet e para për themelimin e Universitetit të Tetovës, në periudhën para Kuvendit themelues të tij, më 4 qershor 1994.
Historia e Universitetit të Tetovës, si e asnjë universiteti tjetër në botë, sa njeh historia e njerëzimit, është e madhe, e pashtershme dhe me përmasa historike, që edhe brezat e ardhshëm do të kenë çfarë të hulumtojnë, studiojnë dhe shkruajnë.

DEMOKRACIA E BLLOKUAR NË SERBI: PROTESTAT, REPRESIONI DHE HIJA E PROPAGANDËSSË VITEVE ’90

Prej disa muajsh, Serbia është tronditur nga një valë e vazhdueshme protestash qytetare, të udhëhequra kryesisht nga studentë, intelektualë dhe aktivistë të shoqërisë civile. Kërkesat e tyre janë të qarta: zgjedhje të lira, media të pavarura dhe fund i autoritarizmit gjithnjë në rritje. Por përballë kësaj zgjimi demokratik, reagimi i autoriteteve ka qenë brutal dhe represiv.

Pamjet e përplasjeve mes protestuesve dhe forcave speciale të policisë janë bërë virale, duke nxitur shqetësim ndërkombëtar. Dhuna ndaj studentëve, ndalimet arbitrare dhe heshtja e institucioneve kanë ekspozuar një realitet të hidhur: demokracia në Serbi është në krizë të thellë.

Një regres i rrezikshëm:

Serbia, e cila për dekada u përpoq të heqë qafe imazhin e një shteti autoritar të trashëguar nga regjimi i Millosheviqit, sot po rikthehet në të njëjtën spirale shtypjeje. Mekanizmat e shtetit përdoren për të frikësuar qytetarët, për të shuar çdo zë kritik dhe për të konsoliduar pushtetin politik përtej çdo norme demokratike.

Ndërkohë që qeveria mundohet të paraqitet si e hapur ndaj Perëndimit dhe integrimit evropian, realiteti në terren tregon të kundërtën: media të kapura, drejtësi e politizuar dhe mungesë totale transparence në proceset zgjedhore.

Bumerangu i propagandës.

Ironikisht, Serbia po përjeton sot atë që dikur akuzonte të tjerët. Në vitet 1989 -90, mediat shtetërore serbe përhapnin lajme të rreme mbi “masakra dhe terror” në vendet fqinje si Shqipëria dhe Rumania. Shifra të ekzagjeruara, si 600.000 të vrarë në Rumani, u përhapën nga Beogradi në një përpjekje për të legjitimuar qëndrimin e vet autoritar dhe për të destabilizuar fqinjët.

Por, historia ka një mënyrë të veçantë për të kërkuar llogari. Sot,

Serbia përballet me të njëjtat akuza që dikur ua hidhte të tjerëve. Në vend që të nxjerrë mësime nga e kaluara, shteti serb po ringjall po ato praktika që dikur i përdorte si armë politike.

Heshtja ndërkombëtare dhe roli i shoqërisë civile

Reagimi ndërkombëtar ndaj situatës në Serbi ka qenë i vakët, në mos krejtësisht pasiv. Megjithëse disa organizata ndërkombëtare për të drejtat e njeriut kanë ngritur zërin, presioni i vërtetë diplomatik ka munguar. Kjo heshtje i jep autoriteteve serbe një mesazh të rrezikshëm: se mund të veprojnë pa pasoja.

Në këtë kontekst, roli i shoqërisë civile dhe i rinisë intelektuale bëhet vendimtar. Ata po mbajnë gjallë idealin demokratik në një mjedis ku liria e shprehjes kërcënohet çdo ditë. Ata janë shpresa më e madhe për një Serbi ndryshe – një Serbi që i përket qytetarëve, jo klaneve politike dhe strukturave të vjetra shtypëse.

Përfundim:

Serbia ndodhet në një moment kritik. Rruga që zgjedh sot do të përcaktojë jo vetëm të ardhmen e saj politike, por edhe vendin që ajo do të ketë në familjen evropiane. Një shtet që përdor dhunën ndaj studentëve dhe frikëson qytetarët nuk mund të pretendojë të jetëdemokratik.

Është koha që Serbia të përballet me të vërtetën. Dhe është koha që bashkësia ndërkombëtare të mos qëndrojë më neutrale përballë këtij regresi alarmues.

Kopenhagë, 30 . 06. 2025

RIKONSTRUKTIMI I IDENTITETEVE KOMBËTARE NË BALLKAN: RASTI I MALËSISË DHE SHQIPTARËVE NË SERBI

Në këtë artikull dua të shqyrtoj procesin e ndërtimit të Identiteteve kombëtare në Ballkan përmes analizës së dy rasteve konkrete: krijimi i kombit malazez në kontekstin historik të Malësisë Shqiptare dhe pozita e shqiptarëve në Serbi bashkëkohore. Duke u mbështetur në deklarata publike, burime historike dhe intervista të dokumentuara, trajtohet çështja e manipulimit të Identitetit si instrument politik me pasoja të drejtpërdrejta mbi të drejtat kulturore e gjuhësore të popullsisë shqiptare autoktone.

1. Rikonceptimi i Malësisë: Nga Malësia Shqiptare në "Komb Malazez" ?!!!

Në një prononcim të pazakontë për realitetin politik të rajonit, intelektuali dhe ish -Ministri i Jashtëm i Serbisë, Vuk Drašković, është shprehur se: "Nuk ka serbë, nuk ka Kishë Serbe, por janë malazezë dhe Kisha malazeze." Kjo deklaratë, përtej dimensionit fetar dhe institucional, përmban një mesazh të rëndësishëm mbi proceset e krijimit të Identiteteve kombëtare në Gadishullin ILIRIK apo hapësirën e Ballkanit.

Koncepti i "kombit malazez" është një konstrukt relativisht i ri në historinë moderne të rajonit. Ajo që sot njihet si Mali i Zi, në përkthim nga sllavishtja Crna Gora dhe në përdorim ndërkombëtar "Montenegro", nuk përkon me emërtimin dhe realitetin historik të njohur ndër shqiptarë si Malësia e Shkodrës. Malësia nuk ka qenë kurrë "e zezë" si në përkthimin sllav, por ka qenë pjesë e trungut etnokultur shqiptar, me një identitet të dallueshëm që i paraprin formimit të shtetit malazez.

Krijimi i një "kombësie" të re përmes një emërtimi të jashtëm (Mali i Zi) dhe formësimi i një identiteti të ndarë nga rrënjët shqiptare përbën një ndër shembujt më të qartë të procesit të

etnogjenezës së dirigjuar. Ky proces nuk ishte neutral, por i orientuar kundër interesave kombëtare shqiptare dhe shpeshherë i shoqëruar me politika asimiluese, shpërngulje dhe fshirje e kujtesës historike.

2. Shqiptarët në Serbi: Një Realitet i Mohuar?!

Në një deklaratë zyrtare të vitit 2025, një përfaqësues i qeverisë serbe u shpreh se në Serbi jetojnë rreth 700.000 shqiptarë. Kjo shifër është në përputhje me një intervistë të gazetës Politiken të Danimarkës në vitin 1996 me avokatin shqiptar, Hysni Bytyqi, i cili pohonte ekzistencën e mbi 600.000 shqiptarëve, prej të cilëve vetëm në Beograd rreth 150.000. Megjithatë, ndonëse me këtë përmasë demografike, shqiptarët në Serbi mbeten të privuar nga të drejtat themelore të përfaqësimit, organizimit dhe arsimimit në gjuhën amtare. Në kryeqytetin serb nuk ekziston asnjë Shoqatë Kulturore Shqiptare, asnjë shkollë në gjuhën shqipe. Kjo përbën një shkelje flagrante të konventave ndërkombëtare mbi të drejtat e pakicave. Në Sanxhak, një krahinë e banuar historikisht nga shqiptarët, është vërejtur një ringjallje kulturore në vitet e fundit, ku individë të përkushtuar si Amina Nuraj kanë filluar hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, megjithëse përballen me pengesa të vazhdues-hme nga instituc-ionet shtetërore.

Përfundim

Të dy rastet – ai i ndërtimit të identitetit malazez në kurriz të Malësisë shqiptare dhe ai i mohimit të të drejtave bazike të shqiptarëve në Serbi – dëshmojnë për vazhdimësinë e një politike shtetërore që synon kontrollin, asimilimin dhe shpër-bërjen e identitetit shqiptar në hapësirat historike të tij.

Këto realitete kërkojnë një vëmendje më të madhe nga akademia shqiptare, si dhe një angazhim më të strukturuar të faktorëve politikë dhe diplomatikë shqiptarë, për të dokumentuar, ndërkombëtarizuar dhe adresuar këto fenomene në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe parimet e barazisë kulturore.

Qerret i Kavajës, 10 Korrik, 2025

ALARM KOMBËTAR/ MIELLI SERB PO HELMON SHQIPËRINË – I NDALUAR NË BE, I LEJUAR KËTU!

Tregtia e Tregut që është pa kontroll të rreptë shënde-tësor helmon popullin në Shqipëri!
Një analizë kritike mbi ndikimin e kapitalizmit të pakontrolluar në shëndetin publik, me fokus te buka si produkt bazë ushqimor.
Parathënie Kapitalizmi në Shqipëri ka marrë formën e tij më të egër: një sistem i lirë tregu pa etikë, pa kontroll, pa ndjeshmëri ndaj jetës njerëzore. Përfitimi ekonomik vendoset mbi shëndetin e qytetarit. Shembulli më flagrant i këtij realiteti është buka e përditshme e shqiptarëve, e cila prodhohet me miell që përmban substanca të rrezikshme, të ndaluara në BE, por të lejueshme në tregun shqiptar.
Përmbajtja e bukës në Shqipëri: një listë helmesh të ndaluara nga BE Nga analiza të pavarura dhe burime nga industria ushqimore, rezulton se buka në Shqipëri prodhohet me përmbajtje mielli të importuar kryesisht nga Serbia. Ky miell, pavarësisht kostos së ulët, vjen i pasur me përzierës kimikë të rrezikshëm:
· Fosfat natriumi (E -339)
· Fosfat kaliumi (E -340)
· Fosfat kalciumi (E -341)
· Klor (E -925)
· Dioksid klori (E -926) – zbardhues industrial, i ndaluar në BE për shkak të potencialit mutagjen dhe kancerogjen.
·Agene (triklorid azotik) – agjent zbardhues, i ndaluar globalisht, lidhur me dëme neurologjike në eksperi-mente laboratorike.
Statusi ligjor në BE: Sipas rregullores së Komisionit Evropian (Reg. 1333/2008) dhe vlerësimeve të Autoritetit Evropian për Sigurinë Ushqimore (EFSA), shumica e këtyre substancave janë të ndaluara në produktet e brumit, në veçanti në ato të konsumit të përditshëm.

Shqipëria si "zonë e lirë tregtare" dhe, ngaqë i ka eliminuar te gjitha institucionet përkatëse te kontrollit te ushqimeve bujqësore e blegtorale qe kish pasur para viteve 90 -të për helmet ushqimore, si rrjedhojë nuk disponon kapacitete efektive laboratorike apo mekanizma monitorimi sistematik të miellit dhe produktit final – bukës. Si rrjedhoje, Shqipëria është një treg i hapur ndaj helmeve ushqimore që BE -ja i ka ndaluar që prej dekadash.

Rreziku shëndetësor: nga fëmijët te sëmurët kronikë. Gjithashtu, sipas te dhënave te institucioneve Evropiane, Shqipëria renditet në vendet me incidencë të lartë të sëmundjeve gastrointestinale dhe të sistemit nervor te fëmijët. Institucione si OBSH dhe UNICEF kanë sinjalizuar për rritje të rasteve me tumore dhe sëmundje kronike që lidhen me ushqimin. Përderisa buka është ushqimi kryesor, ndikimi i saj është potencialisht katastrofik.

Origjina e dyshimtë: Serbia si furnizues i miellit të lirë dhe të rrezikshëm Mielli nga Serbia hyn lirë në tregun shqiptar. Pavarësisht historikut politik dhe ekonomik të dëmeve nga ky shtet ndaj shqiptarëve, tregtia e miellit është jo vetëm e pakontrolluar por edhe favorizuar nga segmentet tregtare të lidhura me interesat importuese.

Kapitalizmi pa kontroll = degradim kombëtar Kapitalizmi që nënvlerëson jetën e qytetarit në emër të fitimit është forma më e rrezikshme e shkatërrimit social. Kur buka – simbol i jetës dhe kulturës shqiptare – kthehet në burim sëmundjeje, atëherë kemi humbur jo vetëm trupin, por edhe shpirtin e kombit.

Rekomandime

· Ndalim i menjëhershëm nga Qeveria i importit të miellit jashtë standardeve të BE.

· Rifuksionimi I institucioneve përkatëse për analizat e detyrueshme laboratorike për çdo produkt importi dhe prodhim vendas me bazë brumi.

· Edukim i vazhdueshëm I konsumatorit përmes mediave kombëtar dhe stimulimi e mbështetja e prodhuesve të ndershëm vendas, nen një kontroll te rrepte laboratorik shkencor.
Përfundim Kjo është thirrje për reflektim kombëtar. Të mos mbrojmë bukën që hamë, është të heqim dorë nga vetë ekzistenca jonë. Koha për veprim është tani.

Zhelinë, 30. 07. 2025

Pse po varroset tradita dhe kultura shqiptare, nga klerikët islamistë?

ËSHTË NEVERITËSE KUR EDHE NË RASTE TË VDEKJES NGA INSTITUCIONET FETARE ISLAME EKZISTON DYSHIMI SE PO BËHET KORRUPSIION, GJEGJËSISHT HAJNJI PERFIDE?!

Para pak javësh, më vdiç babai im, Servet Zeqiri.
U mërzita për babain, por vërtet u trondita; çfarë pashë e dëgjova në vendlindjen time në katundin Zhelinë të Tetovës.
Pse them kështu, do ta sqaroj pikërisht në këtë shkrim.
...Është një element tjetër i hidhur i bazuar në fakte, që dëshmon se kemi të bëjmë me një sistem të stisur, jo me një traditë fetare të konsoliduar as autoktone çfarë po ndodh në atdheun tonë;
-veç tjerash, si mbulesat nga femrat;-ferexhet, dikur të harruara në shtëpitë tona pantallonat përçudnuese të shkurtra nga meshkujt, e të tjera devijime...,-të neveritshme...,-shqetëson dhe fakti që po ndodhin dallime të theksuara financiare nga një zonë në zonën tjetër në aspektin e pagesës për varrosjen e të vdekurve?!!!
-Fjala vjen, në fshatin tim në Zhelinë, ceremonia mortore arriti një kosto mbi një mijë euro, ndërsa në disa fshatra të tjera po të të njëjtit rajon, varrimi kryhet vetëm për rreth pesëqind euro?!!!
Në qytete, çmimet ndryshojnë sërish, sipas një logjike të paqartë dhe jo transparente. Këto dallime nuk mund të shpjegohen me ndonjë normë fetare, sepse feja, në parim, nuk trashet me tarifa të lëvizshme sipas vendbanimit.
-Përkundrazi, ato dëshmojnë ekzistencën e një sistemi vetëqeverisës informal, ku çdo grup klerikësh vendos rregullat, numrin

e pjesëmarrësve dhe kompensimin financiar sipas dëshirës dhe rrethanave. Kur një ritual themelor i jetës shoqërore,
-siç është varrimi, i nënshtrohet logjikës së tregut kapitalist; pa asnjë mbikëqyrje institucionale, atëherë kemi të bëjmë me një formë korrupsioni të organizuar, ku nuk sundon ligji, por ku vjedh "Maliqi"
Jo domosdoshmërisht, në kuptimin penal, por në kuptimin moral dhe kulturor; përdorimi i autoritetit fetar, hoxhës, mullait apo imamit; për përfitim të tyre material, në një moment kur familja ndodhet në gjendje të rëndë emocionale, kur është e pafuqishme për të kundërshtuar çmimin pa tavan...
-Kjo praktikë grabitjeje krijon një realitet të mjerë kombëtar, ku identiteti dhe dinjiteti i të ndjerit varet nga mundësitë financiare të familjes dhe jo nga tradita apo besimi.
Në këtë mënyrë, feja nuk shërben më si mbështetje shpirtërore, por si mekanizëm imponimi dhe pozitat shoqërore?!
Mungesa e një ligji të fuqishëm, të përbashkët dhe dënimi për këto dallimet ekstreme; nga fshati në fshat, apo nga qyteti në qytet; e bëjnë të qartë se nuk kemi të bëjmë me trashëgimi kulturore as fetare shqiptare, por, me një model të ri, të huazuar, apo të ndikuar nga qarqet të huaja reaksionare të pjesërishme i cili degradon keq në anarki, del jashtë çdo kontrolli publik dhe jashtë interesit kombëtar.

Kopenhagë, 27.12.2025



(Për festat e nëntorit, Komuna e Tetovës organizoi edhe përurimin e librit tim Në mbrojtje diplomatike të çështjes shqiptare, dhe me këtë rast më dekoroi kryetari i Komunës, Bilall Kasami.)

REAGIM PËRKITAZI ME "REAGIMIN E MEXHLISIT TË XHAMISË NË ZHELINË".

Eeee, mjerë populli ynë që ka këta klerikë që, në radhë të parë, nuk e kuptojnë se çfarë është besimi?!
Ne, shqiptarët kemi një fe,-kemi-Shqiptarinë.
Ndërsa, besimet janë të shumta: myslimane, të krishtera, katolike, ortodokse; e të tjera.
Ajo që ndodhi tani, me reagimin krejt të pakuptim ndaj meje, është një turp i tyre.
Nuk di nëse atë reagim e kanë nënshkruar edhe dy hoxhallarët e xhamive, apo ndoshta të dy "avokatët e gjallë", Nezir Baftjari dhe Enes Hasani, të cilët dolën me reagimin ndaj meje me titullin:
"Reagim Publik – Mexhlisi i Xhamisë Zhelinë"?!!!
Dolën kundër artikullit tim, "Pse po varroset tradita dhe kultura shqiptare, nga klerikët islamistë"?
-Personalisht, kam pritur që të dalin atdhetarët e vërtetë, me guxim për të thënë të vërtetën, realitetin çfarë po ndodh, jo, që të më mbrojnë mua,–Xhemil Zeqirin, me një veprimtari 44 vjeçare, në mbrojtje të çështjes kombëtare shqiptare.
E gjithë rinia ime në Danimarkë, kaloi duke protestuar dhe duke punuar me Organizata të ndryshme përparimtare në shërbim të popullit dhe të atdheut tim. Prej vitin 1981,kam vepruar edhe me miqtë e mi danezë, themelova "Komitetin Miqtë e Kosovës". Jam themelues i shoqatës "Kulturore Besa", në Kopenhagë, të cilën e ngrita me financat e mia personale. Kam qenë veprimtar i Lëvizjes Popullore të Kosovës, si dhe për disa vite Nënkryetar i Organizatës daneze "STS International Solidaritet". Poashtu, kam themeluar Këshillin e Lëvizjes Vetëvendosje, në Danimarkë Këshilli i parë në Skandinavi dhe në Evropë. Jam marrë me publicistikë dhe shumë veprimtari të tjera...

Asnjëherë nuk kam mbajtur qëndrim kundër banorëve të zonave rurale apo popullit në përgjithësi; përkundrazi, kam qenë dhe mbetem kundërshtar i klerikëve manipulues dhe i aktorëve politikë që historikisht kanë shërbyer si mbështetje e interesave të pushtetmbajtësve.

Gjatë gjithë këtyre viteve kam zhvilluar veprimtari me Ministritë e Jashtme të Danimarkës dhe të Suedisë; duke ngritur çështjen shqiptare në instancat më të larta ndërkombëtare: në Këshillin e Evropës, Parlamentin Evropian, OSBE, e deri në OKB, në Nju Jork.

Këto nuk i përmend për lavdinë time personale, por për t'ua kujtuar hoxhallarëve të fshatit tim të lindjes dhe rritjes sime, të cilëve, fatkeqësisht, –as që u ka interesuar veprimtaria atdhetare e një bashkëfshatari të tyre. Përkundrazi, në heshtje më kanë luftuar, gjë që dëshmohet edhe nga reagimi i tyre. Si mund të shpjegohet fakti i mjerë, kur në atë reagim steril, më quajnë "anti-kombëtar" dhe "anti-fetar"?!!!

Feja ime është Shqiptaria; ndërsa besimi është çështje personale. Ju, me qëllim, i ngatërroni këto dy gjëra me shumë me rëndësi.

Unë kam besuar gjithmonë në Zot, por, s' kam besuar në mashtruesit që tallen me popullin në emër të Zotit! Pikërisht, të tillë janë dy përpiluesit e këtij reagimi, i cili në fakt nuk është gjë tjetër veçse një peticion publik i mbushur me mllef dhe hipokrizi. Madje, për këtë çështje as nuk isha i njoftuar. Për këte "Peticion" më informoi bashkëfshatari ynë, Bashkim Arsllani, i cili kishte debatuar në faqen e Facebook-ut të xhamisë së fshatit.

Në artikullin tim, unë i sqarova qartë qëndrimet dhe procedurat për çështjen e varrimit, duke marrë shembull rastin e babait tim të ndjerë. Ceremonia e varrimit u zhvillua, sikur të ishim në Arabi?!!! Të gjitha lutjet dhe ritualet tjera ishin në gjuhën arabe!!! Ato, rituale ishin pa asnjë lidhje me traditën tonë as në interesin tonë kombëtar shqiptar.

E, pastaj, këta zotërinj marrin guximin moral që, mua të më quajnë anti-kombëtar?!!!

Qenkam anti-kombëtar dhe i pa fe, "për mëkatet" e mia, sepse nuk jam arab, pse desha që lutjet dhe ritualet për babain të ishin në gjuhën shqipe. Unë, nuk e kuptoj arabishten, pse të dëgjoj lutje dhe rituale të tjera, në një gjuhë që s'e kuptoj? Apo, qenkam i pa fe, pse jam shqiptar dhe flas shqip, prandaj, ritualet e varrimit të babit tim, doja t'i kuptoja?!!!

Jam i bindur se publiku e di mirë kush jam. Më njohin shqiptarët, jo vetëm në katundin tim dhe në rrethinë, por më njohin nga të gjitha trojet shqiptare dhe nga mërgata, deri përtej të oqeanit. Për mua kanë shkruar me admirim të madh, mbi 50 intelektualë shqiptarë dhe më shumë se 10-të intelektualë dhe akademikë danezë. Kam botuar rreth 250 artikuj për vuajtjet e shqiptarëve në trojet tona etnike në Ilirik (Ballkan) dhe jam autor i nëntë librave publicistike.

Po citoj dy rreshta nga një shkrim i Prof. Dr. Hulusi Hakos, ish-rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës, i cili shkroi pa më njohur nga afër, vetëm kur në Bibliotekën e Tiranës e kishte lexuar librin tim: "Këto janë disa nga mesazhet e vëllait tonë, Xhemil Zeqiri, nëpërmjet librit 'Kosova Jonë'. Mund t'i themi me pak fjalë: Hallall gjiri i nënës në Zhelinë të Tetovës!" Pra, fshatit tim ia kam ngritur emrin dhe nderin në Shqipërinë tonë dhe në mbarë globin.

-Nuk kërkoj që dikush të më mbrojë! Mua, më mbron veprimtaria ime atdhetare 44-vjeçare.

Kërkoj vetëm që e vërteta të thuhet, ashtu siç e meriton secili që ia ka kushtuar jetën kombit; dinjitetit dhe identitetit shqiptar.

Ndërsa, shpifjet, intrigat dhe trillimet, janë si flluska sapuni, ato do të shkrihen së shpejti, do të mbeten veçse, njolla turpi për dështakët...

Kopenhagë 08-02-2026

AKADEMITË QË PO E LUFTOJNË GJUHËN SHQIPE

Kur armiqtë e kombit flasin në emër të shkencës?!!!
Në vend që të jenë kështjella të dijes dhe mbrojtjes së identitetit kombëtar, Akademitë e Tiranës dhe Prishtinës po shndërrohen gjithnjë e më shumë në instrumente të shërbimit kundër gjuhës shqipe. Me paratë e taksapaguesve shqiptarë, atje botojnë libra që nuk mbrojnë, por cenojnë dinjitetin gjuhësor e kulturor të kombit.
Akademikë në shërbim të së huajës reaksionare!
Ka kohë që disa akademikë shqiptarë janë vënë në shërbim të armiqve të kombit, duke tentuar të rrënojnë nga brenda shtyllat e identitetit tonë. Kur është fjala për historinë, kulturën dhe gjuhën shqipe, këta njerëz shfaqen si "shkencëtarë", por në fakt janë tradhëtarë të heshtur të vetë kombit që i ushqen.
Së fundmi, dy "akademikë" nga Prishtina, Nazmi Lleshi dhe Bardh Rugova, kanë botuar një libër me titull "Fjalori i turqizmave në gjuhën shqipe", me plot 497 faqe dhe mbi 14.500 fjalë. Në pamje të parë, libri duket si një përpjekje leksikografike, por në thelb është një fyerje ndaj lashtësisë dhe pastërtisë së shqipes.
Kjo qasje, që e paraqet shqipen si gjuhë të njollosur, të varur nga ndikimet turke, është pjesë e një strategjie të vjetër për të ulur vlerën e gjuhës sonë dhe për ta paraqitur atë si një gjuhë pa rrënjë të thella në historinë evropiane.
Akademia e Tiranës – heshtje ose bashkëfajësi
Ky fenomen nuk është i izoluar. Akademia e Shkencave e Tiranës ka botuar edhe më parë vepra të ngjashme, që nën petkun e "studimeve shkencore" zbehin identitetin kombëtar dhe e mbulojnë shqipen me hije të huazimeve të rreme. Kjo nuk është shkencë, por degjenerim i qëllimshëm kulturor.
Zëri i kundërshtimit

Në këtë errësirë të fabrikuar, shfaqen zëra që nuk pranojnë të heshtin. Njëri prej tyre është studiuesi Agron Dalipaj, i cili me argumente shkencore po u hedh poshtë këtyre "akademikëve" çdo përpjekje për të rishkruar historinë dhe gjuhën shqipe. Dalipaj përfaqëson atë që duhet të ishte fryma e vërtetë e akademisë – mbrojtja e së vërtetës dhe e gjuhës amtare.

Pse shqipja është e shenjtë?!

Popullit shqiptar nuk i ka mbetur gjë tjetër përveç historisë, kulturës dhe gjuhës – tri shtylla që e kanë mbajtur gjallë kombin tonë për mijëra vjet. Dhe është pikërisht aty ku godasin armiqtë e sotëm: në kujtesën dhe ndërgjegjen kombëtare. Kur nuk mund të na mposhtin me armë, përpiqen të na tjetërsojnë me "fjalorë". Por historia flet ndryshe. Zbulimet arkeologjike, si rasti i qytetit të Linës në Shqipëri, si dhe kërkimet e studiuesve amerikanë e evropianë, po dëshmojnë për lashtësinë e gjuhës dhe qytetërimit shqiptar. Ndërsa, bota po e njeh këtë të vërtetë, disa "akademikë" të paguar nga populli po përpiqen ta mohojnë.

Përmbyllje

Koha e heshtjes ka mbaruar. Gjuha shqipe nuk ka nevojë për "fjalorë turqizmash", por për fjalorë krenarie kombëtare. Ajo nuk është gjuhë e huaj në truallin e vet, por rrënja e vetë Evropës. Kush e lufton shqipen, e lufton kombin. Dhe kush e mbron shqipen, mbron Shqipërinë.

Zhelinë, 13.11.2025

KOSOVA NUK MUND TË ECË PËRPARA ME PINJOLLËT TITISTO -RANKOVIÇIANË?!

Bedri Hamza dhe hijet e shtëpisë së vjetër?!
Trishtuese!
I biri i shoferit të klasës politike të Rankoviqit, Kandidat për Kryeministër?!!!
Kosova shpesh flet për ndryshime politike, por në realitet shumë nga udhëheqësit e saj janë, janë pasardhës të elitave shqipfolëse, që dikur i shërbyen Beogradit.
Nëse dikush mendon se këto janë vetëm thashetheme politike, rasti i Bedri Hamzës është shembulli më i mirë që e vërteton këtë maskaradë politike. Kryetar i Komunës së Mitrovicës dhe kandidat për Kryeministër nga PDK-ja, Hamza shfaqet si teknokrat i përgatitur, por mbi të rëndon një trashëgimi e errët familjare që nuk mund të fshihet.
Deli Hamza: Shoferi i pushtetit të hekurt.
Në Kosovën e viteve të Rankoviqit, shumë shqiptarë u shtypën, u burgosën e u dëbuan nga atdheu nga dhuna dhe terrori serbomadh në aksionin famëkeq të mbledhjes të armëve.. Por, kishte edhe nga ata që u afruan fort me pushtetin. Babai i Bedri Hamzës, Deli Hamza, ka qenë shofer në një Organizatë Punuese, (emri nuk po më kujtohet), ka vozitur drejtorët!… Kur Rankoviqi – arkitekti i terrorit dhe masakrave ndaj shqiptarëve, – vdiq në vitin 1983, familja Hamza; jo vetëm mori pjesë në ceremonitë mortore në Beograd, por hapi derën e shtëpisë për të pritur ngushëllime për vdekjen e tij. Ky veprim, në kulturën shqiptare, nuk është gjest i zakonshëm: është akt besnikërie ndaj një njeriu, tmerrësisht i terrorizoi shqiptarët për dekada.
Tito -Rankoviqi: Urrejtja ndaj xhelatëve Tito - Rankoviq, ende nuk është harruar nga kujtesa e popullit të e Kosovës dhe kombit shqiptar.
Për shumë familje shqiptare, emri i Titos dhe i Rankoviqit

përfaqësojnë një epokë dhune të pashoqe:
Atëbotë, mijëra arrestime, turpe krime ekzekutime të rënda edhe pa gjyqe kanë ndodhur ndaj shqiptarëve;
Zhvendosje masive dhe kolonizim të Kosovës me serbë ardhacakë nga Serbia, Mali Zi e gjetkë kanë ndodh.
Mohim i identitetit dhe represion i egër kulturor; ndalimi i Flamurit Kuqezi dhe i shkollave shqipe etj…
Në këtë realitet të hidhur, fakti që disa shqiptarë i shërbyen pushtetit dhe madje nderuan vdekjen e tij tregon strukturat e nënshtrimit dhe bashkëpunimit që ende ndikojnë në politikën shqiptare në Kosovë.
Sinan Hasani: Shqiptari që Beogradi e përdori si fasadë
Në atë kohë, një tjetër figurë simbolike ishte Sinan Hasani, president shqiptar i Kryesisë së Jugosllavisë në vitet 1980. Sinan Hasani paraqitej, kinse si përfaqësues i shqiptarëve, por në të vërtetë ishte vegël qorre e Beogradit.
Ai ngriti karrierën mbi besnikëri ndaj regjimit serbo - jugosllav;
Në vend që të mbrojë shqiptarët, Sinan Hasani ishte pjesë e makinerisë politike që mbante Kosovën të nënshtruar.
Ky mjedis politik shpjegon pse lidhjet familjare me pushtetin serb ishin rrugë drejt karrierës, ndërsa ata që rezistonin përfundonin në burgje ose në varre.
Bedri Hamza: Pse heshtë si mumie për të kaluarën?
Në një shoqëri demokratike, një politikan i madh do të përballej hapur me historinë e familjes së tij. Por, Bedri Hamza nuk ka kërkuar kurrë falje apo distancim nga aktet e turpshme të së kaluarës familjare.
Ai, ka preferuar të ndërtojë imazh të "ekspertit të ekonomisë", duke shmangur çdo diskutim për rrënjët që e sollën në këtë pozitë.
Pyetjet dhe dyshimet janë të qarta:
Si mund të jetë Kryeministër një njeri që nuk është përballur me të kaluarën e familjes së vet?

A është Bedri Hamza përfaqësues i një politike të re demokratike, apo simbol i elitave të ricikluara që e shohin pushtetin si trashëgimi?
Elitat e trashëguara: Rrënjët e korrupsionit? !
Kosova, është ende peng i një klase politike që lindi nga rrjetet e pushtetit të Jugosllavisë. Figura të dyshimta, si ky Bedri Hamza; nuk janë përjashtim, por simbol i një problemi strukturor:
Pushteti nuk fitohet mbi meritë kombëtare;
Karrierat politike po ndërtohen mbi lidhje të trashë-guara.
Përgjegjësia morale mungon, ndërsa, qytetarët humbasin besimin.
Përfundim: Koha për të thyer heshtjen!
Kosova, nuk mund të ecë përpara pa u përballur me të kaluarën. Bedri Hamza dhe shumë politikanë të tjerë bartin mbi supe hije të së kaluarës që ende dikton të tashmen.
Pa një debat publik mbi këtë trashëgimi, Kosova do të vazhdojë të riciklojë të njëjtët liderë që nuk përfaqësojnë interesat e vërteta të kombit.
Deri kur?!

Kopenhagë, 12.09.2025

BALLKANI I HAPUR: NJË PLATFORMË E KAMUFLUAR PËR DOMINIMIN SERB NË RAJON

1. Konteksti Rajonal dhe Shtytjet për "Integrim".

Pas shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë, rajoni i Ballkanit ka kaluar përmes proceseve të vështira të tranzicionit politik dhe ekonomik. Në këtë peizazh të brishtë, nisma të ndryshme për bashkëpunim rajonal janë promovuar si mjete për stabilitet dhe zhvillim. Një prej këtyre është "Ballkani i Hapur", një projekt i nisur nga Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut në vitin 2019. Megjithatë, prapa diskursit për "bashkëpunim ekonomik" dhe "zhvillim të përbashkët", qëndron një logjikë politike e rrezikshme: krijimi i një hapësire të kontrolluar nga Serbia, e cila synon të zhbëjë kufijtë politikë për të forcuar kontrollin ekonomik dhe ndikimin ideologjik në rajon.

2. Serbia si promotor i një nisme me ambicie neo-hegjemoniste

Është e pamundur të kuptohet Ballkani i Hapur pa kuptuar qëllimet e politikës së jashtme serbe. Beogradi, i udhëhequr nga Aleksandar Vuçiq, ka ndërtuar një strategji të dyfishtë: para Bashkimit Evropian sillet si reformator dhe paqebërës, ndërsa në praktikë forcon lidhjet me Rusinë, Kinën dhe vazhdon të destabilizojë Kosovën nëpërmjet strukturave paralele dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë për kriminelët e luftës.

Nisma e Ballkanit të Hapur nuk është asgjë më shumë sesa një mjet për të "normalizuar" dominimin serb nëpërmjet mjeteve ekonomike, duke shmangur diskutimin për të kaluarën kriminale të shtetit serb në rajon, pa kërkuar falje dhe pa pranuar realitetin e pavarësisë së Kosovës.

3. Qëndrimi i Qeverisë Kurti: Refuzim i drejtë dhe me bazë shtetformuese

Kryeministri Albin Kurti dhe Qeveria që ai udhëheq e kanë kuptuar në mënyrë të saktë këtë dimension politik të Ballkanit të

Hapur. Duke refuzuar pjesëmarrjen në këtë projekt, Kosova nuk e ka mbyllur derën për bashkëpunimin rajonal – përkundrazi, ka kërkuar bashkëpunim në bazë të vlerave të Bashkimit Evropian, të drejtësisë, reciprocitetit dhe barazisë.

Qëndrimi i Qeverisë Kurti është i mbështetur në një filozofi të qartë të shtetformimit demokratik dhe të dinjitetit kombëtar: Kosova nuk mund të integrohet në një rajon ku sundon logjika e mohimit të realitetit të saj si shtet i pavarur dhe ku Serbia ende sillet si padron.

4. Opozita Destruktive: Zëri i Beogradit brenda Kuvendit të Kosovës

Në vend që ta mbështesin këtë qëndrim parimor dhe të qartë shtetëror, partitë opozitare në Kosovë — veçanërisht ato që kanë qenë në pushtet dhe që janë të lidhura me oligarkinë e vjetër — kanë zgjedhur një pozicion që në mënyrë të hapur komprometon interesin shtetëror të Kosovës. Duke e quajtur Ballkanin e Hapur "mundësi", ata i bashkohen retorikës së Beogradit që e sheh Kosovën si një hapësirë të përkohshme, të destinuar të asimilohet.

Këta aktorë politikë jo vetëm që nuk përfaqësojnë interesin qytetar dhe kombëtar, por shfaqin një diskurs të mbushur me urrejtje ndaj Kryeministrit Kurti dhe Qeverisë së tij, duke e bazuar narrativën e tyre në shpifje, gënjeshtra dhe krijimin e një klime të rreme krize – me qëllimin e vetëm për ta de legjitimuar vullnetin demokratik të popullit që votoi për ndryshim dhe drejtësi.

5. Alternativa e Kosovës: Integrimi përmes Bashkimit Evropian

Kosova ka vendosur drejt: bashkëpunimi rajonal nuk mund të jetë zëvendësim për procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Projektet si Ballkani i Hapur nuk janë të nevojshme nëse ekziston përkushtimi i përbashkët për të zbatuar katër liritë e BE -së nëpërmjet Procesit të Berlinit, një platformë që mbështetet fuqimisht nga Gjermania dhe Franca. Qeveria Kurti është angazhuar me seriozitet për këtë alternativë, duke e

pozicionuar Kosovën si një aktor parimor dhe të besueshëm ndërkombëtarisht.

6. Përfundim: Koha e përgjegjësisë dhe e unitetit demokratik

Sot, më shumë se kurrë, Kosova ka nevojë për qartësi strategjike dhe unitet politik. Qeveria Kurti, përkundër presioneve të shumta të brendshme dhe të jashtme, ka ruajtur kursin e saj të drejtë dhe të pavarur në politikën e jashtme. Refuzimi i Ballkanit të Hapur është shprehje e një vetëdije të lartë shtetërore që meriton jo vetëm mirënjohje, por edhe mbështetje të gjerë popullore.

Kosova nuk duhet të pranojë të bëhet pjesë e një "bashkimi" që mohon vetë ekzistencën e saj. Shtetësia, drejtësia dhe dinjiteti nuk janë të negociueshme.

Qerret i Kavajës, 21.07. 2025

JO! NUK QE ASPAK E RASTËSISHME ÇFARË NDODHI NË SHQIPËRINË TONË?!

Po, por, se çfarë ndodhi e po ndodhë në Shqipërinë tonë, duhet bërë një analizë më e hollësishme, duhet të kthehemi që nga viti famëkeq 1989, kur federata jugosllave ishte tronditur nga protestat shqiptare dhe rezistenca për të qenë të barabartë si popujt e Jugosllavisë dhe të Evropës, luftë kjo e udhëhequr nga Organizatat ilegale me simbolin e rezistencës shqiptarëve, Adem Demaçi, në ballë të kësaj lufte paqësore por, me rezistencë shumë aktive, brenda në Kosovë dhe mërgata me demonstrata në Evropë dhe në botë e detyruan Evropën plakë të ndërmerrte diçka.

- Ajo vërtet ndërmori, nëpërmjet aleates së tyre Jugosllavisë, apo thënë më saktë Serbisë Fashiste.

Ato, u detyruan që të merren masa që të formojnë një parti politike - demokratike në Kosovë, sa nuk është miratuar ligji për amnistinë e shqiptarëve nëpër burgjet serbo -jugosllave.

Pra, Serbia Fashiste nëpërmjet agjentëve dhe anëtarëve të vet të devotshëm, formoi Lidhjen Demokratike të Kosovës, në fakt ISH -LKJ ta "refo-rmojë" në parti demokratike. Detyra e tyre ishte që të qetësohen dhe të mashtrohet populli shqiptar në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare, me objektivën të shkonin më tej: që të ndërmarrin hapa që dhe në Shqipërinë Londineze të krijojnë parti demokratike dhe udhëzimet do vijnë nga "demokracitë" botërore.

Serbia, këtë rol e luajti fort mirë në dobi të saj. E gjithë lufta e Serbisë ka qenë si ta shkatërrojë shtetin shqiptar apo ta rrëzojnë pushtetin popullor, pasi që ai pushtet e mbështeste pa rezerva "seperatizmin shqiptar", jashtë kufijve të Shqipërisë Londineze.

Vlen të rikujtojmë faktin shqiptarëve se, atëbotë në Ilirik, kishin mbetur vetëm dy shtete socialiste: Rumunia dhe Shqipëria. Ndërsa, Jugosllavia për një kohë të shkurtë me shpifje dhe

komplote e shkatërroi Rumaninë, e Çausheskut, duke rritë numrin e të vrarëve deri ne 600,00 po në fakt ata kishin qenë vetëm 67, bile me pushkatimin e Çausheskut dhe gruan e tij, ky numër u rrit në 69.
Po si vepruan në Shqipëri pas vdekjes së gjeniut, Enver Hoxha, më 11 Prill 1985?!
Shqipërisë iu ndërprenë marrëdhëniet, pra mallrat shqiptare as u shitnin e as nuk mund të importonin nga shtetet tjera, pasi politika ishte e tillë ku kishin marrëveshje me ish -shtetet socialiste të cilat u bënë kinse, "Demokratike" dhe i prishën marëdhëniet me shtetin shqiptar.
Këtë e shfrytëzoj Serbia nëpërmjet LDK duke e përdorur se ja, "Pushteti Popullor, është kundër krejt botës së, ai pushtet e ka shitur Kosovën, ai pushte ka vrarë e ka burgosur" Intelektual" e të tjera zhurma bla, bla, bla...
Natyrisht, filloi një varfëri pa parë, si në kohën e para luftës së dytë botërore, në anën tjetër TV serbo -jugosllave dhe greke, u liruan dhe TV shqiptare filluan të transmetojnë Arritjet e mëdha ne botën kapitaliste, me ato reklamat, ku duke fluturuar në ajër me koka -kola, binin në det dhe fillonin të pinin koka -kola, në këto situata aspak të lakmueshme Serbia dhe mediat e saj si "Tanjugu" e tjera, shpifnin se ka demonstrata dhe ka shumë të vrarë…
Në anë tjetër Ambasada jugosllave në Tiranë filloi të bashkë-punonte me ambasadat tjera në Shqipëri si ato italiane turke etj, po vetëm një ambasadë nga Lindja e mesme nuk iu përgjigj planit serb, që ajo të pranojë popullin nëpër ambasada si revoltë pakënaqësie, (këtë më tha një mik nga Lindja e Mesme), që e takova rastësisht në Kopenhagë, në një protestë që mori pjesë edhe ai dhe më dha 1000 korona danezë si ndihmë, unë u habita si ka mundësi të shkojnë punët deri aty, kur ai me tregoi se ka qenë në Tiranë si Sekretar dhe se kishte origjinë shqiptare, me ç'rast, tregoi dhe faktin për planin famëkeq jugosllav, që njerëz të pandërgjegjshëm të futeshin nëpër ambasadat, siç theksova

me lart.
Që të mos i përsërisim: shpifjet, akuzat dhe trillimet serbe, tani më edhe ndërmjet të liderëve, "demokratë" "shqiptarë"!
Serbia Fashiste, në fillim ndau 40,000 milion dollarë që të shkatërrohet gjithçka, dhe kjo ndodhi, u shkatërruan 500 -600 fabrika, u prenë 600,000 pemë të ullirit , u dogjën dhe u rrënuan plantazhe të tëra të pemëve dhe agrumeve, u vodhën dhe u shitën të gjitha kooperativat bujqësore e blegtorale.
Kur u dogj dhe u shkatërrua çdo gjë në Shqipëri, natyrisht shtetet fqinje "demokratike" fërkonin duart, sepse e panë qartë që ia arritën qëllimit.
- Me Serbinë partitë anarkiste -neofashiste LDK dhe PDSH filluan të bëhen faktorë me peshë në raportet me "partnerët" apo më saktë me padronët e tyre.
Këta sa për sy a faqe i respektonin, kinse janë liderë si Rugova dhe Saliu, kinse janë parti që bënë ndryshime pozitive në dobi të vendit të tyre etj, prandaj, shqiptarëve nuk iu mbetej tjetër rrugë, veçse të ikin nëpër Evropë, të joshur nga premtimet, gjithçka, por ato që kishin dëgjuar nëpër Ambasadat se, po qe se ikë në Evropë do keni nga një automjet "Benz", banesë superiore, por edhe të ardhura deri në 10.000 dm, dhe do të keni mundësi shkollimi e studimi sa të doni, mund të studioni, por këto as nuk ndodhën kur edhe filloi dëshpërimi i popullit, filluan të shihen qartë mashtrimet, ana e errët e asaj "demokracie" kur njerëzit të shtyrë nga nevojat për mbijetesë filluan të merren me kriminalitet, me drogë, me prostitucion, me fjalë të tjera, Serbia dhe shtete të tjera armike ia arritën qëllimit: të shkatërrojnë unitetin kombëtar të shqiptarëve.
Kjo u arrit në veçanti me vrasjet në mes grupeve se, kush do ketë kontroll në pushtetin me shtet të shkatërruar rëndë, nga të gjitha levat e tij.
Tani, "miqtë tanë" po tallen me ne.
Ata, po na japin ca karamele dhe liderucët dhe liderucët "tona" janë zhytur secili dhe secila më keq e më zi në turpe dhe në

veprimtari kriminale etj.
Pra, me këto veprimtari reaksionare të klasës politike, pas viteve 90 -ta, u penalizua e drejta e shqiptarëve që përherë kërkuan që shtet të mirëfilltë të lirisë, barazisë dhe të drejtësisë. SHQIPTARËVE IU MOHUA DHE PO U MOHOHEN TË DREJTAT SOCIALE, KOMBËTARE, ETJ.
Këto tani janë zv, që prej vitit famëkeq 1989 kanë zëvendësuar, me të drejtën ideologjike: Lufta kundër socializmit dhe lëvdatat për fashizmin, kjo është e tmerrshme çfarë ka ndodhur me Shqipërinë tonë Etnike.

Kopenhagë,13 prill 2025

ARRESTIMI I GAZETARIT, NEXHAT BEHLULI, SULM I RËNDË NDAJ LIRISË SË FJALËS NË KOSOVË?!

REAGIM

Arrestimi i gazetarit Nexhat Behluli, nga Kosova Lindore, në territorin e Republikës së Kosovës për shkak të fjalës së lirë përbën një goditje të rëndë ndaj demokracisë, drejtësisë dhe vetë lirisë për të menduar, shprehur dhe shkruar lirshëm.

Në një vend që pretendon se është shtet demokratik, arrestimi i një gazetari për shprehjen e mendimit të lirë prej tij përbën jo vetëm skandal institucional, por, edhe një paralajmërim të rrezikshëm për çdo zë realist, kritik në shoqëri.

Në vend që Prokuroria e Kosovës të mbrojë ligjin, të mbrojë fjalën e lirë, ajo po tregohet gjithnjë e më shumë si një ekzekutuese me mjetet shtypëse kundër së vërtetës dhe ndjekjen dhe linçimin e atyre që guxojnë të flasin dhe të shkruajmë hapur të vërtetën…

Nexhat Behluli, nuk është kriminel. Ai, është një zë i lirë, një njeri që përfaqëson kauzën e shumë qytet-arëve shqiptarë nga Kosova Lindore, që përfaqëson një komunitet të shtypur, të harruar dhe të (margji-nalizuar) nga institucionet e Prishtinës, të Tiranës dhe të qarqeve euro-atlantike.

Ai nuk u arrestua, për shpifje, as për nxitje dhune, por për fjalë për një ngjarje reale…. Prandaj, arrestimi i tij është i papranueshëm.

Për më tepër e më keq: arrestimi i tij është një turp për Drejtësinë në Kosovë dhe për institucionet që duhet ta garantojnë lirinë e shprehjes, jo ta shtypin atë.

Ky veprim është një tentativë për të frikësuar të gjithë ata që guxojnë të kritikojnë politikën, Drejtësinë dhe shtetin.

Prokuroria e Kosovës duhet të japë menjëherë sqarime publike për këtë arrestim dhe të tërheqë çdo aktakuzë ndaj Behlulit!

Institucionet ndërkombëtare që mbikëqyrin Liritë Demokratike në Kosovë duhet të reagojnë fuqishëm dhe urgjentisht.
Gazetarët nuk janë armiq të shtetit. Ata, janë rojtarë të së vërtetës.

Mos harroni!
Kur e vërteta burgoset, atëherë të gjithë jemi të kërcënuar.
Liria e fjalës nuk është krim. Liria e fjalës është themeli i çdo shoqërie të lirë.

Kopenhagë, 1 qershor 2025

TRADHTIA NDAJ LUFTËS DHE REPUBLIKËS

UÇK-ja nuk luftoi për interesa personale, për tenderë e për pushtet, por për një Kosovë të lirë, të drejtë dhe sovrane. Çfarë shohim sot? Një OVL-UÇK që hesht përballë korrupsionit, një organizatë që bashkëpunon me partitë politike të cilat po e çojnë Kosovën drejt rrënimit. Kjo organizatë nuk mbron më vlerat kombëtare, por interesat e një grushti njerëzish që e kanë kapur shtetin dhe po e mbajnë peng zhvillimin e tij.

A është kjo ajo për të cilën luftuam? A është ky ideali i Adem Jasharit, i Zahir Pajazitit, i Mujë Krasniqit dhe i mijëra dëshmorëve që ranë për Kosovën? Jo! Kjo është një tradhti ndaj sakrificës së tyre. Kjo është një organizatë që punon për pushtetin, jo për historinë!

NJË THIRRJE PËR DISTANCIM nga OVL-UÇK sepse jan bër avokat të PDK dhe mbrojnë interesat kriminele të tyre.

Sikurse edhe Gezim Mekuli, unë kam zgjedhur të mos jem pjesë e kësaj organizate dhe ftoj të gjithë veteranët e ndershëm të distancohen nga ajo. Të gjithë ata që vërtetë e ndjejnë se kanë luftuar për Kosovën dhe jo për interesa partiake duhet ta thonë hapur: Nuk e njohim këtë organizatë si përfaqësuese të idealeve të luftës sonë!

Të nderuar bashkëluftëtarë, nëse vërtetë besoni në drejtësi, nëse vërtetë besoni në sakrificën e asaj lufte, atëherë mos lejoni që emrat tanë të përdoren për qëllime politike! Nuk jemi ne ata që luftuam për ta pasuruar një grusht njerëzish. Nuk jemi ne ata që dolëm malit për të krijuar një kastë të paprekshme që sot tallet me popullin dhe veteranët e vërtetë.

NUK KA LIRI PA TË VËRTETËN

Sot, Republika e Kosovës është në rrezik nga ata që e kanë kapur shtetin dhe po e minojnë atë për përfitime personale. OVL-UÇK nuk është më zëri i luftëtarëve, por zgjatimi i partive që e kanë keqpërdorur dhe rrënuar këtë vend.

Dhe unë, Frashër Oseku, e kisha me të drejtë që nga fillimi. Sepse nuk mund të jem pjesë e një mashtrimi! Sepse nuk mund të pranoj që lufta jonë të keqpërdoret për karrierë dhe para! Sepse e dua Kosovën, por jo të kapur nga hajdutët e politikës!
Ftoj të gjithë ata që e ndjejnë të njëjtën gjë të mos heshtin. Është koha të flasim. Është koha të mbrojmë idealet e vërteta për të cilat luftuam.
Lavdi dëshmorëve! Turp atyre që e shkelin gjakun e tyre për përfitime personale!

Kopenhagë, 15 Janarë 2025

LETËR E HAPUR: NJË SHPIFJE E TURPSHME DHE NJË PËRPJEKJE E DËSHTUAR

Përgjigje një shpifësi të - paemër: Nexhmedin Gerlica

Më 25 qershor 2025, në një emision të transmetuar nga TV Istogu Channel, një figurë e "anonime, për popullin, krejt i pa emër dhe i pa peshë publike si Nexhmedin Gerlica, i cili më sulmoi në mënyrë të ulët, duke më quajtur, "agjent i sllavo-maqedonasve dhe përkrahës i Gligorovit".

Një shpifje e turpshme dhe një përpjekje e dështuar për të më njollosur emrin dhe veprimtarinë time atdhetare.

Ky sulm ndodhi pasi unë, po atë dite, përmenda një fakt të njohur: shumë vite më parë, që nëpërmjet institucioneve shtetërore të Danimarkës, i bëra një ftesë publike Albin Kurtit për të ardhur në Kopenhagë për një debat të rëndësishëm ndërkombëtar. Ai, atëbotë nuk mundi të vinte për shkak se nuk i jepej pasaportë nga UNMIK-u.

- Qëllimi im ishte i qartë – që përmes autoriteteve daneze të ushtrohej presion mbi UNMIK-un për t'i dhënë Albin Kurtit pasaportën që i takonte.

Në vend të tij, në debat mori pjesë Shqiptar Oseku, dhe diskutimi me diplomatët dhe gazetarët danezë ishte i nivelit të lartë.

Gjatë pauzës, një ambasador maqedonas shqipfolës i tha Shqiptarit: "Si u futët në këtë institucion? Unë jam munduar shumë të sjellë ministrin e jashtëm maqedonas, por nuk kam mundur."



(Kryetari i Komunës Bilall KasamiJa më dekoroi si veprimtar politik.)

- Kjo ngjarje flet shumë për atë që kemi arritur ne shqiptarët – me punë e përkushtim, jo me fjalë boshe.
E tani, del ky far Nexhmedin Gerlica dhe më akuzon paturpësisht për të pa vërtetat e tij kokëshkreta…
Po kush je ti, more Gerlica?!
Çfarë ke bërë për kombin shqiptar?! Kush të njohu apo të njeh, përveç vetes tënde dhe ndonjë
"këshilltari" që e sjell si zbukurim në ndonjë emision pa ndikim?
Unë nuk fshihem. Më njohin mirë në Danimarkë, më njohin në Evropë, më njohin në mërgatë. Unë i kam botuar 8 libra – dy të tjerë janë gati për botim – me analiza për çështjen shqiptare dhe bashkimin kombëtar. Kam mbi 100 artikuj të botuar në shtypin danez. Kam dërguar 36 letra të hapura në Ministrinë e Jashtme të Danimarkës, në Këshillin e Evropës, OSBE dhe në OKB. Mbi 100 artikuj nga shtypi danezë që më kanë cituar, dhe nuk ka media serioze në Danimarkë që nuk më ka intervistuar për çështjet shqiptare në Ilirik-Ballkan.
Për veprimtarinë time kanë shkruar 6 intelektualë të njohur danezë dhe mbi 30 akademikë shqiptarë nga të gjitha trevat,

Evropa, SHBA dhe Kanadaja.
Po ti, Nexhmedin Gerlica, çfarë ke bërë përveç se krekosesh në studio të "Istogut Chennell" me figura të çoroditura, që nuk përfaqësojnë askënd.
Nuk mund ta përbaltësh dot një emër që është dëshmuar mbi katet decenie me punë të pandalshme, të palodhshme me përkushtim dhe ndershmëri vetëm për çështjen kombëtare.

Mos guxo më pastaj, të më përmendësh emrin, sepse fjalët tua janë boshe, janë krejt pa vlera, janë – si hijet që veniten, përballë dritës të fuqishme të së vërtetës.
Të paralajmëroj, nëse do të vazhdosh me këto broçkulla, do të përballesh me ligjin, do të dënohesh për shpifje!…

Kopenhagë, 25 qershor 2025

TË LUMTË", O BEN BLUSHI?!

Na paske bërë namin, e paske shkruar një libër, me idenë e madhe të ribashkimit kombëtar.
Aty, paske dhënë ide të rralla, me porosi që, Kosova të dalë para botës me "Komplot", duke bërë realitet ribashkimin kombëtar!?
Me librin në makinë e nën sqetulla, mbase për art idealistët nuk pyesin, paske shkuar në Prishtinë për ta shitur librin tënd të famshëm, natyrisht për biznes dhe demagogji.
Ju, demonë-kratët që e keni minuar mbi 30 vite ribashkimin kombëtar, tani po trumbetoni, kinse jeni prijatarë të kësaj ideje madhore?!!!
"Është e drejtë", e secilit të flet dhe të shkruaj çfarë të dojë në emër të ribashkimit kombëtar, por jo të bëjë demagogji për interesa personale, ekonomike, politike e të tjera...
Lexuesit e nderuar e dinë mirë që:
"Nga e thëna në të bërë, në mes është një det i tërë".
Për më keq është se, jeni ju që keni vërshuar me këtë "det të pa kapërcyeshëm".
- Kujtoj, mirë ke bërë që ke theksuar për Ribashkim me nënën Shqipëri!
- Mos harroni se, janë derdhur tonelata djersë lot e gjak mijëra vite dhe mijëra shqiptarë të okupuar janë dergjë burgjeve për këtë ideal të lartë kombëtar.
Fatkeqësisht, është një realitet i hidhur historik fakti që, ju intelektualët borgjezë reaksionarë "në krye" të tyre dhe klasa politike në Shqipërinë Etnike, (londineze), - harruat që edhe në Shqipërinë e andej Drinit, janë derdhë lot e djersë, për ta forcuar Shqipërinë për t'u dalë zot shqiptarëve të robëruar në Shqipërinë e këndej Drinit, siç do të thoshte poeti ynë – Dritëro Agolli!
- Unë, e pata financuar botimin e librit të Gjeneral Veli Llakës, 6000 Euro për Operacionin "Shpërthimi" që ishte urdhër i prerë

i "diktatorit" Hoxha, që ushtarakët të bëjnë planin ushtarak për t'i çliruar trojet e okupuara nga sllavët pushtues!

Na vjen keq që, ju në Shqipërinë londineze, keni rënë pre e UDB-ës, nëpërmjet titistve me Komandant Qyqarin, e saj Ibrahim Rugova dhe më pastaj me Ramiz Alinë, duke ia dhënë pushtetin dhëndrit të serbëve, Sali Ramë Berishës.

- Pastaj, ndodhën gjithë ato gjëma mbi Shqipërinë Etnike.

Ata të pabesë me demagogji të rrallë i mashtruan shqiptarët dhe e shkretuan Shqipërinë tonë, gjithnjë edhe me ndihmat e pakursyera të qarqeve reaksionare të perëndimit duke sjellë si "fakt" të kryer që, jo vetëm Kosova, por Shqipëria është nën okupim!!!

Kjo ishte një tragjedi që i kushtoi shumë kombit shqiptar. Edhe sot politika zyrtare, mundohet të mashtrojë me demagogji, sesi t'i vjedhë shqiptarët me të vetmin qëllim të mos e kuptojnë realitetin e hidhur që ndodhi nga tragjedia e vitit famëkeq 1991!

Zotëri intelektual, Ben Blushi!

Jeni shkrimtar, politikan, jeni dhe njëri ndër më kapitalistët në Shqipërinë tonë të dashur.

- A je ti në dijeni se, njerëzit e ndershëm, pensionistët e të tjerë idealistë, në Shqipëri nuk kanë lekë, as për barna e bukë në sofër.

Ndërsa, ju përpiqeni të na shisni "sapun për djathë" pra, të na shisni mend, me teori të tilla absurde.

- Dhe, hiqesh që nuk e di dhe nuk je pjesëmarrës në këto politika që klasa juaj politike e shkatërroi shtetin, tani po e shkatërroni me ikje masive nga atdheu kombin shqiptar!

Dua t'jua kujtoj:

- Po të kishte vazhduar Shqipëria me rritjen e popullatës, sot vetëm Shqipëria e andej Drinit t'i kishte afër dhjetë milion banor!

A e dini ju mor z, se "Diktatori" Hoxha, Shqipërinë e mori me më pak se 1 milion, por e la me 3.8 milion banorë, ndërsa, sot ajo ke vetëm me afër 1.7 milion.

-Ju e shkatërruat popullin me mashtrime të pambarim, me premtime të kota, duke e çuar në rrugë prapakthimesh, me "marifetet" tuaja....
Jemi ju, që i dogjët 600 fabrika, pastaj e keni shkatërruar ekonominë, blegtorinë dhe industrinë e lehtë dhe të rëndë!...
Sot politika reaksionare e Tiranës, me "në krye," ortakun tënd politik, Edi Ramën më shumë e lufton qeverinë e Kosovës se, qeverinë e Serbisë Fashiste.
Edhe një fakt po ua paraqes:
A ju ka shkuar ndër mend ndonjëherë, juve o "të uruar" si politikanë, shkrimtarë apo intelektualë, pse vallë, kur ishte PD-ja me Sali Berishën në pushtet, Këshilltar kryesor ishte çetniku, Damir Fazliç, ndërsa, kur e morën pushtetin ju të PS-së të Edi Ramës, Këshilltarë u emëruan dy serbofilët, nga më të këqijtë dhe më të rrezikshmit për kombin shqiptar pro-serbe me damkë: Baton Haxhiun dhe Shkëlzen Maliqin?!!!
- Dhe, si ka mundësi që, bash këta palaço politik, analistë të "përpunojnë", ta sundojnë e zezojnë politikën shqiptare në Shqipërinë tonë të dashur.
- Prandaj, reflektoni pozitivisht mor z!...
- Uleni kokën e merrni mundimin pastrojeni pushtetin dhe opozitën nga mbeturinat jugo-nostalgjike, pastaj ribashkimi ynë kombëtar është i sigurt.

Kopenhagë, 2 nëntor 2023

SPAK-U MERRET ME SHPIFJET NDAJ HISTORISË DHE KULTURËS SHQIPTARE!

Uroj që viti 2024, të jete viti i vetëdijesimi për i intelektualët shqiptarë.

Në fund të vitit 2023, patëm një "ndodhi të madhe" politike; u arrestua me burg shtëpiak njeri nga politikanët ndër më i korruptuari, më destruktiv dhe më kundërshqiptari, Sali Ram Berisha.

- Saliu, nga viti famëkeq 1991, kur doli në skenë si kundërkomunist i tërbuar; bashkë me bandat e tij anarkiste neofashiste të quajtur, PDSH, shkatërroi çdo gjë; ushtrinë, policinë, ekonominë, industrinë, bujqësinë, blegtorinë e të tjera…

Por, më e keqja që zor se do rregullohet ndonjëherë: e shkatërroi unitetin e popullit, me gënjeshtra, shpifje, fyerje, trillime e të tjera turpe të pa fre!…

- Për të fituar përkrahjen e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm antikomunistë të Shqipërisë; filloi duke shpifur; kinse "Enveri e shiti Kosovën", e tradhtoi Mukjen" - e, bla, bla. bla; që as idiotët e lagjeve partiake që zhurmojnë, por në fakt nuk i besojnë; - nuk i besojnë sepse faktikisht asnjë argument të vetëm nuk e kanë.

Këto zhurma vërtet kanë lënë pasoja të këqija, marramendëse duke krijuar mjegullnaja dhe përçarje ndër shqiptarët.

- Shpifjet dhe trillimet ngelën si këmisha të zeza të veshura me marrëzitë e "kulturës" së mendimeve kuturu për interesa meskine të cekëta të "intelektualëve demokratë" - siç është një palo historiani, Uran Butka, një sojnik kameleoni si dyzina të tjerë të cilët nga komunistë të devotshëm u kinvertuan në antikomunistë të tërbuar; edhe ky si gagaristaqët e gagaristaqet tjera; të pa fije mbulesa argumentesh shpifën dhe po shpifin; kundër Enver Hoxhës, kundër PKSH-re; kinse ishin kundër

Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare që padrejtësisht nga imperialistët mbetën jashtë trungut amë - Shqipërisë.
Mos të harrojmë se, babai i Uran Bukës pasi fashistët e humbën luftën agresive pushtuese, meqë ai ishte eksponent i keq përkrah tyre, bëri vetëvrasje, për më keq e më zi; ai ra kryedetyrës së ndyrë të tradhtisë; ra (me nder lexuesve) në hale; ai fanatik shkretan nuk e mendoi jetën me nder, para vdekjes me turp me humbjen e luftës; nuk u pajtua dot pse LANÇ-re e fituan partizanët, e fituan komunistët, që ishin aleatë me anglo - amerikanët; në luftën botërore kundër nazifashizmit dhe nacizmit.
- Para ca ditësh më rastisi që në rrjetin e fejzbuk-ut, në një video një intervistë nga një shkretan "Intelektual" i ashtuquajturi, Shpend Gashi.
Ky i "uruari", Shpend i Ziu, hyri në familjet shqiptare nëpërmjet Televizionit "Top Chennel" duke alarmuar për "mënyrën" sesi u shit Kosova"?!!!
- Ky palaço, duke hequr veten si intelektual i madh, ky "shpikës" apo më mirë: ky shpifës i keq, doli qesharak i shekullit, para opinionit shqiptar dhe të huaj; kur krejt papritur në një natë pa hënë e zbuloi se, kinse Enver Hoxha e shiti Kosovën në Kongresin e Manastirit?!!!
"Zbulim epokal", - vërtet katastrofale; a nuk e meriton ky z, Shpendi që për marrëzira shpifjesh të sojit të Ismail Kadaresë; bile para se t' i jepej i.k, Shpend Ziu, të nderohet me çmimin "Nobel"?!!!
Po, po! Çmimin "Nobel", pse jo; sepse trutë e këtyre intelektualëve që flasin pa asnjë fije logjike, si duket; nuk kanë lidhje me kokat, por me barqet e tyre.
Faktikisht, kokat drejtohen me trutë, jo me zorrët!…
- Vallë, ky palo intelektuali anti-enverian, a ka sadopak lidhje me matematikën dhe historinë; apo ia fut kot, krejt kuturu, me shpifjet kundër gjeniut, Enver, të llapatë së koti kundër Shqiptarit të madh, Enverit.

- Unë, nuk jam prof, mirëpo kam mësuar ca matematikë dhe kam mësuar ca dhe histori.

Mua, kjo çështje më rezulton krejt ndryshe:

Enver Hoxha, u lind më 16 Tetor 1908, ndërsa Kongresi i Manastirit, u mbajt më 14 deri më 22 nëntor 1908. Pra, i bie se, Enveri veçse sa kishte lindur, s`kishte as një muaj; që kjo foshnjë "supermene", arriti që të bëjë gjëmën kombëtare nga më të tmerrshme; e shiti Kosovës?!?!?!?!

- Heu, të marrtë lumi ty dhe shkollën tënde, o Prof. i shkencave politike Shpend Gashi!

Ky shkretan "Shpendi" qenka avokat i zoti i shpifjeve të Sali Berishës; kur flet krejt pa logjikë…

Bile, në një koment ia pata theksuar faktin se,

si ka mundësi që Enveri e shiti Kosovën, ende pa i bërë një muaj në këtë "jetë -luftë"; - siç theksonte Ay.

- Ky far "mendjendrituri", Shpendi i Zi, më thirri në msn, me ç'rast më qortoi dhe vazhdoi më tej me shpifjet për Mukjen, kinse aty është tradhtuar Kosova?!!!

Kur e kundërshtova me argumente, ne pamundësi të këtyre, vazhdoj të thoshte se: "Enveri e shiti Kosovën".

Mirë, - i thashë.

A a ka mundësi të më thuash, si e sa e shiti, kujt ia shiti, dhe kush qe ndërmjetësuese për këto pazare?!

Mësa di unë; nga historia jonë tragjike: Kosova ka mbetur jashtë shtetit shqiptar që nga Konferenca e Londrës, më 1913; mos harroni mor zotëri, që mendoni gabimisht si ky Shpendi, se në atë kohë, Enveri kishte vetëm 5 vjet; përsëri ky "supermeni" u çua "fluturoi" me krah, i bëri gjëmën atdheut, e shiti një pjesë të madhe të tij.

- Po ashtu, bashkëbiseduesit tim ia theksova faktin; historiani anglez, Janez Pettifer, në librin e tij librin e tij "UÇK-ja" shkruan: "Enveri e formoi famëmadhen UÇK-n".

- I gjendur në rrugë pakrye, kur më tutje i ngeli keq sharra në gozhdë, ai si i pacipë që u dëshmua; më ofendoi rëndë mua dhe

Jenez Pettiferin dhe po atë çast më bllokoi nga lista e miqësisë në fejzbuk.

Unë e kuptoj urrejtjen e këtyre "shkencëtarëve" të letrave të verdha, ndaj ideve komuniste; mirëpo këta zotërinj, kameleonë, tregtarë të njëqind flamujve; duhet të kthjellohen që ta kuptojnë se: idetë komuniste, nuk luftohen me shpifje, insinuata dhe trillime, pot as me fyerje të ulëta të cilat mund t'u kthehen në surrate…

- Prandaj, me këtë rast mendoj që; është shumë e rëndësishme dhe urgjente që të miratohen ligje në Kuvendet tona në Tiranë, Prishtinë dhe në Shkup e gjetkë, kundër shpifjeve që: askush të mos mundet të deklarohet me shpifje dhe gënjeshtra, ashtu si t i vijë nëpër kokë, sipas tekeve dhe interesave të liga personale.

Kopenhagë, 1 janar 2024

FESTAT E NËNTORIT NË TETOVË

SOT NË TETOVË PROMOVOHET LIBRI I XHEMIL ZEQIRIT ''NË MBROJTJE DIPLOMATIKE TË ÇËSHTJES SHQIPTARE''

Shkruan: Laura Laçi
21.11.2024

Në kuadër të festave të nëntorit të organizuara nga Komuna e Tetovës, sot me fillim nga ora 12:00 në Sallën e Këshillit Komunal në Tetovë përurohet libri ''Në mbrojtje diplomatike të çështjes Shqiptare'' me autor Xhemil Zeqiri, njofton
Profesori Arsim Sinani, recensent i librit ka theksuar se ky libër është një dëshmi historike për rolin e diasporës për çështjen shqiptare si për Kosovën, ashtu edhe për shqiptarët në Maqedoninë e Veriut.
"Xhemil Zeqiri është një nga figurat më të rëndësishme që i ka diaspora shqiptare në Evropë. Për më shumë se 4 dekada ai nga Kopenhaga e Danimarkës ka qenë një zë i rëndësishëm i çështjes shqiptare. Për Xhemil Zeqirin mund të them se në zhvillimet për themelimin e mbijetesën e Universitetit të Tetovës ai ka dhënë maksimumin e tij për ta ndërkombëtarizuar dhe për ta prezantuar denjësisht problemin e arsimit, por edhe problemet që edhe sot i shqetësojnë shqiptarët në Maqedoninë e Veriut. Të gjithë faktorët e rëndësishëm nëpërmjet tij dhe bashkëmendimtarëve të tij që nuk kalkuluan dhe nuk kursyen asgjë, por punuan dhe kursimet e tyre i vendosën në veprim të çështjes së Kosovës", ka theksuar Arsim Sinani.
Autori i Librit Xhemil Zeqiri për Portalb.mk tha se libri është pëlqyer shumë nga lexuesit, dhe u detyrova ta ribotoj edhe njëherë me disa plotësime.
treten. I mblodhi dhe i hodhi në letër: ngjarjet, bisedat, intervistat gazetareske dhe çdo aspekt tjetër të veprimtarisë së tij, duke i regjistruar dhe ruajtur me përpikëri. Librat e tij janë sot dëshmi, janë memorie, janë udhërrëfyes, për këdo që kërkon të kuptojë

atë periudhë. Në faqet e tyre nuk gjen vetëm informacion; gjen rrahjen e zemrës të një patrioti. Gjen mallin, dhembjen dhe shpresën. Ai shkroi që kombi të mos mbetej pa kujtesë, sepse një popull pa kujtesë, është një popull pa të ardhme.

Kur atdheu bëhet mënyrë jetese?!

Por, Xhemil Zeqiri nuk është vetëm zë i një kohe të kaluar. Ai nuk mbetet thjesht kujtim apo figurë e arkivuar në faqet e historisë. Ai jeton dhe vepron, mendon dhe reagon, shkruan dhe paralajmëron edhe sot. Për të, atdheu nuk ka kohë të shkuar; ka vetëm përgjegjësi të vazhdueshme.

Interesimi i tij ka qenë dhe mbetet i shtrirë në të gjithë kombin, në rrugën e shtet-formimit shqiptar dhe në mënyrën si është drejtuar dhe duhet të drejtohet shteti. Ai i rikthehet vazhdimisht periudhave vendimtare të historisë, figurave që ngritën themelet e shtetit dhe atyre që për rreth gjysmë shekulli mbajtën të paprekur pavarësinë në kushte të stuhishme ilirike (ballkanike). Për Zeqirin, historia nuk është muze; është mësuese. Ajo nuk lexohet për t'u admiruar, por për t'u kuptuar dhe për të mos gabuar sërish. Në analizat dhe bisedat e tij, ai shpesh shtron pyetje thelbësore: çfarë e forcon shtetin? Ku dobësohemi? Pse përsërisim të njëjtat gabime? Ai kërkon përgjegjësi, kërkon përparim, kërkon seriozitet. Sepse, sipas tij, një komb që nuk mëson nga historia, rrezikon ta paguajë të ardhmen.

Edhe sot ai e ndjek me vëmendje rrugëtimin e Shqipërisë në sistemin e ri politik. Ai gëzohet për arritjet, por nuk hesht për problemet. Kur sheh padrejtësi, kur sheh institucione që lëkunden, kur sheh zhgënjim qytetar, ai e ngre zërin. Jo për të sulmuar, por për të përmirësuar. Jo për të prishur, por për të ndërtuar. Për të, liria duhet të shoqërohet me ligj, me drejtësi, me funksionim të shtetit – ndryshe ajo mbetet e paplotë.

Vështrimi i tij shtrihet njëkohësisht në Kosovë, në trevat shqiptare në Maqedoni, si dhe tek shqiptarët nën Serbi, në Kosovën Lindore. Ai, nuk i ndan ata me kufij administrativë; i

bashkon me fat. Çdo zhvillim politik, çdo tension, çdo shpresë apo rrezik në këto hapësira, ai e ndjen si çështje personale. Për të, kombi është një trup: nëse dhemb një pjesë, dhemb i tëri.
Në këtë kuadër, ai ka qenë dhe mbetet kritik ndaj ideve për ndryshime kufijsh, që mund të hapin plagë të reja. Ai e njeh mirë historinë e Ilirikut (Ballkanit) dhe e di se kur politikanët luajnë me harta, shpesh popujt paguajnë me jetë e me shpërngulje. Prandaj, ai kërkon maturi, drejtësi dhe garanci të forta.
Po kështu, ai e ka trajtuar me kujdes dhe iniciativën e ashtuquajtur "Ballkani i Hapur", duke ngritur pikëpyetje sa herë që sheh rrezikun që në emër të bashkëpunimit të krijohen pabarazi të reja ose të forcohet përparësia (primati) i Serbisë pa u zgjidhur më parë çështjet e hapura me shqiptarët. Për Zeqirin, bashkëpunimi është i mirëpritur vetëm kur është i barabartë, kur respekton dinjitetin dhe të drejtat e secilit.
Pra, veprimtaria e tij nuk është vetëm e djeshme; është e përditshme. Ai vazhdon të shkruajë, të flasë, të këshillojë, të kritikojë kur duhet dhe të mbështesë kur e sheh të drejtë. Dialogu i tij është i gjerë, gjithëpërfshirës dhe i drejtuar nga një busull e vetme: interesi kombëtar. Kjo e bën Xhemil Zeqirin një figurë të rrallë – një njeri që e ka kthyer patriotizmin në mënyrë jetese. Jo si kujtim romantik, por si detyrë aktive. Dhe, për sa kohë ai vazhdon të mendojë e të veprojë, zëri i kombit në mërgatë vazhdon të jetojë përmes tij.

Çfarë na mëson aktiviteti dhe jeta e tij?
Jeta e Xhemil Zeqirit nuk është thjesht një rrëfim për t'u treguar; është një mësim për t'u jetuar. Ajo na flet me gjuhën e përvojës, me peshën e sakrificës dhe me qartësinë e një ndërgjegjeje që nuk ka pranuar të flejë. Në çdo hap të tij, dje dhe sot, kupton se atdheu nuk është një fjalë që shqiptohet lehtë, por një barrë e shenjtë që mbahet me dinjitet. Ai na mëson se dashuria për vendin nuk provohet me brohoritje, por me punë të heshtur e të përditshme. Me durimin për të trokitur në dyer që nuk hapen

menjëherë. Me këmbënguljen për të folur edhe kur të tjerët lodhen. Me guximin për të qëndruar drejt kur rrymat fryjnë kundër. Na mëson se flamuri nuk është veç zbukurim festash. Ai është përgjegjësi. Është kujtesë për ata që ranë dhe detyrim për ata që jetojnë. Ta mbash flamurin do të thotë të mbash fjalën, të mbash drejtësinë, të mbash shpresën e njerëzve që presin më të mirën.

Nga rruga e tij kuptojmë edhe një të vërtetë tjetër të madhe: largësia nuk e zvogëlon dashurinë për atdheun. Përkundrazi, shpesh e bën më të mprehtë. Edhe në mërgim mund të bëhesh mur mbrojtës, urë lidhëse, shtyllë e lirisë. Trupi mund të jetë larg, por ndërgjegjja mund të jetë më pranë se kurrë. Ai, kurrë nuk e kërkoi lavdinë. Nuk rendi pas titujve, as pas duartrokitjeve.

Por lavdia e gjeti vetë – në besimin e njerëzve, në respektin e bashkëpunëtorëve, në gjurmën që veprimtaria e tij ka lënë në historinë tonë të re dhe në debatet që vazhdon të hapë edhe sot. Sepse, ai nuk është vetëm kujtim; ai është prani. Figura e tij bëhet kështu një thirrje e vazhdueshme: për bashkim kur rrezikojmë të ndahemi, për përkushtim kur tundimi i rehatisë na merr, për vazhdimësi kur harresa na afrohet. Ai na kujton se kombi nuk mbahet nga entuziazmi i çastit, por nga puna e gjatë dhe besnikëria e palëkundur.

Në fund, nga veprimtaria dhe jeta që ai zhvillon në mërgatë, del një përfundim i thjeshtë dhe njëkohësisht i thellë: patriotizmi nuk është fasadë deklaratash, por punë dhe qëndrueshmëri. Është të mos largohesh nga detyra, të mos heshtësh përballë padrejtësisë, të mos lejosh të shuhet drita e së vërtetës. Dhe, përderisa ai vazhdon të mendojë, të shkruajë e të reagojë, ky mësim vazhdon të marrë frymë mes nesh.

Unë kam pasur dhe vazhdoj të kem fatin ta njoh nga afër. Kam biseduar dhe bisedoj me të për kulturën, për plagët dhe për shpresat tona. Në fjalën e tij gjen urtësi, në heshtjen e tij gjen përgjegjësi, në qëndrimin e tij gjen dinjitet. Sa herë që më ka dhuruar librat e vet, kam ndjerë se në duar nuk mbaj vetëm faqe

të shtypura, por copa jete, frymë përkushtimi, një zemër që rreh për kombin.
Dhe sot, kur përmendet emri i tij, nuk del përpara thjesht një njeri. Del një udhë. Del një kujtesë që nuk plaket. Del një zë që nuk lodhet së thirruri për drejtësi. Xhemil Zeqiri, është aty ku shqiptari ngre kokën dhe kërkon të drejtën e vet. Është aty ku fjala e lirë çan errësirën. Është aty ku dashuria për atdheun bëhet punë, sakrificë dhe besim. Një dritë në horizont, ai nuk kërkon duartrokitje; mjafton që rruga të shihet. Dhe, për sa kohë kjo dritë mbetet ndezur, kombi e di se nuk është vetëm.

DEBAT KUNDER RETORIKËS TË PABAZUAR NË FAKTE DUHET TË KUNDËRSHTOHET

Eh more xha Spartaku ia futë kot, si Kau Pelës?! Kur flitet për komunizmin, ju adhuruesit e fashizmit të Ballit, Legalistët dhe të Zogut aludoni tek Enver Hoxha. Kjo retorikë e pabazuar është bërë bajate, sepse, nuk ka shumë filozofi për të kuptuar. Kjo u ndodh se dini aspak histori dhe pak matematikë! Enveri u lind më 16 Tetor 1908, kurse më 1912 u shpallë Pavarësia, më 1913 fuqitë e mëdha në Konferencën e Londrës vendosën kufijtë tanë, pra Enveri ishte 5 vjeçar.

Udhëheqësit e Luftës së Parë Botërore dhe të dytë botërore u mblodhën në Paris më 1918 dhe vendosën përsëri të zbatonin Traktatin e Fshehtë të Londrës, por u ngritën shqiptarët dhe më 1920 u shporrën armiqtë nga Vlora e Gjirokastra, por kufij mbetën ata të 1913.

Kjo çështja e mbetjes së kufijve të 1913 edhe pas Luftës së Dytë Botërore ishte vendosur në Marrëveshjen e Atlantikut më 1941 dhe në atë të Jaltës më 1945 se, kufijtë nuk do ndryshojnë; ato mundej të ndryshonin, por vetëm me pëlqimin e palëve, në këtë rast shqiptaro - jugosllavë. Enver Hoxha punoi për të ribashkuar Kosovën me Shqipërinë. Gjatë vizitës në Beograd, Enver Hoxha, pa hezituar i foli Titos, se: "Kosova është shqiptare dhe duhet t'i bashkohet Shqipërisë!", por Titoja i tha se "kishte frikë se I zemëroheshin serbët dhe I prishej Federata, pasi kishte ndërmend edhe gllabërimin e Shqipërisë në atë Federatë, dhe gjoja e la për ta parë më vonë.

Me sa shoh në profilin tuaj, duhet të jeni nga Tetova jonë dhe ti jetoke ne Amerikë, por mësoje së në MV i kemi punët keq, dhe mos iu besoni aq shumë edhe amerikanëve se, më 1946 kishte plot "Grenellë" në SHBA, dhe se ata "Grenellët" e 1946-tês, i bënin shumë presione Enver Hoxhës, që Shqipëria të futej në Federatën Jugosllave dhe në Greqi.

Po është dhe kjo retorika juaj, kur i quani Berishën dhe Ramën: komunistë!! Këto janë poshtërsitë e llojit më të keq antikombëtar, sepse po ky Sali Berisha e shkatërroi ekonominë, ushtrinë, bujqësinë që e kishin ndërtuar komunistët shqiptarë me në krye Enver Hoxhën, madje edhe më keq: largoi trurin shqiptar që e kishin mençuruar ata komunistë e "këqij" me Enverin. Por, ti Sami Xhaferi, duke qenë ase duhet të jesh analfabet, nuk dallon dot komunistin nga nacionalistin. Enver Hoxhën e theksojnë gjithë enciklopeditë e botës as për diktator dhe as për komunist, por për nacionalist. Dhe mësoje që të mos gabosh më: komunistët janë internacionalistë dhe jo nacionalistë. Enverin De Goli e quante nacionalisten më të madh të Evropës. U kthjellove?
Pastaj, ju zogistët dhe adhuruesit e Zogut sllavofil, si mundeni ta quani komunist Edi Ramën, kur ky pizeveng i pacipë në vitin 1991 përkrah Berishës piskatnin si gomarë: "Komunistët në litar, pensionistët në hanxhar", ndërsa për Enverin thotë se "ishte monster" e plot antishqiptarizma të tjera. Pra, ti kujton se po je antikomunist, je Shqiptar i madh! Ata 4 milionë shqiptarët nën udhëheqjen e Enverit, nuk ishin antikomunistë, prandaj e barazuan për 40 vjet Shqipërinë në të gjitha fushat e jetës me Evropën, ndërkohë Evropës i ishin dashur 300 vjet. Demokrati, duhet ta luftojë të keqen me argumente të qëndrueshme, e jo me ëndrra pleqsh, - siç bëjnë ballisto-zogistët dhe zotëria juaj.
Qerret, Kavajë-15 Korrik 2025

ALBIN KURTI DHE VV PËR KOSOVËN?!

Në një kohë transformimi dhe përpjekjesh të mëdha për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë dhe të përfshirë, Kryeministri Albin Kurti në krye të VV-së shënuan një kthesë të fuqishme pozitive në historinë politike të Kosovës. Me energjinë e tij të paepur dhe vizionin e tyre për një të ardhme moderne, Albini dhe VV i ka dhënë një impuls të ri për demokracinë, lirinë, barazinë dhe ardhmërinë e vendit tonë.

Ndryshimet demokratike dhe përballja me çështjet thelbësore kombëtare shqiptare.

Albin Kurti , ishte dhe është i palodhur në bërjen e një qeverisjeje të hapur. Ai e ka vënë dialogun në binarë të barabartë me faktorë të jashtëm ndërsa të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe me institucionet publike, duke krijuar mekanizma të rinj për pjesëmarrje qytetare që e bëjnë qeverisjen më të përgjegjshme dhe të afërt me nevojat e popullit. -Ky angazhim i fortë ndaj demokracisë ka sjellë një ndryshim të dukshëm pozitiv në mënyrën më të mirë, sesi merren vendimet politike në Kosovë.

Lufta kundër hajnisë (korrupsionit) dhe përmirësimi i Institucioneve.

Në një mjedis ku sfidat e hajnisë në veçanti nga klasa politike ka qenë një pengesë serioze për zhvillimin e vendit, Kurti ka zbatuar masa të guximshme, për të forcuar institucionet shtetërore dhe për të siguruar popullin që, të gjitha politikat të jenë në përputhje me parimet e drejtësisë dhe lirisë. Përmes reformave të tij, Kosova po bëhet një vend më i pastër dhe më i sigurt për investime, duke nxitur besimin e qytetarëve dhe të komunitetit ndërkombëtar.

Investimet në Edukim dhe në ndihmat shtresave të gjëra popullore.

Një nga shtyllat kryesore të politikës së re të qeverisë është investimi në arsimin dhe kulturë. Pastaj, thellësisht dhe gjerësisht

Albin Kurti dhe VV kanë shënuar një ndryshim të madh në mënyrën si të tejkalohen sfidat e arsimit në Kosovë. Ai ka zbatuar programe të reja për trajnime profesionale dhe edukim joformal, duke i ofruar të rinjve mundësi të reja për zhvillim dhe përfshirje në tregun global të punës. Ky fokusim ka nxitur një mentalitet progresiv, ku ndihma në orientime dhe kreativiteti përballen me sfidat e kohës moderne.

Angazhimi për Integrim evropian dhe bashkëpunim ndërkombëtar



("Pas takimit me Këshillin për Politikë të Jashtme në Kuvendin e Danimarkës, zhvilluam një kafe pune me nënkryetarin Olka K. Nielsen.")

Albin Kurti, ka dhënë një vizion të qartë për integrimin evropian të Kosovës, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me vendet e Bashkimit Evropian dhe partnerët ndërkombëtarë.

-Përpjekjet e tij për të harmonizuar politikat vendore me standardet ndërkombëtare po sjellin një perspektivë të re për zhvillim ekonomik dhe social, duke bërë Kosovën një partner të rëndësishëm në rajon.

Shpresojmë dhe po punojmë për një të ardhme të ndritur për Kosovën

Me një udhëheqës si Albin Kurti, Kosova po shkon me besim të plotë drejt së ardhmes së ndritur. Angazhimi i tij për të përmirësuar jetën e qytetarëve, për të luftuar padrejtësitë dhe për të nxitur një kulturë të re të përgjegjësisë, po shprehet me hapa pozitiv që frymëzon jo vetëm Kosovën, por edhe rajonin. Kryeministri, Albin Kurti po ndërton themele të forta për një shoqëri demokratike, ku të drejtat e njeriut, liria dhe barazia janë garantuara me ligje të drejta për çdo qytetar të Kosovës. Ky udhëheqës vizionar, sjell jo vetëm një ndryshim të prekshëm në politikën vendore, por edhe një shembull frymëzues për brezat e ardhshëm, duke e bërë Kosovën një vend më të drejtë, më të sigurt dhe më të bashkuar.

02-03-2025

‘

KUSH JE TI O ENVER HOXHAJ QË KËRKON DEBAT ME KOLOSIN ALBIN KURTI?!?!?!

Në trojet shqiptare, situata është shumë e vështirë në aspektin ekonomik, kulturor, arsimor, por, më shumë se në çdo fushë të jetës, është më e vështirë në aspektin politik.
Prej qëkur, VV -ja hyri në Kuvendin e Kosovës, aty filloi një debat i gjallë me zhvillime të reja, për kërkesat përparimtare opozitare nga VV -ja.
Por, kapësit e shtetit e panë rrezikun për humbjen e pushtetit dhe të privilegjeve të tyre, prandaj për 15 vite me radhë, nuk lanë, as po lënë gjë pa bërë, për t'i shtypur mendimet dhe veprimet përparimtare të Albin Kurtit dhe të LVV.
- Pse po ndodhë gjithë kjo furtunë mbi supet e njoma të rinisë shqiptare në Kosovë?!
Albini dhe LVV -ja, i filluan, i zhvilluan dhe po i zhvillojnë betejat politike me rezistencë paqësore aktive, të bazuara me vendosmëri të qarta objektivash kombëtare me statutin dhe programin e organizatës politike LVV -ja, ndër vite, mbi një decenie ngadalë, por sigurt është shndërruar në parti serioze gjithnjë e më të fuqishme në përkrahje të masave të gjëra popullore, brenda dhe jashtë vendit.
Objektivat madhore të Albinit me shokë ishin dhe janë: me çdo kusht, me çdo çmim: djerse dhe gjaku të mbrohet Kosova dhe çështja kombëtare shqiptare nga sulmet dinake dhe të egra, tejet perfide të faktorëve ndërkombëtarë miq të hapur dhe të maskuar të Serbisë Fashiste dhe të politikanëve puthadorë "kosovarë" dhe "shqiptarë" në Prishtinë, Tiranë, në Shkup që janë bërë pengues të mjerë dhe rrënues të përparimit dhe ribashkimit kombëtar.
- Klasa politike në pushtet, si dikur nën tutelën e UNM K-ut dhe pastaj nën tutelën e EULEX -it gjithnjë ishte dhe mbeti servile ndaj vendimeve të padrejta të qarqeve reaksionare ndërkombëtare, në veçanti në dëm të Kosovës dhe të çështjes shqiptare në

përgjithësi.
Albini dhe VV nuk e lejuan këtë, dje, sot, as nuk do ta lejojnë që tradhtitë të ngrenë kokat e mykura edhe nesër.
- Duke parë e dëgjuar se çfarë po ndodhte dhe po ndodhin gjithë ato prapakthime historike dhe tradhti, para syve të shqiptarëve dhe të opinionit botëror në konferencat euro -atlantike, Albini dhe VV me guxim dhe dituri e ngritën flamurin e rezistencës paqësore aktive.
-Natyrisht, gjithnjë gjatë përgatitjes, gjatë zhvillimit të aksioneve dhe demonstratave dhe pas tyre, nga regjimet antipopullore janë ndërmarrë sulme të pandërprera; dhunë policore në sheshet e qyteteve të Kosovës dhe tortura në burgje pas burgosjes të Albin burgomadhit dhe aktivistëve të tjerë në veçanti ndaj figurave udhëheqëse të Lëvizjes LVV, Glaukut, Albulenës e të tjerë.
Dëshmorë të atdheut nga turpet dhe krimet politike të UNMKUT dhe klasës politike "kosovare" janë Balaj dhe Xheladini, ndërsa, nga persekutimi i pandalshëm i pushtetit mafioz, Thaçi -Isa kundër LVV -së, është dhe djaloshi trim, Astrit Dehari, cili u privua nga jeta në burgun e Prizrenit.
- Për të shkruar këtë artikull, më detyroi gjendja e përballimit, këto ditë para fillimit të mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme të 14 shkurtit, 2021.
- Kur jemi në këtë temë, lexuesve të nderuar ua kujtoj se; kur "kreu" i PD K-së, Enver Hoxhaj, e mori timonin e PD K-së, -thënë troç, pa asnjë meritë atdhetare, "pardon", -harrova që, e vetmja meritë e tij qenka se, ky tip -fodulli, s'është asgjë tjetër veçse, një torolla K-mashtrues dhe aq më keq, një mendjepak në politikë.
- Ky z, kishte plot funksione kur PD K-ja ishte në pushtet, por në asnjërën prej tyre nuk ka qenë i suksesshëm.
Më datë 13 janar 2016 unë bashkë me dy kushërinjtë e mi, Ylberin dhe Bekimin, u nisëm për në Prizren, shkuam për një takim me ish -zv. Komandantin e UÇ K-së të ZP të Pashtrikut,

veprimtarin e çështjes kombëtare dhe shkrimtarin, Avdi Ibrahimi.

Gjatë rrugës drejt Prevallës së bukur, bisedonim për buku-ritë e këtyre maleve pitoreske shqiptare, bisedonim, për gjarpë-rinjtë dhe hardhucat dykëmbësh, që iu kishin qepur këtyre maleve, duke i zhvatur pasuritë e atdheut.

Bisedonim pra, për politikanët hajna të Kosovës, të cilët në ato shpatie pitoreske kanë ndërtuar vila luksoze dhe restorante.

- Po, iu thashë, – keni drejt.

Kurse, ne që po punojmë 30 apo 40 vite në vende të huaja, bashkë me shokë jemi rropatur, kemi bërë gjithë ato veprimtari në shërbim të popullit dhe atdheut; për çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare dhe siç thuhet:

"Nuk na zë gjumi, për bashkimin kombëtar".

Ne, nuk jemi milionerë.

- Pse ta fshehim, ne nuk ndihemi mirë dhe për faktin që: ish -shokët na tradhtuan, që kur e erdhën në pushtet, i kapën të gjitha levat e shtetit, vendin e varfëruan, e lanë dhe pa sovranitet.

-Siç u pa dhe u dëgjua, disa dyzina nga ish -shokët në pushtet erdhën vetëm që të pasurohen me anë të mashtrimeve, hajnive (korrupsionit); atdheun e bënë plaçkë tregu; i shitën pasuritë e Kosovës.

Aty rreth orës 11.00 Bekimi ndaloi para restorantit, "Sharr". Sa hymë brenda, në një tryezë ishte ulur ish -Kryetari i Prizrenit, Ramadan Muja, i cili shumë vite ka vrapuar gjyqeve i akuzuar për keqpërdorime, hajni (për korrupsion).

- E njihni këtë zotërinë, -iu thashë bashkëbiseduesve të mi?

U shpjegova se, kush ishte…

-Pas pak, e pamë një xhip që hyri në oborr dhe kush na erdhën se; erdhën Kadri Veseli dhe Enver Hoxhaj.

- Enveri, ecte pas Kadriut, si "bubik", këta bubikët, janë një soj qenushësh të vegjël që, plakat skandinave i shëtisin përdore me zinxhirë.
-Ja, shiheni atë maskarain, - iu fola kushërinjve të mi:
Ky, Hoxhaj ka qenë në Vjenë, atje ka doktoruar për histori, ky z, gjatë LÇ -re, ka deklaruar:
"Nëse UÇ K-ja e fiton luftën, unë do të shkoj në Beograd, te Millosheviqi do të kërkoj azil politik"?!
- E, tani ky pizevengu, pa pikë turpi, u palua në PDK?!
- Apo, e ka peng, atë fjalë të ligë, pas së cilës atëbotë, dyshoj që mund të fshiheshin dhe shumë punë të tjera të liga. Prandaj, titisto -millosheviqët e Isës e kanë dërguar në atë pozitë të lartë, që ta ketë atë parti nën kontroll.
- Ja, pasi Gjykata Ndërkombëtare e Hagës e arrestoi Kadri Veselin, Enverin e bën si ushtrues detyre të Kryetarit të PDK-së.

- Tani, kjo parti krejt në heshtje, po i largon nga Lista për deputetë, veprimtarë/e të devotshëm, që kanë luftuar në radhët e UÇK-së dhe poashtu, pahetueshëm po shkrihen në një Parti me LDK-n e titisto-millosheviqianit - Isa Mustafa që, bashkë i kanë kapur institucionet e Kosovës dhe kjo u pa qartë me znj, Valdete Dakaj, si duket Enver Hoxhaj, me kënaqësi po rikthehet në ish-çerdhen e vet, ndonëse me tesere tjetër partiake.
- Po, çka e bënë situatën edhe më qesharake dhe më skandaloze, është fakti që, këto ditë z, i pispillosur "vjenez" Enver Hoxhaj, si "trimi" pas betejave; kërkon disa "duele", debate me Albin Kurtin?!?!?!
Harron ky z, megaloman i rritur, i fryrë si gjel deti, i ngritur shpejt në pushtet, si kungulli, - pocerka në gardh se, për të debatuar me Albinin, i cili ka një bagazh të madh politik, mbi dy decenie veprimtari atdhetare dhe ca më pak se, 15 vite Kryetar i LVV, tani partia më e madhe në Kosovë.
Albini, është dhe njëri ndër më të vendosurit atdhetar, mbështes i simbolit tonë, Adem Demaçi dhe i UÇK-së, ky duhet të ketë jo

veç titullin shkencor, por edhe veprimtari të lakmueshme atdhetare dhe politike.
Albini, ishte Sekretar i bacit Adem, në krahun politik dhe diplomatik të UÇK-së.
Albini, e mbronte UÇK-n Heroike, jo vetëm para gazetarëve, në Gjykatën Fashiste serbe, por edhe kur Kryqi i Kuq në trysni të organizatave ndërkombëtare, kërkonte që të vizitohen pengjet e Luftës Çlirimtare, kudo që ishin në burgjet e Serbisë Fashiste.
- Me këtë shkrim, nuk dua të krekosem, por, për hir së vërtetës dhe lexuesve dua të rrëfej që, pandalshëm kam punuar, nga ky aspekt, me organizatat daneze.
- Sa për ta kthjelluar ca këtij z, Hoxhajt, po ia kujtoj disa veprimtari që e kam mbrojtur çështjen kombëtare dhe atëbotë kam kërkuar të drejtën për Vetëvendosje për popullin tonë:

Letrën e Hapur që ia dërgova Ministrit danez, Neils H.Pedersen, më 24 shkurt 1997, kur Danimarka e udhëhiqte OSBE-në, cila u botua në gazeta daneze më prestigjioze, "Politiken" dhe në "Ajbajderen". Këtë letër e kam botuar në librin e tretë, "Në mbrojtje (diplomatike) të çështjes shqiptare, Prishtinë (shkruaje vitin e botimit) faqe, 185.
Letra titullohej: Pse shqiptarëve s' ju lejohet e drejta për VETËVENDOSJE?!
Jo vetëm në shtypin shqiptar, por edhe në shtypin danez e kam mbrojtur, UÇK-n Heroike.
Kam dërguar gazetarë dhe delegacione daneze, në nivele të larta politike dhe shkencore: që, nga Kuvendi, Ministria e Jashtme dhe Universiteti.
Pas këtyre letrave dhe debateve politikanë, gazetarë dhe shkencëtarë, - pra, profesorë të shquar danezë kanë bërë studime, pastaj ndryshuan qëndrimet, në veçanti pasi u kthyen nga Kosova. Kur titistët e sojit rugovistë, të zhytur në kënetat e lakmive, pas oreksit të pushtetit fiktiv, të futur dhe në lakun e armiqve, Kosovën e lanë në robëri, ndërsa zhurmonin kinse kemi

shtet paralel me Serbinë Fashiste. Atëbotë, të gjithë ishit renditur si delet e zeza, pas "bariut" titisti-millosheviqianit, Ibrahim Rugova, i cili e kishte humbur rrugën mjegullave të shkollave të Kumrovcit, ecnit frikshëm të mekur në kolonën e tuaj të pestë, ndërsa, në ato radhē turpi ishe edhe ti, z, Enver Hoxhaj, që UÇK-n famëmadhe e quaje, "Dorë e zgjatur e Serbisë". Unë, më datë29.03.1998, me 13 organizata daneze organizova një debat publik në Sallën e Kuvendit danez, pikërisht për UÇK. Dhe, në atë debat qe i ftuar dhe Zëdhënësi Politik i UÇK-së, z. Nasim Haradinaj, i cili ishte në frontet e LÇ-re, prandaj, nuk erdhi.

Ndërsa, nga Unioni i Studentëve të Prishtinës, erdhi Driton Lajçi, dhe Ambasadori i qeverisë së Kosovës në Stokholm, Dr. Shaqir Shaqiri, tani i ndjerë.

-Për këtë debat, pati interesim të madh.

Një ditë më pas, shkroi shtypi danez, më datë. 30. 03.1998 e përditshmja autoriteteve "Politiken" shkroi një artikull, ku veç tjerash e citon bisedën shumë të dobishme dhe sqaruese të Driton Lajçit në atë debat.

Zotëri Dr. Prof. Hoxhaj!

Unë, me përkushtim dhe seriozitet, iu jam qasur halleve të mëdha të kombit dhe atdheut.

Duke ditur faktin që, ne nuk njihemi e ndiej detyrë morale të të njoftoj që, jam punëtor krahu, por që i kam botuar pesë libra, vetëm në fushën e rrëpirët të publicistikës.

Librat e mia janë kryesisht publicistikë, ku pasqyrohen opinione, letra, debate polemika që burojnë, jo nga analiza të salloneve luksoze, por janë përmbledhje të veprimtarisë sime 40-vjeçare në mërgim, bashkë me veprimtarë të tjerë atdhetarë.

- Meqë, prej themelimit të LVV po përballem me këto aktivitete të pandërprera opozitare, mediat tuaja gjithnjë po mundohen të izolojnë aktivitetin tim dhe të bashkëpunëtorëve të mi.

Tani, dua të shtroj pyetjen: më gjeni një anëtarë me tituj profesor, akademik, o mësues të shkollave fillore, o të mesme nga partitë tuaja, LDK-PDK-AAK e të tjera simotra, që i ka mbi 120 artikuj

në shtypin danez, anglez, gjerman, apo në shtypin e shteteve të huaja mike dhe armike.
Po ti mor z, Enver Hoxhaj, si një intelektual, tani me titull akademiku, a më tregon mua, lexuesve të nderuar, por edhe elektoratit në Kosovë, të cilit bashkë me partiakët tuaj, PDK, po ia kërkoni votën; çfarë veprimtarie në shërbim të popullit dhe atdheut ke bërë ti kur ishe në Austri?
- Sa artikuj ke shkruar dhe ç' veprimtari të tjera atdhetare i ke në bagazhin tënd, që të kanë nderuar dje dhe që mund të nderojnë sot dhe nesër personalitetin prej "atdhetari", si politikan dhe udhëheqës partie në Kosovë?
- Dua të di dhe anën tjetër "të medaljes", për faktin që, ty të ka dalë nami i zi, ashtu siç i ka dalë Ibrahim Rugovës nga Xërxa; qëkur me paturpësi ke deklaruar kundër UÇK-së, madje këtë e sqaron edhe partneri juaj, Bilall Sherifi i cili, veç tjerash thotë: "Hashim Thaçi, paska folur për qëndrimet tuaja, kundër UÇK-së dhe çlirimit të atdheut, Enver Hoxhaj, po e pengon veprimtarinë e UÇK-së në Austri".
- A mos vallë, tani ia arrite qëllimit që po e sulmon aq ligësisht, Albinin dhe LVV-n, sepse oreksi yt politik i xhepit ta thotë: ti, duhet të drejtosh Kosovën me orientime rugoviane, kah Serbia Fashiste; ashtu -siç deklarohej partneri juaj, Bexhet Pacoli se:
"Kosova, nuk mundet pa Serbinë".
Ju, tani i fërkoni duart, kur mendoni që, "e keni rastin ideal", që me ato ligjet tuaja të "drejtësisë së xhungës", ta ndaloni Albinin, Liburnin, Albulenën, të kandidojnë për deputetë.
Juve ju tmerron kthimi i Albinit si Kryeministër i Kosovës dhe i VV në pushtet. Dihet që, Albini dhe VV-ja, janë bërë si halë në sy; armiqve dhe tradhtarëve të shqiptarizmës. Mjerë ju, sa poshtë keni rënë, o servilë të mjerë shqipfolës!

MË VJEN KEQ SE HASHIM THAÇI DËNOHET NË HAGË AI ËSHTË DASHUR TË DËNOHEJ NË PRISHTINË?!

Hashim Thaçi duhej të dënohej për hajni dhe shumë gabime të tjera politike dhe ushtarake.
Unë, isha mbështetës i tij politikisht.
Një javë para se të mbaronte LÇ -re e UÇ K-, së Heroike, me nismën time pata organizuar takimin e tij me qeverinë daneze, vizitë që pati një sukses të dukshëm politik.
Mirëpo, tri ditë para se, ekipi…, gjegjësisht Sekretari i tij, Bilal Sherifi më thotë në telefon që, ne nuk të njohim ty, – sepse …, qe punë nepotizmi, Bilali e kishte me banim në Danimarkë, kushëririn e tij Ibrahim Xhemajlin.
- Pas atij rezultati të madh, filluan dhe përçarjet e mëdha nga Hashimi dhe Bilal Sherifi. Hajnitë fakti që, fatkeqësisht as LP K-ja jashtë vendit nuk më mbështeti, por kreu pa arsyeshëm filluan të më luftojnë dhe si rrjedhojë e kësaj më izoluan dhe asnjëherë nuk iu ka interesuar aktiviteti im politik në Danimarkë.
Unë, veprimtari politik i pandalshëm, që kam mbi njëqind e njëzetë artikuj në shtypin danez, të nxjerra në dritë në çdo mjet të informimit: në rtv, në shtyp, mua më kanë intervistuar mbi njëqind herë, gazetarë dhe intelektualë danezë, të cilët më kanë cituar në shumë artikuj të tyre, dëshmi për të gjitha këto i kam tridhjetë e ca letra të hapura që ia kam drejtuar qeverisë dhe po ato në kopje ia kam dërguar Këshillit Evropës, BE deri në OKB, më kënaqë fakti që të gjitha këto janë të botuara në shtypin e kohës.
Pra, të gjitha këto suksese si veprimtar i LPK-së ne kuadër të kontakteve me institutet daneze, të gjitha këto rezultate shokëve tanë të LP K-së, as nuk iu interesonte fare të më kontaktonin së paku që këto materiale me vlera historike të ruheshin në arkivat e LP K-së.

Kurrsesi, nuk mund të kuptoj as për lexuesit të sqaroj pse ndodhën këto poshtërsi, kishte mëri ndaj meje, apo dikush vuante nga egoizmi i mjerë…
Kur unë organizova më 17 Janar debatin publik me simbolin e rezistencës sonë kombëtare Adem Demaçi, ia tregova disa materiale ai m' u drejtua i kënaqur më tha: "Xhemil Zeqiri, këto materialet duhet të botohen, sepse ne shqiptarët i harrojmë.
Unë i botova disa nga këto, i kam botuar në shtatë libra.
1. Kosova jonë,
2. Në mbrojtje diplomatike të çështjes shqiptare.
3. Debate intervista dhe letra.
4. Drejt vetëvendosjes me tre bashkëautorë me Fadil Shytin dhe Mona Agrigoroaiei.
5. E vërteta bën armiq.
6. Arsyetimi të çon pranë së vërtetës.
dhe
7. Si ta shpjegojmë këtë lloj urrejtjeje.
- Në përgatitje për botim kam dhe librin e radhës – Ribotim, me ca shtojca, "Në mbrojtje diplomatike të çështjes shqiptare.

Kopenhagë, 26.03.2025

LIBRIN E ALBINIT E KA FINANCUAR XHEMIL ZEQIRI, E JO DEVOLLI, O SHPIFËS - VEHBI KAJTAZI!

Gëzim Mekuli
15 janar 2025

Demanton publicisti nga Tetova, Xhemil Zeqiri: O analisti banalist, o shpifësi i paskrupullt, Vehbi Kajtazi! Librin e Albinit, "Zgjohu" e kam financuar unë në vitin 2007
Në këtë fushatë zgjedhore në Kosovë nuk kishin se si të mos bëheshin pjesë edhe ata që vetëquhen dhe e quajnë njëri-tjetrin analistë, por që më shumë se analizë po bëjnë një fushatë të organizuar të shpifjeve të ulëta në drejtim të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti.



Basti i ish-pushtetarëve dhe "analistëve" të tyre ka qenë që ta portretizojnë kryeministrin Kurti të dështuar dhe të kapur, po aq sa kanë qenë ata që ishin në pushtet para tij. Por të vetmit që kanë

dështuar janë fushatat e tyre të shpifjes, përkundër fushatës së kryeministrit Kurti që po paraqet arritjet e qeverisjes së tij, arritje të cilat "shefat" e analistëve që ishin në pushtet nuk do t'i bënin dot edhe nëse do të qëndronin dy jetë në pushtet. Arritjet e tyre janë zhvatja e shtetit të Kosovës dhe dobësimi i subjektivitetit shtetëror, kohë e cila ka përfunduar dhe nuk do të rikthehet kurrë më.

Secili e di shumë mirë betejën e kryeministrit Kurti kundër zhvatësve, jo vetëm kundër atyre që kishin pushtetin politik, por edhe atyre që përmes lidhjeve me figurat e larta të ish-pushtetit morën atë që quhet pushtet ekonomik dhe që quhet ndryshe edhe oligarki.

Së fundmi, në fjalimin e tij në Pejë, kryeministri Kurti foli edhe për kompaninë Devolli, për vëllezërit Blerim dhe Shkëlqim Devolli, të cilëve u kërkoi publikisht që t'ia kthejnë Telekomit të Kosovës 62.6 milionë euro që ia kanë marrë në arbitrazhe të kurdisura.

Pas kësaj "analistët" e ish-pushtetit u angazhuan që të bëjnë shpifjen e radhës, për ta portretizuar përpjekjen e kryeministrit Kurti si një mashtrim apo fasadë.

Në emisionin Rubikon të drejtuar nga Adriatik Kelmendi, që transmetohet në televizionin e Devollëve, në Klan Kosova, Vehbi Kajtazi shpifi publikisht duke thënë se librin e Albin Kurtit "Zgjohu" e ka financuar për botim Blerim Devolli.

Nuk kemi çfarë t'i analizojmë "analistit" Vehbi, sepse atë dhe të ngjashmit e tij populli i Kosovës i njeh mirë dhe e di mirë se pse shpifin në atë mënyrë të ulët, por mundemi vetëm t'i paraqesim faktet që mashtrimin e Vehbi Kajtazit e nxjerrin në shesh.

Ndër ata që reagoi ishte gazetari, Gëzim Mekuli, i cili tha: "Nuk kam edhe aq shumë kohë për të humbur. E posaçërisht me shpifjet e dështakëve është edhe turp të merresh, por për shkak të etikës dhe edukatës time familjare për t'i dal zot të drejtës, dua të informoj publikun se ai individ (V.K) dhe aparati i tij kundër-Kosovë po shpif dhe mashtron edhe tek libri shqip".

"Garantoj se librin 'Zgjohu – për rezistencë drejtë lirisë' të Albin Kurtit e ka financuar Xhemil Zeqiri, atdhetar dhe publicist nga Tetova, me vendbanim në Danimarkë. Kam qenë i informuar kur ai dërgoi 5000 euro për 1000 ekzemplar. Kjo kishte ndodhur në vitin 2007", shkroi Gëzim Mekuli.

"Ky fakt është i njohur për ata që kishin akses në shtëpinë e VETËVENDOSJE! në Prishtinë, në atë kohë. Ndërkohë, ky individ, propaganduesi V.K., ishte ende fëmijë, ndoshta duke studiuar në Universitetin Partiak të Prisht(inës)", tha në fund gazetari Mekuli.

THIMI SAMARXHIU: Z. KRANAR SHALA NGA PRISHTIN DHE Z. XHEMIL ZEQIRI NGA KOPENAHGA DEBAT - ANALIZËN PER ZGJEDHJET 09. SHKURTIT 2025

Thimi Samarxhiu: z. Xhemil Zeqiri e dëgjat analizën e Krenar Shalës, ç'mendim keni, si një veprimtar dhe përkrahës i LVV në mërgim, si i patë rezultat e djeshme?

Xhemil Zeqiri: Po, e dëgjova analizën e Krenarit dhe pajtohem plotësisht me Krenarin, dhe një analizë të shkëlqyer. Analistin, Krenar Shalën, e respektoj, sepse ka qëndrime të pastra dhe të drejta. Unë, kam pritur dalje më të madhe, mendoj se pak ishte numri i votuesve, kam pritur të dalin mbi 70% popullit atëherë do kishim një rezultat me të mirë, megjithatë jam i kënaqur me rezultatin kur të kemi parasysh, se Albin Kurti e fitoi këtë mandat, këtë betejë kundër Opozitës, analistëve të gjitha mediave, kundër Vuçiçit, Edi Ramës, Ali Ahmetit e të tjerëve. Personalisht, një muaj kam ndjekë fushatën me një shqetësim te madh. Paramendojeni. Opozita ka derdhë lekë të mëdha, shkuan deri në SHBA. Që nëpërmjet Krye-Lobistit serb si e kishte emrin ai "Dylber Grenelli" të jep deklaratë propaganduese kundër Qeverisë së Albin Kurtit, pra lekë të mëdha janë derdhur nga Opozita si po të derdheshin këto lekë për popullin, nuk do ishte në këtë situatë, populli ynë i varfër, populli ynë nuk e meriton këtë keqtrajtim nga Opozita. Megjithatë, shpresoj që LVV të formojë qeverinë pa Yesmenët, fundi i fundit duhet njëherë e përgjithmonë shqiptarët t`i thonë të bardhës e bardhë dhe te zezës, e zezë.

-Sa për mërgatën ç'ishte pyetja juaj?

Thimi Samarxhiu: Po, na thuaj sa më shkurt nëse mundesh?

Xhemili: Unë mendoj se gati të gjitha lëvizjet patriotike për atdhedashurinë janë bërë nga mërgata, paramendojeni ata mërgimtaret tanë që erdhën në Kosovë, erdhën nga vullneti i madh erdhën me dëshirë me mish e me shpirt, shkuan të votojnë

për një udhëheqje të mirë, ata nuk erdhën se i detyroi dikush, por erdhën nga dëshira e lanë punën, harxhuan lekët, u lodhën udhëtimeve të gjata, erdhën për të votuar dhe pikërisht këtu qe dhe skandali që donin të vidhnin votat mërgimtarëve, që më vonë do të dalin dhe do t`i shohim më mirë skandalet...!

Thimi: Kenaqësi! Pyetja e dytë: Thimi Samarxhiu: siç tha edhe Krenari do vijojnë presionet ndërkombëtare, ju z, si mendoni si duhet të sillet Albin Kurti përballë kësaj situate?

Xhemil Zeqiri: Po unë përsëri pajtohem me mendimet e Krenar Shalës, dua të them se ndërkombëtaret atë punë kanë, por një gjë duhet të dihet mirë se, Albin Kurtin, nuk mundin ta shantazhojnë, dosje nuk ka dhe nuk kanë ku ta kapin. Qëllimi i të gjithëve përfshirë dhe ndërkombëtarët që të kenë një koalicion me Yesmenët, që ky do ishte një shantazh sa herë që qeveria do të bënte rezistencë ndaj marrëveshjeve kundër Republikës së Kosovës, e ndërkombëtarët të krijojnë kriza dhe të shkohet në zgjedhje, këtë bindje më forcon dhe intrigat e Këshillit zgjedhor në Kosovë që po e vonojnë procesin e numërimit...

-Mendoj se, edhe ndërkombëtarët dhe amerikanët do ta shohin se duhet të ketë një zgjidhje për shqiptarët, mos harrojmë se 3-4% serbët i kanë të gjitha të drejtat; dëgjoni askush nuk e vë në diskutim për shqiptarët që jetojnë në Serbi. Vetëm në Beograd kishte mbi 150.000 shqiptarë, ndërsa, në gjithë Serbinë ka mbi 600.000 pa përfshirë këtu, Kosovën Lindore. Ato tri qytetet shqiptare më të diskriminuara; Preshevë, Medvexhë dhe Bujanoc, e, për këtë ka shkruar dhe gazeta daneze, "Politiken", në vitin 1996. "Atje shqiptaret nuk kanë asnjë Shoqatë Kulturore, e lëre më, shkolla në gjuhën shqipe, apo media, bile, edhe frikësohen të flasin shqip, mos i dëgjon fqinji se, i paraqet te organet e pushtetit- diskriminues ndaj etnisë shqiptare.

Në debatet publike në Danimarkë dhe në mediat e kam rrahur këtë çështje. Për problemin e shqiptarëve atje, kemi pas debate. "Politiken" mori aksion; shkuan intervistuan ca persona në mesin e tyre edhe avokatin që e paditi në gjyq pushtetin serb për

heqjen e Autonomisë së Kosovës, pra, avokati Hysni Bytyqi, iu kishte dhënë intervistë "Politiken" dhe pasi u botuan pas tre ditësh e gjetën të rrahur e të keqtrajtuar rëndë nga policia sekrete serbe të ciline kishin hedhur në një park. Nuk di shumë, si qëndron puna me Hysni Bytyqin por, e di se kishin shpëtuar dhe ishte shkuar në Zvicër për mjekim. Bashkësia ndërkombëtare duhet t'ia ia ndalë hovin fashizmit serb; jo, për hatër të fashizmit të Serbisë Fashiste; shqiptarët në Kosovën Lindore dhe gjetkë, nuk munden të tjetërsohen! Duhet ndalur kjo dhunë e tmerrshme mbi shqiptarët. Unë, habitem me Opozitën dhe analistët, si nuk iu dhimbset populli, por, gjithë atë djersë, lot e gjak që është derdhur për t'u mbrojtur nga fashizmi serb me dekada e harrojnë, sikur të mos kishte ndodhur asgjë?!!!

Ja, e përsëris një shembull; Qelekulla në Nish është ndërtuar me kafkat shqiptare, aty akuzojnë 952 (Koka), duhet t'u themi fqinjëve tanë mizorë se, në vitin 1813, Beogradi ka qenë mbi 83% shqipfolës, këto duhet t'u thuhen edhe ndërkombëtarëve,-e, unë jam i bindur që, Albini ua thotë nëpër ato zyrat e mbyllura ku bëhen negociata për këtë edhe ndërkombëtarët nuk duan të diskutojnë me argumentet por, duan në bisedime ndonjë Yesmen të shantazhuar, që lehtësishtua bën, AMIN! Albini, nuk është i tillë, Albini, i ka mbrojtur dhe i mbronë interesat e popullit të Kosovës dhe më gjerë para ndërkombëtarëve, përballë, Borellëve, Llajçakëve & CO.

Unë mendoj se, Opozita dhe analistët duhet të ndalojnë shpifjet për shembull, Ramush Haradinaj e quan Albinin, "Albin Serbia", po ç'janë këto shpifje, pa fakte, pastaj, kërkon vota nga shqiptarët?! -E kërkon votën e shqiptarëve, pastaj pse nuk e votojnë Ramushin as AAK-n, natyrisht, sepse populli nuk han bar...

E, sa i përket atij Grenellit, mendoj se, shumë shpejt edhe amerikanët do të distancohen nga qëndrimet e tij të papranueshme që, vet Grenelli ka ndërhyrë në zgjedhjet e një vendi të pavarur,-siç është Kosova.

Thimi Samarxhiu: shumë faleminderit që morët pjesë në këtë debat, ju nga Kopenhaga dhe Krenar Shala nga Prishtina, iu falënderoj të dyve!
Xhemil Zeqiri: Faleminderit!



(Vizita ime ishte me ftesë nga kryeministri Albin Kurti.)

NË STUDION E TV EURONEWSALBANIA 21-04-2024

Zonja dhe zotërinj përshëndetje!
Unë jam Thimi Samarxhiu do të jemi bashkë, padyshim kur flasim për rolin e shqiptarëve në Ballkan, ua kemi kushtuar dhe ua kushtojmë një vëmendje të madhe shqiptarëve të mërgatës.
Padyshim se, mërgimtarët kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm në kancelaritë ndërkombëtare. Njëri nga këta është edhe Xhemil Zeqiri; një shqiptar nga MV.
Xhemil Zeqiri, kënaqësi që iu kemi në studio!
Xhemil Zeqiri: Faleminderit për ftesën!
Thimi Samarxhiu: Ju falënderoj që pranuat ftesën!
Pyetje: Si i sheh shqiptarët sot? E kam fjalën për shqiptarët në gjithë rajonin tonë; Kosovë, MV, Kosovë Lindore dhe në Mal të Zi?
Xhemil Zeqiri: Në fakt, patjetër më duhet të them se, nuk jam aq i kënaqur, kur të kemi parasysh atë veprimtari të madhe që kanë bërë shqiptarët (për të mos u ngjitur më lart) që nga viti 1981 nuk ishte as nuk është në vijë të duhur; nuk jam i kënaqur, sepse, janë derdhur me tonelata djersë, gjak e lot dhe ende nuk kemi arritur atë që kanë dëshiruar dëshmorët dhe veprimtarët e mëdhenj të çështjes kombëtare, që mbetëm gjallë. Me këto "suksese"; kështu që, Kosova pas një rezistence dhe LÇ-re, të madhe kundër forcave gjenocidale fashiste serbe; delegacioni saj në Konferencën e Rambujës u kthye po fitore të plotë; -sikur u tradhtua gjithë ato sakrifica të popullit tonë.
Thimi Samarxhiu: Pse?
Xhemil Zeqiri: Partitë politike shqiptare pranuan një Marrëveshje shumë të disfavorshme për shqiptarët e Kosovës, pranuan lojën dinake të Serbisë.
Thimi Samarxhiu: Po, më mirë që u nënshkrua?!

Xhemil Zeqiri: Po, sikur ta kishte nënshkruar edhe Serbia, atëherë, ç'do të bënim ne?! Siç dihet në vitin 1990 u shpall Pavarësia e Kosovës nga deputetët e Kuvendit të Kosovës. Atëbotë, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e kishte shumicën e popullit në anën e saj, por nuk ngulën këmbë për t'u jetësuar ajo Pavarësi; përkundrazi, deputetët ikën jashtë vendit, populli mbeti pa institucionet aktive të Republikës brenda vendit. Sikur bëhej njëfarë pushteti j brishtë "paralel" gjer në fund të viteve 90-ta, kohë kjo shumë e hidhur në robëri për shqiptarët. Pastaj, u organizua LÇ-re nga UÇK-ja. Tek pas një viti e gjysmë Bashkësia Ndërkombëtare e organizoi Konferencën e Rambujës. Është për të theksuar që, përfaqësuesit e LDK me Ibrahim Rugovën dhe disa elementë titistë, kinse, politikanë të pavarur; si Veton Surroi, Blerim Shala e ndonjë tjetër; shkuan në Rambujë dhe nënshkruan një Autonomi në kuadër të Serbisë. Por, mos të harrojmë, përfaqësuesit e UÇK-së, Hashim Thaçi & Co e shkelën betimin e dhënë para flamurit kombëtar; ata, ishin betuar me emblemën e famshme të UÇK-së, për ribashkim kombëtar. Pra, ribashkimi kombëtar s'u përfill, u harrua. Fati ynë, ishte që Serbia nuk e nënshkroi, se pastaj, vaj halli për ne, me ata liderë…

Thimi Samarxhiu: edhe më parë ishte premtuar bashkimi kombëtar, por qe anashkaluar, si mendoni?

Xhemil Zeqiri: Po, unë jam një veprimtar i vjetër, në vitet 1986-87, mora aksion në institucionet dhe në zyrat daneze me ç'rast mundohesha që nëpërmjet Adem Demaçit të sensibilizojmë problemin tonë kombëtar.

Thimi Samarxhiu: Po, patjetër dua të të pyes edhe për Demaçin; sepse, ju keni qenë njëri ndër bashkëpunëtorët e ngushtë të Demaçit?

Xhemil Zeqiri: Po, ashtu është. Unë, vazhdoja me shokët në mërgim që ta sensibilizojmë çështjen kombëtare dhe diskriminimin e shqiptarëve në Jugosllavi. Pra, shkoja zyrë më zyrë, pastaj shkova edhe në Lidhjen e Shkrimtarëve të

Danimarkës bisedoja me 'ta dhe shpërndava ca materiale në gjuhën gjermane, që m'i dërgonin veprimtarët e Lëvizjes Popullore të Kosovës,(LPK), më dërgonin ato materiale me të cilat argumentoja në Danimarkën demokratike, por gjithnjë mendoja se si të gjeja ndonjë mik demokrat që t'ia shpjegoja vuajtjet e shqiptarëve?

Kryetarja e Lidhjes së Shkrimtarëve, atëbotë ishte një femër e cila quhej, Toni Liversejq; ishte njohëse e mirë e Jugosllavisë dhe kishte marrë një çmim për përkthimin e librit kundër shqiptarëve të Vasa Çubrolloviç, "Ura mbi Dri"; i shpjegova, pra, i fola pak për shovinistin serb, Vasa Çubrilloviçin dhe vazhdova: unë, e ndiej veten shumë keq sepse në këtë shtetin danez fëmijët 10 vjeçar e dinë kush është Nilson Mandella, edhe pse ai, është shumë larg, në Afrikë, ndërsa, intelektualët danezë nuk e njohin shqiptarin Adem Demaçin i cili është 28 vj, në burg, sepse ka shkruar një libër dhe ka kërkuar të drejta të barabarta me popujt tjerë në Jugosllavi. Toni L, më tha; për çështjet jashtë Danimarkës është "PEN -Qendra Daneze. Unë, as që kisha dëgjuar për këtë organizatë të intelektualëve dhe të shkrimtarëve ndërkombëtarë. -Po, a ka mundësi të më jepni adresën,-i thashë? -Posi. Më dha adresën, caktova takim dhe shkova tek "PEN". Ata me pritën mirë dhe filluam bisedat ishte Sekretari "PEN-it" Johanes Riis një pesëdhjetë vjeçar. Urdhëro je për kafe? Po, faleminderit. Urdhëro ç' ke nga zemra për të biseduar? Po,-i thashë. Unë, jam shqiptar nga Kosova. Unë e ndiej veten të diskriminuar, këtu në shtetin demokratik danez, kur bisedoj për vuajtjet tona me njerëz bile edhe me gazetarë, ndërsa, ata nuk e njohin heroin tonë, Adem Demaçin, njëri ndër shkrimtarët e parë nga shqiptarët në Jugosllavi. Ay, është në burg qe 28 vjet. E, këtu fëmijët 10 vjeçarë e dinë se kush është N. Mandela. Ai, menjëherë e thirri Sekretaren, ia kërkoi "Dosjen e Jugosllavia" … Ja, më tha! Ne, tri herë kemi kërkuar nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, të kemi njohuri për Adem Demaçin; ja, sesa informata na kanë dhënë ata. E hapi dosjen ku shkruante:

"Adem Demaçi, është i burgosur, ka dy fëmijë dhe është ndarë nga gruaja, ishte një shkrim i dobët që mezi lexohej"?!!!
Thimi Samarxhiu: asgjë tjetër; si fj, vjen, pse është në burg dhe sa vite?!
Xhemil Zeqiri: jo, jo dhe veç atë që pashë.
1. Rissime tha, a ke mundësi të më sigurosh biografinë dhe veprimtarinë e shkrimtarit, Adem Demaçi? Posi, patjetër, por e kemi ne gjermanisht. S'ka problem, sepse flas unë gjermanisht. Të premten shkojmë në Hagë të Holandës, ne danezet e udhëheqim Kongresin e "PEN-it" Evropian dhe se, ne do ta marrim këtë çështjen e Demaçit, natyrisht ia dërgova biografinë dhe ditën e diel në mbrëmje vonë, me telefonoi dhe më tregoi se Adem Demaçi është anëtar nderi i Penqendrës Daneze dhe Evropiane,-nëse nuk gaboj. Kjo ishte një sukses që mua më dha një vullnet të madh që më tej të vazhdoj veprimtarinë.
Thimi Samarxhiu : po, për ç'veprimtari tjetër do na thoni që keni bërë në Danimarkë?
Xhemil Zeqiri: po, para këtij suksesi e pata formuar "Shoqatën Kulturore "BESA", atë Shoqatë e financova, vetëm dy veta e dinin se janë lekët e mia. Patëm një betejë politike me ambasadën jugosllave dhe me disa bashkëpunëtorë të tyre shqipfolës, të cilët nuk lejonin që Shoqata të emërohej, "Shoqata e punëtorëve shqiptarë nga Jugosllavia". Pas shumë përpjekjesh edhe ky sukses u arrit; qëllimi im ishte të kishim një Shoqatë, të kishim vulën tonë në gjuhën shqipe, të dëshmonim se jemi shqiptarë nga Jugosllavia. Unë, personalisht as nuk kam qenë anëtar i Kryesisë së Shoqatës.
Thimi Samarxhiu: Z. Zeqiri pasi përmendet anashkalimin e bashkimit kombëtar dhe miqtë tanë ndërkombëtar ishin kundër bashkimit kombëtar, ç'u desh të kishin bërë politikanët shqiptarë?
Xhemil Zeqiri: po, tani rezistenca ndërroi qëndrim, besoj iu kujtohet kur Gellbardi e quante UÇK-në terroriste, por Adem Demaçi, Përfaqësuesi Politik i UÇK-ës i saj bënte rezistencë dhe

rezistenca atyre ua ndërroi qëndrimin. Amerikanët e hoqën Gellbardin dhe sollën Hollbrukun si Përfaqësues të dialogut i SHBA-së.

-Dhe, është shumë interesant këtu të shpjegojmë se, pse Hollbruku shkoi në Junik, të takohej me ca Komandantë – lokalë, jo me Komandant, Remin në Besianë (ish- Podujevë); kur atje me ca pushkë edhe të gjahut ua thyen turrin Serbisë Fashiste,-por jo z, shkoi në Junik, sepse nëna e Georg Vashingtonit; ish-Kryetarit të parë amerikan ka origjinë nga Italia dhe nëna e i tij ishte nga Juniku, quhej, Nazlie Balaj. Por, politikanë shqiptarë, sikur nuk i kuptojnë ose nuk i lexojnë këto porosi që në politikë kanë domethënie të madhe. Politikanët shqiptarë është dashur t'ua imponojnë ndërkombëtarëve, ose më mirë të themi; t'ua shpjegojnë më mirë hallet dhe të vërtetat, pse Demaçi bënte rezistencë dhe nuk ndryshonte qëndrimet…

Thimi Samarxhiu: si mendon, a ka mundësi të ndryshojë situata?

Xhemil Zeqiri: po, po; ka mundësi, mundësitë janë, më lejo dua të kujtoj thënien gjeniale të Napolon Bonapartës kur thotë:

"Unë, e fitoj çdo luftë, nëse Komandant e vendosi një luan; ushtarët nuk kanë rëndësi le të jenë gomarë, por, kur Komandanti është gomar, me ushtarët luanë, humbet lufta"!

Tani, Kosova ka një Komandant luan, ai është Albin Kurti; prandaj, mesiguri do të shkojmë vetëm drejt fitores.

Thimi Samarxhiu: a ju kujtohet Albini, erdhi në pushtet me parullën për ribashkimin kombëtar, tani, e ka harruar, diçka nuk shkon?!

Xhemil Zeqiri: natyrisht, po është dhe jemi për ribashkimin kombëtar,-jo, jo nuk e ka harruar! Albini, e ka gjetur situatën të tillë dhe duhet të vazhdohet në këtë mënyrë, derisa të ndryshohet edhe Kushtetuta dhe në shumë aspekte ka shumë punë për të bërë.

Thimi Samarxhiu: po Albin Kurti nuk e artikulon më kërkesën e ribashkimit kombëtar; ndoshta edhe Albin Kurti e ka kuptuar se ribashkimin kombëtar nuk e lejojnë ndërkombëtarët?!
Xhemil Zeqiri: padyshim, ka ca zig-zake derisa, puna të vij deri atje; ribashkimi kombëtar është i (pa alternativë) i pakalueshëm; prandaj, edhe ata ndërko-mbëtarët duhet këtë të kuptojnë mirë; Albini, po ua shpjegon dhe çdoherë e më mirë, po ka mbështetje edhe nga ndërkombëtarët, natyrisht, punët ecin ngadalë, por sigurt. Situatën kur Albini mori udhëheqjen, postin Kryeministër, gjendja ishte tepër e vështire Pandemia "Covid 19" e dëmtoi jo vetëm ekonominë e Kosovës, por tërë bota kishte probleme ekonomike; pastaj, u hap lufta në Ukrainë, prandaj duhet bëtë ca veprime diplomatike në këto situata ku Iliriku (Ballkani) as Kosova nuk janë çështje dite; mendoj se duhet përdorur një strategji…
Thimi Samarxhiu: Pajtohem, por jo të heqësh kërkesën për bashkim kombëtar?!
Xhemil Zeqiri: Po unë VV e mbështes, sepse është e vetmja Organizatë politike në trojet shqiptare që pas LÇ-re, që ka një Platformë politike dhe në Statusin e saj e ka angazhimin për ribashkimin kombëtar. Albin Kurti, sot është Kryeministër i Kosovës dhe si Kryeministër ka shumë obligime për të gjithë banorët e Kosovës, jo vetëm për anëtarët e VV-së. Personalisht, unë nuk kam pritë këtë, në mandatin e parë të Albinit.
Thimi Samarxhiu: Cili është gabimi, që ka bërë Albini, që ju mendoni?
Xhemil Zeqiri: për mua ka rëndë të madhe që veriun e Kosovës ta çlirojë dhe territorin e Kosovës ta shpëtojë nga ricopëtimi; pastaj, çështjet tjera rregullohen me lehtë. Tani nuk do thosha, se ka ndonjë gabim. Gabim do ta quaja vetëm faktin që, Veteranët e Luftës së famëmadhes UÇK që erdhën nga Shqipëria e andej Drinit; u janë ndaluar ndihmat materiale (pensionet) ky qe një gabim i madh; por, Albini e gjeti të tillë këtë problem, por ai Komisioni po punon shumë ngadalë dhe se,

siç u pa, e rritën numrin në 60,000 veteranë, e, kur dihet fakti se, nuk kanë qenë as 15.000 ushtarë të UÇK-së Kam protestuar që, si ka mundësi t'u ndalet pensioni, Kolonel Dilaver Goxhajt, Adem Shehut, e të tjerëve luftëtarë nga Shqipëria e andej Drinit. Dilaveri Goxhaj, apo Kolonel, "Shpëtim Golemi" ka qenë Zëvendës Shef i Shtabit të UÇK-së, bile, ka pas një rol shumë të rëndësishëm në Shtab, në bashkëpunim me NATO-n. Urdhërat, ku të bombardohej mbi caqet serbe, NATO-ja, i ka marrë nga "Shpëtim Golemi".

Ushtria e shtetit shqiptar ka qenë shumë e fortë, me kuadro shumë të përgatitura, mësa jam në dijeni unë, pesëdhjetë ushtarakë me origjinë nga Kosova, ai " Diktatori" Hoxha, i ka përgatitur fort mirë, për Luftën Çlirimtare të ardhshme, për t'i çliruar trojet shqiptare dhe nga ata; asnjëri nuk shkoi në luftën e Kosovës, por, shkuan të tjerë si gjirokastriti Dilaveri me djalin e dëshirit, Dritanin, Adem Shehu Genc Sefa "Lushnja" e ca të tjerë.

Thimi Samarxhiu: Më bëri përshtypje, kur përmende "Diktatorin" bëre thonjëzat?!

Xhemil Zeqiri: Enver Hoxha për mendimin tim, nuk ka qenë diktator, por më shqiptarë i ditur dhe më strateg, më nuk do të lindë nëna shqiptare. Unë e kam financuar librin e Gjeneral, Veli Llakës, "Operacioni Shpërthimi"; aty, autori shkruan: "Me urdhër të Enver Hoxhës, u bë ai plan ushtarak.

Thimi Samarxhiu: Po, të flasim për "Diktatorin" do të na duhen orë të tëra, por, do ndalemi përsëri tek veprimtaria jote; si ke vepruar dhe si u njohe për herë të parë dhe ku e takove Adem Demaçin?

Xhemil Zeqiri: Po, për herë të parë jam takuar më 15 janar 1992, bashkë me disa veprimtarë, që sot janë opozitarë mendimesh me mua; ata kishin dalë të prisnin, Adem Demaçin, goxha larg Kopenhagës, kur ofrohen afër Kopenhagës, Baca Adem i pyet: Ku po shkojmë? Ibrahim Xhemaili, i thotë tek unë në banesë, Aaa,-jo, mua do t'më çoni te Xhemil Zeqiri. Atëbotë,

unë banoja në një banesë përdhese; kur ime shoqe më tha; u ndalua një makinë me tabela të Berlinit qenka; unë dola në dritare, shoh Baca ishte me ca të tjerë. Dola para dhe u përshëndeta, ndaj më tha; a ti je Xhemil Zeqiri, a? Po, unë jam. Baca Adem mirë se erdhe ,-heu, uhuhuh, unë kam menduar, sesa i madh je, por, ti qenke më i vogël se unë! Hahaha, qeshëm dhe u përqafuam. Më me 17 janar 1992 pata organizuar një debat publik në sallën kryesore të Kuvendit danez, ku morën pjesë mbi 300 veta, i ftuar ishte edhe Baca, i cili do shpjegonte tërë Platformën Shqiptare në Ilirik (Ballkan).
Të jemi të e qartë; personalisht kam pas një ekip danez, ku kanë marrë pjesë në Komitet, unë e kam udhëhequr Komitetin, por miqtë tanë danezë nuk lejuan që mua të më del emri, sepse frikësoheshin nga agjenturat jugosllave; qëkur, kishte ndodhur atentati mbi vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zekën në Gjermani, por edhe me Enver Hadrin në Belgjikë; prandaj, ata vendosën që Kryetare të jetë një Akademike e njohur në Danimarkë e cila quhej, Mina Skafte Jensen.
-Personalisht, kam dërguar 36 letra në Ministritë daneze dhe në BE dhe deri në OKB, të gjitha kanë qenë të botuara në shtypin danez, pastaj, kam mbi 100 artikuj, për çdo lëvizje apo ndodhi që ka ndodhur në trojet shqiptare, kam pasqyruar qartë, nëpërmjet këtyre artikujve dhe Letra të Hapura.
Në emër të Komitetit "Miqtë e Kosovës " kemi botuar 50 faqe materiale, si libër u quajt "Dokumentet e bardha për Kosovën" dhe një libër afër 200 faqe "Kosova një Konflikt i vjetër", e, jo siç thoshin ish-LKK që u konvertuan në LDK, se që nga 1989 Kosova është në okupim!!! Pastaj, kam organizuar dy Konferenca Ballkanike nëpërmjet Komitetit me shtetin danez dhe partia në pushtet, Social Demokratët i ka financuar të gjitha shpenzimet. Nga Kosova ka qenë Adem Demaçi, Harulla Gorani dhe Ibrahim Kelmendi, nga LPK në mërgim. Nga Maqedonia ishte Arbër Xhaferi e Shaip Emërllahu, nga Tirana kanë qenë Dritro Agolli dhe Skënder Gjinushi.

Thimi Samarxhiu: na thuaj momenti me i bukur dhe më i vështirë me Adem Demaçin, që keni kaluar bashkë?
Xhemil Zeqiri: Po (hahaha qesha), me familjen u nisëm për pushime në bregdet ne Durrës. Kur mbërrimë në kufi, në Qafë Thanë më ndaluan policët maqedon. Aty na vonuan 4-5 orë, gruaja me dy fëmijët u frikësuan shumë, kishte dalë problem me djalin 16 vjeçar i cili donte të sulmonte policë, t'ua merrte armët; i ri nuk i kuptonte gjërat mirë, gruaja e kishte frikën për djalin, mundohej ta qetësonte, vajza 9 vjeçare, shqetësohej gjithashtu, natën në mal atje në kufi. Dikur më liruan me kusht që, kur të kthehem të paraqitem.
U nisëm për në Durrës, rrugës bashkëshortja ime Sabrija dhe fëmijët kishin ndërruar mendim; më thonë: jo, nuk duam të shkojmë në Durrës, duam të shkojmë në Sarandë, djali më thotë; duam të shkojmë, sepse atje është edhe Baca Adem.
Mirë, i dëgjova. Shkuam në Sarandë, pasi ia rraha telin; u paraqit Baca Adem. I tregova se, jemi në Sarandë. Prisni se erdha-më tha.
U takuam dhe na propozoj të shkojmë në darkë në një restorant të mirë, qe i njihte nikoqirët. Shkuam, filluam të bisedojmë. Ndërkohë, shoqja më thotë në sy, tregoj se ç'na ndodhi në kufi. Unë, nuk desha t'i tregoja. Thuaj ti i thosha ngadalë, etj. Baca na vërejti ç'ishte problemi, hë, ç'hall keni? Ja, tha le të të thotë Sabrija, ime shoqe-i them. Ajo, më tha:- jo, thuaj vet; -ç`na ndodhi pyet Baca? Po me ndalën ne kufi, o bac. Edhe? Pyeti baca? Po, më mbajtën 4 -5 orë, pastaj më liruan…., Hehehe!- ata, janë shumë të mirë, e di unë se ç`ke bërë ti kundër tyre; unë nuk kam bërë sa ti, po me mbajtën 28 vjet, e ti,-e di unë, po, edhe ata e dinë, hahaha! Heu, na frikësoi më shumë, Baca. Shoqja mendonte se baca Adem ka autoritet të na ndihmonte në kufi. Kjo ka qenë e rëndë për ne, që nuk do ta harrojmë, kurrë.
Thimi Samarxhiu: Si mendon ti, si të kishin bërë më mirë situatat në favore të politikës sonë ?

Xhemil Zeqiri: Po, unë kam pas një ekip miq danezë ishin rreth tridhjetë persona; gazetarë, politikanë, aktivistë politikë dhe njerëz të mirë, njohës të çështjeve ndërkombëtare. Po të kishim ca aktivitet në vendet evropiane, në shtete të tjera, ndryshe do t'i kishim situatat. Ja, një shembull; një ditë më telefonoi një aktivist i Ekologjisë, është Magjistër i Shkencave Juridike, quhet, Niels Henrik Hooge. Shprehu dëshirën të takohej me mua dëshiron të takohet me mua, u takuam dhe me thotë se, kam vendos të shkoj në luftë, a ke kryer ushtrinë? Jo, më tha.-Po, si do shkosh në luftë-i thashë?! Unë,- tha do shkojë në luftë si shenjë proteste se, NATO-ja po bombardon nga qielli, por nuk futet me këmbësori në Kosovë. Më bëri fort përshtypje. Mirë. E lamë të takohemi të nesërmen me të. Bisedova me gruan time Sabrijen, se, një shkrimtar ka shkruar 19 libra dhe është aktivist i ekologjisë, vjen në këto organizata; por, me tha se nuk e njoh historinë tuaj. Duhet të përgatisim darka që ta marrim më shpesh në darka, që t i shpjegoj. Pasi e përgatitëm mirë, ai shkoi në Kosovë.

-Kam pas bashkëpunim me të gjitha mediat daneze; me një rast, i them një shokut tim gazetar, quhet Nils Klitit, punon te TV2; a ke mundësi të bëjmë një dokumentar me një intelektual se donë të shkojë në luftë në Kosovë.

Ai, e bëri një dokumentar të fortë, një Intervistë me një informacion dhe në Radio Danimarkën, lajmi ekskluziv ishte se Intelektuali danez i bashkohet UÇK-së. Ia pagova rrugën për në Tiranë, shkuan bashkë me Hajdin Abazin. Atje bëri ca përgatitje ushtarake dhe hyri në Kosovë; mirëpo, por pas tre ditësh u ndal lufta, Nilsi mbeti edhe një vit në Kosovë; ndihmonte me raporte të BE. Ndihmoi edhe për ekologjinë, ishte shumë aktiv, çmonto-nin minat që kishin vendosë ushtria serbe e të tjera. Për veprimtarinë e tij atje, ka botuar një libër me titull; "KOSOVA, e jo Kosovo" -siç e quajnë disa politikanë tanë…

Thimi Samatxhiu: Po pas përfundimit të luftës me ç'je marrë?

Xhemil Zeqiri: Siç përmenda më parë kur ishte Baca Adem në Danimarkë te unë, ia tregoja dokumentet letër- këmbimet me

anëtar të Kuvendit danezë, me Ministrinë e jashtme, me BE etj, ai m'u lut që këto të gjitha duhet të botohen, sepse iliret kanë 3000 vite që ne shqiptarët mundohemi t'i kujtojmë, por nuk mbahen mend. Duhet të regjistrohen dhe të botohen në libra. Unë, patjetër dua ta përshëndes një poet, shkrimtar veprimtar i cili jeton në Malmë, quhet Fadil Shyti, sepse më ka ndihmuar shumë edhe kur e formova Këshillin e LVV në Kopenhagë; vlen të theksoj faktin që, shokët Gëzim Mekuli në Osllo, Fadil Shyti në Malmë dhe Shqiptar Oseku në Stokholm; menjëherë pas themelimit të Këshillit të VV në Kopenhagë i formuan Këshillat dhe duke bërë këtë, i dhamë një mbështetje të fuqishme politike morale dhe ekonomike LVV, sepse fillimi i veprimtarisë së VV, ishte i vështirë. Me këto që i theksova kemi vepruar bashkë për LVV, poashtu, shokun Fadil Shyti e kisha dhe çdoherë e kam krah të djathtë; më ka ndihmuar pa masë, këto pesë librat e mia i ka redaktuar për botim dhe nuk pranonte, as një lek me më marrë; bile, me vendosmëri shoqërore më ka kushtëzuar që, as një shkrim mos e dërgo për botim në shtypin e kohës, pa e redaktuar unë në gjuhën e njësuar shqipe, të kemi parasysh faktin që, unë jam punëtor dhe nuk kam studiuar gjuhë dhe letërsi, e them hapur me keqardhje dhe sinqeritet që, kam mangësi të theksuara në drejtshkrim.

Thimi Samarxhiu: Z. Xhemil, ju keni dhënë një kontribut edhe për formimin e Universitetin e Tetovës, a mundeni të na tregoni shkurt?

Xhemil Zeqiri: Po, kur pushteti maqedon me brutalitetin më të egër e sulmoi Universitetin me policë, atje gjakosën rininë dhe studentët shqiptarë, unë organizova një Konferencë Ballkanike bëra intervista dhe shkrova artikuj; me ç'rast e dënova aktin brutal, po ashtu iu drejtova me një letër së bashku me Akademiken Mina Skafte Jensenin, Këshillit për arsim në Këshillin e Evropës. Një kopje ia dërguam edhe delegacionit të Kuvendit danez, Hening Golerodhit , pas dy javësh i kërkova një takim, shkova dhe biseduam; i tregova se Allan Plate nga Këshilli i

Evropës na ka kthyer letrën një kopje ia dhashë! Edhe Heningu më premtoi se na do bëjmë çmos që të legalizohet UT dhe këtë e kam me konfirmuar me shkrim e kam botuar edhe ne librin tim "Si ta shpjegojmë këtë lloj urrejtje"!

Thimi Samarxhiu: ju mendoni se ndërkombëtarët nuk e dinë situatën, por pse këtë qëndrim ndërkombëtarët. Po, ndërkombëtarët i bëjnë presion Kosovës që Serbia të mos shkon me Rusinë?

Xhemil Zeqiri: I uruari Z, Samarxhiu, unë kam qenë kundër negociatave që filluan në Vjenë të Austrisë, dhe këtë e kam dënuar nëpërmjet TV Danez, në programin e parë shtetëror dhe kam thënë: "Tërë bota e ka parë me sy, sesi Serbia i trajtoi shqiptarët dhe përsëri u dashka negociata, çfarë negociatash të bëjmë, të bëjmë tregti me të drejtat tona, kjo kurrë nuk do ndodh pavarësisht sesa, servilët ia plotësojnë apetitet Serbisë Fashiste; populli nuk do pranojë një gjë te tillë". Ne, si popull kemi humbje të madhe me këta servilët politikë me këta Yesmenët, ato marrëveshje në dëm të Kosovës e shqiptarëve duhet të hidhen poshtë. Albini po mundohet t'i i riparojë këto dëme që ia kanë bërë Kosovës.

–Paramendoje, kur të i dëgjosh analistët, të të them të drejtën unë mundohem të dëgjoj debate pasdite në TV e Kosovës. Mbesa ime pesë vjeçare i bërtet gruas sime, nëno i lëshoi gjyshi budallenjtë. Po, këta analistë-banalistët e çmenden popullin, këta argatë të dreqit të ashtuquajturit, "analistë". Paramendo, gruaja ime ka qenë gjithmonë përkrah meje në veprimtarinë time, ndërsa, tani është neveritur prej tyre, tani shikon filma të huaj, sepse, nuk mundet t'i dëgjojë këto TV tona. Asgjë pozitive janë duke dhënë në popull.

Thimi Samarxhiu: Po, edhe Albini pranoi Asociacionin për serbët?

Xhemil Zeqiri: jo, ajo nuk pranohet ashtu siç mendojnë serbët një mini-Republikë, por asociacion,-siç ka Danimarka, Italia e të tjera shtete në Ilirik dhe në Evropë; që aspak nuk shkel

integritetin e Republikës së Kosovës, kjo mundet edhe të ndodh, por jo me kompetenca siç kanë dhënë në Marrëveshjet e Hashim Thaçit dhe Isa Mustafës.

Thimi Samarxhiu: Z, Zeqiri për fund si vlerësoni politikën e shtetit shqiptar në raportet me republikën e MV?

Xhemil Zeqiri: nuk jam i kënaqur. Unë, PSSH e kam ndihmuar shumë bile, jo vetëm si aktivist e anëtar i Partisë Social Demokrate Daneze, por, nëpër-mjet nënkryetarit të Partisë që e kam pas mik të mirë, Leze Budtzi. Në mars të viti 1990 kam futur delegacionin e PS në këtë Konferencë në OSBE, që mbajti. Ishin Namik Dokle, Luan Hajdaraga me dy të tjerë, por nuk me kujtohen emrat. Por e kam thënë se kur PS pruri eshtrat e Mi'that Frashërit në Shqipëri, atëherë me PSSH nga Rilindja Socialiste u bë Rilindje Neofashiste!

E, sa për politikën e MV; Qeveria shqiptare po shkel Kushtetutën, Kryeministri Edi Rama, nuk i përkrahë kërkesat e drejta të popullit shqiptar, por kërkesat e partive politike dhe këtu shkel Kushtetutën gjegjësisht, Neni 8 i saj, që obligon që, Shqipëria duhet t'i mbrojë shqiptarët jashtë atdheut. Nuk është në rregull që qeveria shqiptare të mbështes vetëm partitë shqiptare, e, jo popullin. Atje po krijohen parti që nuk i mbrojnë interesat e popullit, në MV. Shqiptarët përjetojnë diskriminim më të rëndë. Paramendo dy ministra që e quajnë veten ministra shqiptarë, komunikojnë n'mes vete me porosi në gjuhën sllave. Shqiptarët e Maqedonisë do të pësojnë një asimilim, sikur në Çamëri apo në Sanxhak.

Thimi Samarxhiu: Po, ç'duhet të bëjë qeveria?

Xhemil Zeqiri: Qeveria duhet t'i mbështes kërkesat e popullit, jo të partive, ja për shembull Kryeministri Rama më tepër i bën presion Albin Kurtit, se Vuçiçi. Duke i thënë, pranoje asociacionin; e, bla, bla, bla... Asociacioni nuk mund të pranohet, pa u pranuar Pavarësia e Kosovës nga Serbia, se pastaj duhet përsëri të bëjmë lëshime.

Thimi Samarxhiu: po, është presioni ndërkombëtar?

Xhemil Zeqiri: po, ndërkombëtarëve duhet dikush t'u thotë troç,-e, këtë ua thotë vetëm Albin Kurti. Ndërkombëtarët duhet ta dinë se, në vitin 1810 Beogradi ka qenë 85% i banuar me shqiptarë. Qelekulla në Nish me 952 kafka shqiptarësh ato janë shqiptare, jo serbe; janë serbët ata, që po e falsifikojnë historinë.
Thimi Samarxhiu: Shumë faleminderit që ishe në Eruronews-albania, dhe do jeni edhe hera tjera.
Xhemil Zeqiri: Faleminderit juve!



"Gjatë përurimit të librit tim 'Polemika, intervista, debate dhe letra', në korrik të vitit 2005, në sallën e Institutit Albanologjik në Prishtinë, organizuar nga simboli i rezistencës sonë kombëtare, Adem Demaçi. Në foto: në të djathtë prof. Beqir Berisha, ndërsa në të majtë prof. Sadri Fetiu dhe Xhemil Zeqiri."

REAGIM NDAJ "VEPRIMTARIT TË MADH", QË NUK E NJEH AS LAGJJA E VET – KUJTIM LUSHA

Nuk kisha ndërmend të reagoj, por shumë miq të indinjuar më telefonuan duke më thënë: "Mos u shqetëso, i dimë kush është ai dhe kush janë ata".
Për këtë arsye u detyrova ta bëj këtë reagim.
Prej kohësh nuk kam hasur sulme direkte të paskrupullta nga "veprimtarë të mëdhenj", -siç po paraqiten në RTV Istogu Chanel, Nexhmedin Gërlica nga Kosova, mërgimtar në Gjermani dhe Kujtim Lusha nga Kosova, mërgimtar në Belgjikë.
Personalisht, nuk i njoh këta luftëtarë fjalë-mëdhenj të çështjes kombëtare, ndërsa ata më "njohin" në mënyrën e tyre, krejt së prapthi. Jam i bindur thellësisht që, nëse do të më njihnin realisht, nuk do të më sulmonin me shpifje të ulëta dhe pa asnjë argument. Akuzat të tipit: "Enverist i qelbur, stalinist, leninist, agjent i sllavo-maqedonëve, agjent i Gligorovit", "Taksist i Beogradit" e të tjera,– të gjitha këto akuza të pa baza, nuk mund t'i thonë njerëzit normalë. Këto janë vetëm shpifje dhe trillime të mendjeve të tyre të sëmura.
Jo, mor zotërinj! Nuk mundet të fshihet historia me një të rënë të lapsit, ajo luftë heroike që ka ndodhur gjatë luftës antifashiste; nuk zhbëhet ajo, për huqet tuaja prej "veprimtarësh të mëdhenj". Prandaj, ju sugjeroj miqësisht, uleni kokën, lexoni historinë e atyre viteve. Aty do të mësoni që, Enveri dhe Stalini ishin aleatë të mëdhenj anglezëve dhe të amerikanëve. Kur bota u rrezikua nga egërsirat fashiste, Hitler - Musolin & Co, udhëheqësit mendjendritur, nga të gjitha meridianët, pa dallim të ideve divergjencave politike dhe ideologjike; ata, ditën dhe mundën, morën guximin për t'u bashkuar në aleancën e madhe të shteteve sovrane, që ta ndalin të keqen e madhe që po i rrezikonte popujt liridashës dhe këto shtete. E përsëris; historia nuk ndryshohet

sipas dëshirave tuaja donkishoteske.
Për veprimtarinë time politike më njohin të gjithë ata që duan të më njohin realisht dhe shqiptarisht. Madje, në fillim, kur dëgjoja përmes valëve të Istog Channel me moderatorin, Luard Mehmetajn, vetë i kërkova miqësi Kujtim Lushës në Facebook. Ai më pranoi, por pas një dite më bllokoi pa asnjë arsye. Sigurisht, kjo është e drejta e tij – siç thotë populli: "Vëllain ta lind nëna, ndërsa mikun e zgjedh vet".
Por, tjetër është të mos pranosh dikë si mik, e tjetër është të shpifësh kundër njerëzve që kanë dhënë kontribut të madh për çështjen shqiptare. Këto dy "personalitete" shkojnë aq larg, sa hedhin baltë edhe mbi heronjtë kombëtarë e ndërkombëtarë që e kanë udhëhequr dhe përkrahur popullin shqiptar në momentet më kritike të ekzistencës së tij.
Po ashtu, ata sulmojnë edhe kryeministrin shqiptar Edi Rama me fjalorin më të pistë. Unë, gjithmonë kam kërkuar që, çdo figurë publike të kritikohet me argumente, jo me fyerje as me shpifje. Ndaj, kur ata përdorin gjuhën e Sali Berishës – njeriut që shkatërroi Shqipërinë në vitet 1991–92, duke rrënuar mbi 500 fabrika, kooperativa, plantacione e duke prerë mijëra pemë ulliri me parullën "të shkatërrojmë komunizmin" – e kuptoj qartë, se çfarë mentaliteti mbartin.
Kujtim Lusha, në deklaratat e tij, mundohet të shitet si zëdhënës i NATO-s, i Departamentit të Shtetit apo i Shtëpisë së Bardhë. Herë pas here thotë: kinse, iu ka shkruar krerëve politikë të Kosovës dhe të Shqipërisë. Kjo është puna e tij; mua kjo, nuk më intereson.
Por, kur kalon në shpifje personale dhe më akuzon se jam, "i biri i shkjaut", atëherë kjo nuk është më kritikë, por, është urrejtje primitive dhe thirrje e maskuar për dhunë.
Unë i them qartë: syri për sy, nuk më bën përshtypje. Misionin tim politik e kam kryer. Për më shumë se 40 vitesh jam në shërbim të popullit e të atdheut tim; brenda dhe jashtë atdheut e kam demaskuar politikën shoviniste serbo–malazeze–

maqedonase në diplomacinë daneze dhe evropiane. Rreth 60% të këtyre qëndrimeve i kam botuar në 8 librat e mi, si: "Kosova jonë", "Në mbrojtje diplomatike të çështjes shqiptare", "Drejt Vetëvendosjes", "Debate, intervista dhe letra" "E vërteta bën armiq", "Arsyetimi të çon pranë së vërtetës", "Si ta shpjegojmë këtë lloj urrejtje", e të tjerë.

Kjo urrejtje juaja nuk buron nga argumentet politike, por kjo më zgjon dyshimet, më shumë buron nga mentaliteti i atyre kanibalistëve, që gjithmonë kanë punuar kundër shqiptarëve atdhetarë. Në rradaket e tyre; ka zënë myk është urrejtja me ide të huaja që përthithet nga disa pusa shqiptarë dhe kthehet në sulme ndaj vëllezërve të vet.

Me këta dy "personalitete" nuk munda të komunikoj dot as privatisht – nuk kanë adresë, nuk gjenden as në Google, as nëYouTube, as realisht në Facebook. Prandaj, vendosa të shkruaj publikisht. Ju mund të vazhdoni të fshiheni pas emrit të Rugovës e të Kurtit, por sulmet e pamatura që keni bërë e po bëni ndaj meje, natyrisht që e tregoni fytyrën tuaj të vërtetë. Shpifësit dhe trilluesit, gjithmonë janë humbës, ata i ka dënuar populli dhe historia.

- Këtyre "analistëve" dhe zhurmuesve steriotipe, dua t'ju përkujtoj dhe kërkesën time; ju që po më akuzoni mua së koti me shpifjet të cekura më lart; dilni dhe faktoni ato me dokumente, me video, po deshët edhe me personazhe konkrete, atëherë nga ana ime; nëse pa qëllim; siç shprehet një personazh në një film shqiptar: "Kujdes, mos e ha një lugë helm, se pastaj të të vijë era tërë jetën"!

Pra, nëse unë paskam gabuar ndokund pa dijeninë time; "paskam ngrënë ndonjë lugë helm" për të më ardhur era tërë jetën"; jam në gjendje të kërkoj falje publike popullit tim dhe të marrë mbi vete çdo përgjegjësi morale dhe penale. Unë, pra dola me qëndrimet dhe zotimet e mia me fakte, pa dorashka…

- Kjo, tani më detyron që të kërkoj prej jush, jo qëndrimet tuaja ndaj meje, sepse ato po dihen; por, i qëndrimet tuaja ndaj popullit

e atdheut: kush jeni ju, çfarë keni bërë dhe po bëni në shërbim të popullit e atdheut, apo ishit dhe jeni në shërbim të "djallit e të birit"?! - siç thotë populli.
Mos harroni, mua dhe juve nëse jo askush tjetër; me siguri, si individë të mirë apo të këqij, si atdhetarë apo tradhtarë na njohin njerëzit tanë dhe më gjerë…
- Unë, nuk ndaloj, do të vazhdoj më tutje të jem avokat i kombit shqiptar, një prej kombeve më të lashta të Evropës dhe më gjerë.

Qerret-Kavajë, 18.08.2025

REAGIM NDAJ "HISTORIANIT" AGIM GJAKOVA

Z, Agim Gjakova!
Këto ditë e dëgjova një intervistë dhënë gazetarit me damkë titiste, Veton Surroit.
Ke kaluar çdo kufi duke shpjeguar së prapthi disa ngjarje historike.
Mjaft me shtrembërimin e historisë dhe baltosjen e figurave të rezistencës shqiptare!
Për një intelektual dhe për më tepër një ish-disident kundër regjimit titist i cili në vitet e rënda të robërisë u detyrua të ikë nga vendlindja, të kalojë në pjesën tjetër të atdheut të lirë, në RPSSH, është e papranueshme që sot, pas gjithë asaj që kemi kaluar si komb, të vazhdojmë të dëgjojmë tani, zëra të mekur si të Agim Gjakovës, që me një papërgjegjësi të frikshme, arrin sajojë narrativë të rreme mbi ngjarjet më të ndjeshme të historisë sonë, duke hedhur baltë mbi figura të shquara të rezistencës kombëtare, si Haki Taha dhe Adem Demaçi.
Agim Gjakova, shpifë dhe trillon të pavërteta për vrasjen e Miladin Popoviqit.
- Duke pretenduar si shumë demonë-kratë të sotëm zhurmaxhinj sipas historianëve të ca kurseve "të plepave" të Sali Berishës, që betohen në dhijose-kraci kinse, Miladini, u vra nga atdhetari - Haki Taha.
Kësaj, anekdote politike i thuhet:
"Eja babë, ti kallëzoj arat"!!!
(Populli).
- E, kjo çfarë ju pretendoni, faktikisht, nuk është hiç e vërtetë.
- Miladinin e ka vrarë dora gjakatare serbo-çetnike, e serbit Dushan Mugosha, i veshur në uniformën parti-zane të Titos.
- Këtë e ka pohuar me një rast, vet nëna e Miladinit e cila pa dorashka tha: "Djalin tim e vrau OZNA, konkretisht dora e zezë

e Dushan Mugoshës", të cilin nuk e pranoi pjesëmarrës në ditën e varrimit të Miladinit.
Kështu, shkruan në kujtimet e tij, udhëheqësi i LANÇ-re, Enver Hoxha.
- Akademiku i shquar, historiani, Hakif Bajrami me një rast ka deklaruar: "Po, atë ditë, nga UDB-a, është vrarë Serveti, Haki Taha në në ora 9-të, ndërsa, Miladini u vra në ora 11:00.
- Prandaj, me të drejtë historiani ynë shtron pyetjen: si është e mundur i vdekuri, Haki Taha, të çohet dhe të vret Miladinin në ora 00:11, po të njëjtën ditë"?!!!
- Tani, shpifjet vazhdojnë me të madhe, kinse, Haki Taha e ka vrarë Miladin Popoviqin, për tradhti ndaj Kosovës?!
- Këto shpifje janë krejt të pavërteta, posi, këtë çështje e ka shpjeguar në mënyrë brilante – Akademiku dhe historiani, Hakif Bajrami i cili më tej vazhdon: "Pretendimi se, Haki Taha e ka vrarë Miladin Popoviçin, është një shpifje e rëndë dhe një rishkrim i turpshëm i historisë, që bie ndesh me burimet serioze dhe me të vërtetën e njohur publikisht: vrasja e Miladinit, ishte rezultat i përplasjeve të brendshme brenda aparatit jugosllav, me gjasë kjo vrasje u krye nga dora e Dushan Mugoshës, apo segmenteve të tjerë të UDB-së".
- Të përpiqesh t'i faturosh një veprim të tillë një patrioti të mirënjohur si Haki Taha, është një akt i ulët, që ka vetëm një qëllim: të njolloset rezistenca shqiptare dhe të amnistohet roli shtypës i udhëheqësve shovinistë, të ideologëve jugosllavë.
Kur jemi në këtë temë dua të theksoj faktin që, Miladini ishte një komunist i vërtetë malazez, atij ia kishin shpëtuar jetën guerilasit e Enver Hoxhës, kur ai ishte kapur nga fashistët në Mitrovicë dhe ishte dërguar në burgun e Peqinit. Me një aksion të rrufeshëm, guerilasit komunistë e kishin thyer burgun fashist, me ç'rast e kishin liruar nga burgu komunistin malazez, Miladin Popoviqin.
Për këtë akt heroik, Miladini ishte shumë mirënjohës dhe bëri gjithçka që t'i ndihmojë shqiptarët në LANÇ-re. Miladini, jetoi dhe veproi tri vite në Shqipëri.

- Është e vërtetë që e ka dhënë ndihmën e tij të sinqertë, të pakursyer dhe shumë të dobishme në themelimin e PKSH.
Ndërsa, Dushan Mugosha "ndihmën" e kushte me pabesi. Prandaj, Enveri pas disa mospajtimeve me të, e ndoqi nga Shqipëria. Pastaj, me kërkesën e PKJ-së, të kriminelit Tito, Miladini detyrohet të kthehet në Jugosllavi.

Vlen të theksohet këtu fakti që, ka dokumente historike që, vetëm disa muaj para se të vritej, Miladini në një Konferencë të LKJ-së në Beograd, deklarohet qartë, pa ekuivokë deklaroi: "Kosovës, prej nesh, (PKJ-së), duhet t'i njihet e drejta e kombeve për VETËVENDOSJE.

Në Kosovë, duhet të mbahet një Referendum, ku populli i saj me Vise të tjera shqiptare, të përcaktohen qartë, sipas vullnetit të tyre në tre variante për të ardhmen e tij:
1.Dëshirojnë t'i ribashkohen Shqipërisë.
2.Dëshirojnë të kenë Republikën e vet, "Punëtore dhe fshatare" – siç e quante ai dhe
3.Dëshirojnë t'i bashkohen Jugosllavisë?!
- Po në atë Konferencë, kundër reagoi delegacioni serb në veçanti, çetniku i maskuar në uniformën partizane me librezën e gjakpirësve të LKJ-së, Dushan Mugosha.
- Faktikisht, Serbia duke parë rrezikun që Kosova po i dilte nga duart, Dushani me bandat e tij terroriste në Kosovë, vendosi ta vret udhëheqësin komunist, mikun e madh të shqiptarëve, Miladin Popoviqin. Por, tragjedia po atë ditë morti, nuk do të përfundonte me ca viktima të cekura më lart, - po atë ditë Serbia në Prishtinë bëri masakër të paparë, me ç'rast i vrau mbi njëqind shqiptarë "nacionalistë", "irredentistë", të cilët kinse, paskan dorë në vrasjen e Miladinit.
- Në Prishtinë, është një vend, ku quhet "Tauk Bashqe", dikur dhe sot e sot, populli rrëfen se, aty mund të jetë një varr masiv i shqiptarëve, që fashistët serbë i kanë hedhur trupat e vdekur.

Shqetëson fakti që, në këtë intervistë të Agim Gjakovës, skandali nuk mbaron aty.
Agim Gjakova, merr guximin, prej "historiani" de fakto, prej zhurmaxhiu, që të hedhë baltë mbi figurën madhështore të simbolit të rezistencës shqiptare, Adem Demaçi.
Ademit, i cili qe një personalitet që tërë jetën e tij e sakrifikoi për komb e atdhe. Ky simbol i pathyeshëm, në vitet e errëta të robërisë.
- Sulmet e paskrupullta ndaj Demaçit, nuk janë thjesht shpifje ndaj një individi, por janë dhe një atentat ndaj vetë, ndërgjegjes sonë kombëtare.
Agim Gjakova dhe sojnikët si ky, duhet ta dijë mirë se, historia nuk mund të retushohet, të deformohet sipas orekseve të njëanshme ideologjike… Shqiptarët, e dinë fort mirë, kush ishte Miladin Popoviçi, kush ishin Haki Taha dhe kush ishte, Adem Demaçi.
- E dinë fort mirë, kush i ka shërbyer lirisë, dhe kush robërisë.
- E dinë fort mirë, kush qëndroi përballë rreziqeve, për ta bërë atdheun e lirë, por edhe kush iku nga Kosova, ku i dihet pse "i ndjekur" nga regjimi jugosllav, si Kapllan Resuli i cili u strehua si "disident" në RPSSH, por, pastaj u dënua për veprimtari politike si armik i popullit shqiptar.
Jo! Nuk do të lejojmë që emrat e atyre që dhanë jetën për këtë vend të njollosen nga pseudo-intelektualët që kërkojnë të përfitojnë nga mjegullat e injorancës politike, apo nostalgjia për pushtetet e huaja.
- Mjaft më me manipulime!…
Mjaft më me shpifje!… Populli shqiptar e ka kaluar rrufeshëm, me rezistencë errësirën, prandaj, sot më shumë se kurrë ka nevojë për të vërtetën dhe të drejtën legjitime për të mbrojtur figurat e tij të ndritura, për të çuar përpara trashëgiminë e atyre që nuk u përkulën para pushtuesve.

Është për të ardhur keq "Sa poshtë ka rënë katundi", nga një servilizëm, që iu bëhet disa eksponentëve të njohur me damkë si reaksionarë.
Ish-disidenti i djeshëm, Agim Gjakova bie në prehrin e propagandës titiste të Beogradit, Prishtinës dhe të Tiranës?!!!
Tani shtrohet çështja: çfarë nënkuptojmë me këtë servilizëm të mjerë?
Mendoj, në këtë rast që, qëndrimi nënshtrues dhe përulës ndaj autoriteteve politike të kohës, ndodh shpesh për përfitime personale ose për të ruajtur pozitat në shoqëri, apo në institucione.
Kjo ka qenë dhe ende është aktuale në vendet, në "tranzicione" në sistemin feudal-kapitalist, një praktikë e shëmtuar ku artistët dhe "intelektualët" pakurrizorët, shpesh ju duhet të pajtohen me ideologjinë zyrtare të "demokracisë" kapitaliste.
Si duket, pa pikë dyshimi, Agim Gjakova ka rënë në këto humnera të kësaj kohe të pakohë, që, vërtet zor e ka me dalë me faqe të bardhë.
- Them kështu, sepse Agim Gjakova, ka rënë nën kthetrat e propagandës titiste-rugoviste & Co, të vijës më të errët UDB-iste.
Si duket, ky nuk e din, apo përpiqet ta fshehë faktin që, Miladin Popoviçi e ndihmoi fuqishëm, PKSH-n dhe Enver Hoxhën.
Ai, ishte për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë.
Kjo është e vërteta. Pikërisht për këtë serbët e OZNA-s, me urdhër të kryeçetnikut, Dushan Mugosha, e vranë në Prishtinë, sepse, ai me Enver Hoxhën ishin ata që organizuan Konferencën e Bujanit.
Pra, Miladini ishte për VETËVENDOSJEN e popullit të Kosovës. Ishte për bashkimin Shqiptar.
Emri, Miladin Popoviçit është besnikëri e denjë prej shqiptari.
Ndërsa, këto paçavuret politike që dolën si kërpudhat pas shiut në vitin 1989 e këtej, duke shpifur ndaj shqiptarëve përparimtarë dhe kundër strategut Enver Hoxha dhe Miladin Kelmendasit,

duke mos thënë as një fjalë për udbashen, Milica Obranoviçin, vjehrra e Sali Berishës, e cila e ndërroi mbiemrin nga Milica në Vera.
Më qartë se kushdo tjetër e ka thënë troç anti-shqiptari Milovan Gjilasi, ish-funksionar i Federatës Jugosllave, në TV Sarajevën, kur deklaroi:
"Po, Koçi Xoxi ka qenë agjenti ynë, ne e kishim atë përkrahës; për atë e vrau PKSH-ja; ashtu, siç ka qenë Miladin Popuviçi, agjent i Enver Hoxhës".
- Historia, nuk shkruhet sipas tekeve e shpifjeve, por me fakte,

Ndaj dhe titistët Enverin gjithmonë e kanë trajtuar si armikun më të madh të jugosllavëve.
Ztr, të etur pas lakmive dhe pasurive, po hyni në "Vreshta të huaja" që nuk ju takojnë!… Lexoni historinë e vërtetë, e jo të bazoheni në thashethemet titiste, që në këto tri dekada, altoparlantët e borgjezisë reaksionare vetëm shpifin dhe trillojnë ndaj Shqiptarit më të madh Enver Hoxha.
Shpifni dhe fabrikoni kot së koti, gënjeshtra ju nga reaksioni "kombëtar" dhe ndërkombëtar, kundër Enver Hoxhës.
"Enver Hoxha, është si toka, toka nuk rrëzohet".
- Kështu, ka thënë me të drejtë, Imer Halili, ish-i burgosur politik.

Lavdi Enver Hoxhës! Kopenhagë, 29 prill 2025

ADNAN MEROVCI – NJË ALAMET "SHKRIMTAR"?!

Nga mënyra se si Adnan Merovci po e promovon veten si shkrimtar, dikush që s'e njeh realitetin tonë mund të mendojë se po ka të bëjë me një autor të rëndësishëm të letërsisë historike ose politike shqiptare. Së fundmi, në një përurim librash në Zvicër, ai raportohet të ketë shitur pesë libra për 100 franga zvicerane një pako që, sipas shumëkujt, ka më shumë vlerë simbolike propagandistike sesa përmbajtje historike reale.

Nuk është habi që dikush përpiqet të përfitojë nga mungesa e vetëdijes kritike tek një pjesë e lexuesve. Habia e vërtetë është se si një figurë që ka qenë dëshmitar – dhe shpeshherë edhe pjesëmarrës – në zhvillime të rëndësishme politike, zgjedh të shkruajë shumë pak (ose aspak) për ngjarjet që kanë përcaktuar fatin e një kombi.

Çfarë nuk po na thotë Adnan Merovci në librat e tij?

A ka ndonjë analizë të sinqertë për politikën e Presidentit Ibrahim Rugova? A ka reflektim të vërtetë për deklaratën e pavarësisë së lexuar nga deputetët e tij, për planet e Rambujesë që u pranuan pa asnjë analizë serioze, apo për rolin e paqartë të lidershipit të atëhershëm gjatë periudhave kritike për Kosovën?

A shkruan për takimet në Uashington me Presidentin Bill Clinton, ku UÇK-ja fitoi mbështetjen amerikane, ndërsa Presidenti Rugova merrej me deklarata të mjegullta për gjendjen në Shqipëri dhe "vlerat demokratike" të liderëve të saj?

A ka ndonjë rresht për takimin famëkeq në Beograd, kur Rugova se si u "kidnapua" nga forcat serbe dhe më pas u shfaq në një konferencë shtypi Millosheviqin e Shahinoviqin duke kërkuar ndaljen e bombardimeve ndaj Serbisë se vuan populli serb!E, pa përmendur vuajtjet e popullit shqiptar? A përmendet fakti që bashkë me të ishin edhe familjarë të Rugoves e te Merovcit dhe se udhëtimi nuk dukej edhe aq i detyruar?

Fshehje selektive e historisë

Shkrimtarja e vërtetë historike nuk është propagandë. Ajo nuk i shmanget ngjarjeve që janë të dhimbshme për t'u pranuar. Pyetja që duhet t'i bëhet çdo autori që pretendon të shkruajë për historinë, është: pse nuk përmend rezistencën e armatosur para luftës? Pse nuk shkruan për Tahir Mehën, Rafi Halilin, Rexhep Malen e Nuhi Berishen, apo të tjerë që sfiduan me guxim regjimin serb, ndërkohë që figura të tjera përpiqeshin të ruanin "balancën diplomatike"?

Përse nuk trajtohet me serioz historia e familjes Jashari, për të cilën ende përhapen teza manipulimi, kinse kishte bashkëpunim me Rugovën paqësore?

Letërsia si mjegullim i kujtesës kolektive

Shkrimi i historisë është mision i ndjeshëm. Nëse ke qenë afër vendimmarrjes, ke edhe më shumë përgjegjësi të tregosh të vërtetën. Por në vend të kësaj, merret rruga e lehtë – selektimi i kujtimeve, zbukurimi i figurave, shmangia e përgjegjësive. Dhe për sa kohë ka lexues që duan të dëgjojnë vetëm atë që ju pëlqen, autorë si Adnan Merovci do të vazhdojnë të botojnë libra që më shumë mjegullojnë sesa ndriçojnë të kaluarën tonë.

Historia nuk është për nostalgjikë dhe as për adhurues të figurave të kultit. Ajo është për ata që kanë guximin të ballafaqohen me të vërtetën, sado e pakëndshme të jetë ajo.

Deri atëherë, librat që nuk guxojnë të thonë të vërtetën, mbeten thjesht përurime të një heshtjeje të stërzgjatur.

Kopenhag, 02 maj 2025


NË MBROJTJE (DIPLOMATIKE) TË ÇËSHTJES SH

lt, kryetar i PEN-it Danezë, shkrimtar dhe analist, Ro
eradaktor i të perditshmes POLITIKEN, dhe shumë fu
sione tjera. foto. korrik 1996

se nuk e kam parim të polemizoj në gazet
e persona të tipit "Nikçi"), në rrethana të so
për shkak se nuk jam i "aftë" të giej titui

"Në një takim për organizimin e kulturës shqiptare, me kryetarin e PEN-it, Nils Bafud, dhe me redaktorin e së përditshmes Politiken, Robert Bundig. Në prill 1993, akademiku Rexhep nuk arriti të vinte, por aktiviteti u mbajt me përfaqësuesin e Ambasadës shqiptare në Stokholm, Melan Shanaj."



"Gjatë një debati në një aktivitet të Lëvizjes Vetëvendosje në Kopenhagë, 2024."



"Takim në Odense, Danimarkë, me sekretarin e Partisë Socialdemokrate daneze, Erik Bøl, kryetarin Visar Ymeri, Albin Kurti dhe unë, Xhemil Zeqiri."



"Me veteranin e UÇK-së, Niels Henrik Hooge, dhe unë, Xhemil Zeqiri, gjatë festimit të 18-vjetorit të Pavarësisë së Repuplikës Kosovës në Kopenhagë, organizuar nga Konsullata e R. Kosovës."



"Në qershor të vitit 2018 në Tiranë, me kolonel Dilaver Goxhajn (apo komandant Shpëtim Golemi), unë në mes dhe poeti ynë kombëtar, Arben Duka."



"Në Tetovë, në gusht 2023, na priti akademik Abdulla Mehmeti. Në foto: Abdulla Mehmeti, studiuesi Agron Dalipaj, veprimtari Luan Baçi dhe Xhemil Zeqiri."



"Në debat në TV Euronews Albania, me Krenar Shalën nga Prishtina, unë nga Kopenhaga, drejtuar nga gazetari Tjimi Samarxhiu."


XHEMIL ZEQIRI
NË MBROJTJE (DIPLOMATIKE) TË ÇËSHTJES SHQIPTARE
Xhemil ZEQIRI
E VËRTETA BËN ARMIQ
XHEMIL ZEQIRI
SI TA SHPJEGOJMË KËTË LLOJ URREJTJE
Xhemil Zeqiri
POLEMIKA, INTERVISTA, DEBATE DHE LETRA
XHEMIL ZEQIRI - FADIL SHYTI
MONA AGRIGOROAIEI
DREJT VETËVENDOSJES
Xhemil Zeqiri
ARSYETIMI TË ÇON PRANË SË VËRTETËS
KOSOVA
- En fortiet konflikt
KOSOVA-DOKUMENTER
Aktuelle og historiske dokumenter til belysning af konflikten i Kosovo

BIOGRAFIA E XHEMIL ZEQIRIT

U lind më 27 shkurt 1958, Komuna e Zhelinës, Tetovë.
Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme teknike; e përfundoi në Gostivar. Në vitin 1978 u largua nga vendlindja për arsye të ndjekjes politike nga regjimi kriminal titist. Fillimisht qëndroi në Zvicër dhe në Gjermani; në vitin 1981 emigroi në Kopenhagë, Danimarkë. Është veprimtar politik.

Veprimtaria politike dhe organizative
Që nga fillimi i viteve ’80 u angazhua në veprimtari politike në mërgatë. Në vitet 1985–1986 Danimarkë, si dhe Shoqatën Kulturore “Besa” në Kopenhagë. Më pas formoi Komitetin “Miqtë e Kosovës”. Organizoi demonstrata, debate publike dhe dy Konferenca Ilirike (Ballkanike), ku morën pjesë personalitete të njohura të kohës. Demaçi, Dritëro Agolli, Hajrullah Gorani, Skënder Gjinushi e të tjerë...
Xhemili, ka organizuar grupe veprimtarësh dhe gazetarë nga redaksitë e ndryshme të gazetave daneze që të shohin dhe të vërtetojnë gjendjen në terren, ka organizuar takime me 'ta, pastaj, i ka çuar në Kosovë, që ta njohin nga afër situatën e rëndë politike, ekonomike, sociale tepër të rëndë në Kosovë gjatë kohës së pushtimit jugosllavo-serb...!
Publicistika dhe botimet:
Pas krijimit të partive politike, iu përkushtua publicistikës. Ka shkruar publicistikë të fuqishme me realizëm, si:
“Kosova – një konflikt i vjetër nga 1913”. Ka botuar mbi 250 artikuj në shtypin danez dhe shqiptar, si dhe 36 letra të hapura drejtuar institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare. Është autor i shtatë librave me karakter politik dhe publicistik, të botuar në Tiranë, Prishtinë dhe Pejë.
“Dokumente për Kosovën”.
“Kosova – një konflikt i vjetër 1913-tës, e, jo siç thoshin LDK-ja titiste, konflikti ka filluar prej marsit të vitit 1989”.

Është autor i shtatë librave me karakter politik dhe publicistik:

- *Kosova Jonë* (2000, Tiranë).
- *Në mbrojtje (diplomatike) të çështjes shqiptare* (2003, Prishtinë)
- *Polemika, debate, intervista dhe letra* (2005, Prishtinë).
- *Drejt Vetëvendosjes* (bashkautor, 2008, Prishtinë), me Fadil Shyti, Mona A.
- *E vërteta bën armiq* (2017, Prishtinë)
- *Arsyetimi të çon pranë së vërtetës* (2021, Prishtinë)
- *Si ta shpjegojmë këtë lloj urrejtjeje* (2023, Pejë)

Parimi i tij politik ka qenë dhe është, mbrojtja e të drejtave sociale dhe kombëtare të shqiptarëve, si dhe ruajtja e unitetit kombëtar.

Kjo është vepra e radhës e tij. Urojmë që edhe në të ardhmen shoku Xhemil të ketë shëndet dhe suksese, për lexuesit të shkruaj dhe vepra të tjera me vlera të larta kombëtare dhe njerëzore.

Malmë, 23 shkurt 2026

PËRMBAJTJA

XHEMIL ZEQIRI -NJË JETË NË SHERBIM TË KOMBIT ... 5
PA ADEM JASHARIN, KOSOVA SOT DO TË KISHTE ENDE POLICË DHE USHTARË SERBË…! ... 12
PSE SHQIPTARËVE U MOHOHET E DREJTA PËR BASHKIM KOMBËTAR? ... 14
SUGJERIMI IM DHE I BASHKËPUNËTORËVE TË MI QË, VV-JE, TË HYJË NË INSTITUCIONE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHA REZULTATE TË KËNAQSHME, -TË SHUMËPRITURA?! .. 16
KRYESIA E FAQES SHQIPTARE ”DIPLOAMCIA.DK”, DEL ME KËTË: KOMENT ... 21
DILAVER GOXHAJ, KOMANDANT “SHPËTIM GOLEMI”: HEROI QË MERITON TË SHPALLET “NDERI I KOMBIT”! ... 24
ENVER HOXHA – STRATEGU I MADH I HEROIZMIT TË KOMBIT SHQIPTAR ... 27
REAGIM NDAJ DEBATIT NË RTK PËR FIGURËN E ENVER HOXHËS ... 30
TË NDERUAR BASHKATDHETARË SHPIFJET DHE TRILLIMET NDAJ ENVER HOXHËS NUK JANË AS PAK TË VËRTETA! ... 32
NDËRHYRJA SERBE NË KOSOVËN VERIORE: NJË STRATEGJI PËR NDARJEN E KOSOVËS DHE SAKATOSJEN E TROJEVE SHQIPTARE ... 33
NGJARJET POLITIKE DHE KEQINTERPRETIMET PUBLIKE: NJË QASJE KRITIKE?! ... 36
ROLI REAKSIONAR KUNDËR INTERESAVE SHQIPTARE I STRUKTURAVE PRO-SERBE QË U RRESHTUAN PAS IBRAHIM RUGOVËS DHE LDK-SË?! ... 41
CLINTON – RUGOVA- JA EDHE NJË ARGUMENT SHTES! ... 47
NGA LIDHJA KOMUNISTE NË LIDHJEN DEMOKRATIKE – E NJËJTA FYTYRË E VJETËR E DHUNËS. ... 51
TITISTËT E HOTEL “ROGNERIT” DHE DEFORMIMI I PROJEKTIT KOMBËTAR PAS LUFTËS ÇLIRIMTARE TË UÇK-SË. ... 53
ÇFARË NËNKUPTOJMË ME “TRADHTI”? ... 56
KOMENTI IM PËR ARTIKULLIN PERSONAL TË GËZIM MEKULIT ... 58
PARTITË SHQIPTARE NË MAQEDONINË E VERIUT: VEGLA TË REGJIMIT MAQEDONAS KANË RËNË NË HESHTJE PËR RACIZMIN INSTITUCIONAL?! ... 60

MAQEDONIA E VERIUT DHE URREJTJA INSTITUCIONALE NDAJ SHQIPTARËVE – ALARM PËR BALLKANIN..... 63
MANIPULIMI I LISTAVE ZGJEDHORE NË MAQEDONINË E VERIUT: FALSIFIKIM SISTEMATIK KUNDËR SHQIPTARËVE AUTOKTONË..... 66
TË ARRATISURIT SHQIPTARË DHE SHËRBIMI I DETYRUAR NDAJ UDB-SË: QË NGA ARSHI PIPA DERI TE FLAMUR NOKA. 70
ÇLIRIMI I SHQIPËRISË DHE PËRPJEKJET E BALLIT KOMBËTAR NË NËNTOR 1944: RILEXIM MBI BAZËN E ARKIVAVE NDËRKOMBËTARE..... 75
MANIPULIMI I MASAKRËS SË TIVARIT NGA BALLISTËT DHE TITISTËT..... 78
HISTORIANI" URAN BUTKA DHE PËRPJEKJA PËR TË RISHKRUAR HISTORINË:NJË TRADHTI NDAJ KUJTESËS ANTIFASHISTE SHQIPTARE..... 82
"FLAMURI I NIKOLLËS DHE SHKOPI I GJYSHIT ADEM: KUJTIME QË MË BËNË NJERI"..... 85
LOTI I BURRIT NUK ISHTE ASPAK I LEHTË..... 88
NGA THEMELIMI DERI NË PARLAMENTIN E EVROPËS DHE KONGRESIN AMERIKAN..... 90
DEMOKRACIA E BLLOKUAR NË SERBI: PROTESTAT, REPRESIONI DHE HIJA E PROPAGANDËS..... 92
SË VITEVE '90 92
RIKONSTRUKTIMI I IDENTITETEVE KOMBËTARE NË BALLKAN: RASTI I MALËSISË DHE SHQIPTARËVE NË SERBI94
ALARM KOMBËTAR/ MIELLI SERB PO HELMON SHQIPËRINË – I NDALUAR NË BE, I LEJUAR KËTU!..... 96
ËSHTË NEVERITËSE KUR EDHE NË RASTE TË VDEKJES NGA INSTITUCIONET FETARE ISLAME EKZISTON DYSHIMI SE PO BËHET KORRUPSIION, GJEGJËSISHT HAJNJI PERFIDE?! 99
REAGIM PËRKITAZI ME "REAGIMIN E MEXHLISIT TË XHAMISË NË ZHELINË". 102
AKADEMITË QË PO E LUFTOJNË GJUHËN SHQIPE 105
KOSOVA NUK MUND TË ECË PËRPARA ME PINJOLLËT TITISTO -RANKOVIÇIANË?!..... 107
BALLKANI I HAPUR: NJË PLATFORMË E KAMUFLUAR PËR DOMINIMIN SERB NË RAJON 110

JO! NUK QE ASPAK E RASTËSISHME ÇFARË NDODHI NË SHQIPËRINË TONË?! 113
ARRESTIMI I GAZETARIT, NEXHAT BEHLULI, SULM I RËNDË NDAJ LIRISË SË FJALËS NË KOSOVË?! 117
TRADHTIA NDAJ LUFTËS DHE REPUBLIKËS 119
LETËR E HAPUR: NJË SHPIFJE E TURPSHME DHE NJË PËRPJEKJE E DËSHTUAR 121
TË LUMTË", O BEN BLUSHI?! 124
SPAK-U MERRET ME SHPIFJET NDAJ HISTORISË DHE KULTURËS SHQIPTARE! 127
FESTAT E NËNTORIT NË TETOVË 131
DEBAT KUNDER RETORIKËS TË PABAZUAR NË FAKTE DUHET TË KUNDËRSHTOHET 136
ALBIN KURTI DHE VV PËR KOSOVËN?! 138
KUSH JE TI O ENVER HOXHAJ QË KËRKON DEBAT ME KOLOSIN ALBIN KURTI?!?!?! 141
MË VJEN KEQ SE HASHIM THAÇI DËNOHET NË HAGË AI ËSHTË DASHUR TË DËNOHEJ NË PRISHTINË?! 148
LIBRIN E ALBINIT E KA FINANCUAR XHEMIL ZEQIRI, E JO DEVOLLI, O SHPIFËS - VEHBI KAJTAZI! 150
THIMI SAMARXHIU: Z. KRANAR SHALA NGA PRISHTIN DHE Z. XHEMIL ZEQIRI NGA KOPENAHGA DEBAT - ANALIZËN PER ZGJEDHJET 09. SHKURTIT 2025 153
NË STUDION E TV EURONEWSALBANIA 21-04-2024 157
REAGIM NDAJ "VEPRIMTARIT TË MADH", QË NUK E NJEH AS LAGJJA E VET – KUJTIM LUSHA 172
REAGIM NDAJ "HISTORIANIT" AGIM GJAKOVA 176
ADNAN MEROVCI – NJË ALAMET "SHKRIMTAR"?! 182
BIOGRAFIA E XHEMIL ZEQIRIT 189

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

821.18-94

Zeqiri, Xhemil
Reflektimi i botës shqiptare / Xhemil Zeqiri. - Pejë : Libri im, 2026. - 193 f. : ilustr. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-989-62-6